Objektivi: Fibrina e pasur me trombocite është një sistem i koncentrateve të **gjakut** i cili përdoret kohët e fundit në shkollën tonë dentare, në Kirurgjinë orale dhe Implantologji. Një studim retrospektiv është bërë në 49 artikuj dhe pesë libra. Kriteret e përzgjedhjes ishin fjalë kyçe si fibrinë e pasur me trombocitet, PRF në dentistrinë rigjeneruese, A-PRF dhe I-PRF. Bazuar në këtë literaturë u gjet rëndësia e përdorimit të PRF si një koncept i ri në stomatologji që rrit cilësinë dhe rezultatet në ndërhyrje të ndryshme në kirurgjinë orale. Bazuar në këtë koncept ne kemi filluar të përdorim teknikat e PRF në Shkollën tonë dentare në alveolën post-ekstraksionit, rigjenerimin e indeve të buta në sëmundjet periodontale, ngritjen e sinusit, implantologjinë etj.

Fjalë kyçe: Dentistri, I-PRF, A-PRF.

41. NDIKIMI I DISA FAKTORËVE SISTEMIKË NË LINDJEN DHE ECURINË E PARADONTITETVE

Dr. Shk. Silvana BARA, Prof. Dr. Adem ALUSHI

Abstrakt

Paradontiti, është një sëmundje inflamatore e karakterizuar nga shkatërrimi i strukturave mbështetëse të dhëmbëve.

Konsiderohet si një ndër shkaktarët kryesorë të humbjes së dhëmbëve pas moshës 35 vjeç duke ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së pacientit. Për këtë arsye i kushtohet rëndësi si studimit të faktorëve shpërthyes lokalë që ndikojnë në shfaqjen e paradontopative, ashtu dhe faktorëve favorizues sistemikë, që mund të jenë sëmundje, gjendje fiziologjike kalimtare të organizmit ose vese të ndryshme të pacientëve. Disa prej tyre të cilat do t'i trajtojmë në këtë leksion janë: diabeti, puberteti, shtatëzania, menopauza dhe duhanpirja.

Studime të ndryshme tregojnë se diabeti është një ndër faktorët e rriskut për shfaqjen e paradontopative. Ndjeshmëria ndaj tyre rritet në njerëzit me diabet. Diabeti i pa mjekuar ndikon në veprimtarinë e leukociteve polimorfonukleare, duke ulur rolin e tyre kimiotaksik ose duke rritur aktivitetin e kolagenazës, që prodhohet prej tyre. Po ashtu ndikon në prodhimin e citokinave apo ndryshimet degjenerative të indit lidhor, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e mjekimit.

Ndryshimet hormonale ndikojnë në parodont në stade të ndryshme të jetës së njeriut, një ndër të cilët është dhe puberteti, i cili shënon fazën e fillimit të ndryshimeve të kalimit nga adoleshenca në të rritur. Në këtë fazë rritja e hormoneve steroidë, siç është testosteroni te meshkujt dhe estradioli tek femrat, luan një rol sinjifikativ duke alternuar përgjigjen e indit periodontal ndaj pllakës bakteriale, çka çon në sëmundjet periodontale.

Ndikim të rëndësishëm kanë edhe ndryshimet hormonale tek femrat që lidhen me shtatëzaninë. Kjo për shkak të shtimit të hormoneve si estrogjeni dhe progesteroni, të cilët ndikojnë në ecurinë e sëmundjeve paradontale, ndër të tjera, me këto mekanizma: estrogjeni stimulon metabolizmin e kolagenit dhe angiogenzën (epulis gravidar), ndërkohë që progresteroni shkakton zgjerim të enëve të gjakut duke rritur permeabilitetin vaskular gjë që çon në një përgjigje të ekzagjeruar ndaj pllakës bakteriale.

Ndikim ka edhe menopauza pasi në këtë periudhë kemi ulje të nivelit hormonal gjë që çon në osteoporozë e cila nga ana e vet përkeqëson paradontopatitë paraekzistuese. Në menopauzë ka probleme në paradont që lidhen edhe me metodat mjekuese të saj qoftë hormonale, qoftë me bifosfanate.

Duhanpirja ndikon, gjithashtu, në ecurinë e shëndetit të pacientëve, si dhe në mënyrë direkte ose indirekte edhe në parodont. Ndikimi lidhet si me mundësinë e akumulimit më të madh të pllakës bakteriale, ashtu dhe në aftësitë fagocituese të neutrofileve dhe uljes së funksionit të limfociteve B dhe T.

42. QASJE NDAJ PACIENTËVE ME TERAPI ANTIKOAGULANTE NË KIRURGJINË ORALE

Dr. Shk. Amet DEMIRI, Dr. Seha MUSTAFAI

Abstrakt

Antikoagulimi sistemik me antikoagulantë intravenozë ose oralë dhe barna antitrombocitar të gjakut është një trajtim efikas kundër tromboembolis, sëmundjeve kardiovaskulare, insultet cerebro-vaskulare, si dhe tek pacientët që trajtohen me dializë.

Procedurat dentare invazive ose kirurgjia orale mund të shoqërohen me ndërlikime të gjakderdhjes, nëse kryhen nën efektin e antikoagulantëve. Pacientët me antagonistët e Vitaminës K, antikoagulant të drejtpërdrejtë oral ose me preparate anti trombocitare, që kanë ndërhyrje dentare me rrezik të ulët për gjakderdhje, nuk kanë nevojë për ndërprerje të antikoagulantëve. Në rast të gjakderdhjes dhe komplikimeve të masave hemostatike lokale, të tilla si: qepjet lokale kirurgjikale, ngjitës të fibrinës, trajtimit antifibrinolytic lokal me acid traneksamik, ose acid –aminocaproic, mund të mjaftojë për të ndaluar gjakderdhjen.

Në pacientët me rrezik të lartë të gjakderdhjes duhet të kryhet një vlerësim individual i raportit të përfitimit/rrezikut të ndërprerjes së antikoagulimit. Kalimi i antikoagulimit afatgjatë me antikoagulantët afatshkurtër duhet të planifikohet sipas udhëzimeve ndërkombëtare. Futja e antikoagulantëve të rinj të drejtpërdrejtë oral që kanë ndikim më të butë farmakokinetikë ka lehtësuar trajtimin, duke lejuar ndërprerje afatshkurtër pa rritur rrezikun e trombozës ose krizave kardiovaskulare.

Fjalë kyçe: antikoagulantët oralë, kirurgjia orale, antagonistët e Vitaminës K, antikoagulantët e drejtpërdrejtë oral (barna antitrombocitar), aspirinë ose acidi acetil salicilat (Acidum acetyl salicylicum), heparina.

43. NEOPLAZITË E GJËNDRAVE TË PËSHTYMËS: STUDIM RETROSPEKTIV PREJ 8 VITESH NË DY SPITALE KRYESORE NË SHQIPËRI

Dr. Shk. Brunilda Gashi CENKOGLU[1], Dr. Erisa KOLA[2], Prof. Dr. Mehdi

ALIMEHMETI[3], Dr. Alfred AGA[3],Dr. Shk. Leart BËRDICA[2,3], Dr. Brunilda Ajazi LIKA[4]

[1]*Departamenti i Kirurgjisë Orale dhe Maksilofaciale, Albanian University*

[2]*Departamenti i Patologjisë dhe Mjekësisë Ligjore "Nënë Tereza" Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

[3]*Spitali Amerikan, Tiranë*

[4]*Klinika Dentare Private, Tiranë*

Abstrakt

Tumoret e gjëndrave të pështymës më shpesh paraqiten si masa të zmadhuara pa dhimbje. Tumoret malinje të gjëndrave të pështymës janë të rralla dhe përbëjnë më pak se 0. 5% të të gjithë neoplazive malinje. Shumica janë të vendosura në gjëndrat parotide dhe janë beninje. Vështirësia kryesore në menaxhimin e tyre qëndron në vendosjen e diagnozës diferenciale nësë janë malinje apo beninje.

Ekzaminimi klinik dhe teknikat imazherike konvencionale zakonisht nuk mund të bëjnë diferencimin mes atyre beninje dhe malinje dhe as të nënklasifikojnë proçeset patologjike. Ekzaminimi histopatologjik duke përdorur Hematoxilin-Eosin është ende çelësi i përdorur për diagnozën. Përveç kësaj, imu n ohistokimia mund të përforcojë diagnozën dhe të jetë e dobishme në përcaktimin e parametrave si natyra e qelizave dhe stadi diferencial, proliferimi i qelizav e dhe shprehia e proteinave tumorale. Tumoret beninje dhe ato malinje në stadin e hershëm mund të trajtohen në mënyrë adeguate vetëm me kirurgji, ndërsa tumoret më të avancuara dhe të nivelit të agravuar me metastazë limfonodulare regjionale do të kenë nevojë për radioterapi postoperative.

Qëllimi: Kjo analizë retrospektive u krye për të vlerësuar paraqitjen klinike, vendodhjen dhe trajtimin në tumoret e gjëndrave të pështymës duke theksuar disa nga aspektet më të rëndësishme në diagnostikimin dhe menaxhimin e tyre. Incidenca dhe shpërndarja e të gjitha llojeve të tumoreve të gjëndrave të pështymës u analizuan dhe u krahasuan me studime të tjera epidemiologjike me prejardhje gjeografike të ndryshme.

Materiale & Metoda: U krye një studim retrospektiv i ekzaminimeve bioptike të patologjive të gjëndrave të pështymës gjatë periudhës 2010-2017. Vlerësimi i informacionit u bë duke u bazuar në diagnozën histopatologjike, vendndodhjen, moshën dhe gjininë.

Rezultate: U ekzaminuan 182 biopsi, nga të cilat 118 në meshkuj dhe 64 në femra. Topografikisht, frekuenca më e lartë ishte në gjëndrën parotide. Sipas llojit të lezioneve, 37 prej tyre nuk ishin neoplazike, 104 neoplazi beninje dhe 41 tumore malinje. Lezionet neoplazike u paraqitën me prevalencë në meshkujt. Lezionet më të shpeshta rezultuan të ishin adenoma pleomorfe (n = 79). Moshat e prekura nga patologjitë e gjëndrave të pështymës të studiuara në mostër fillonin nga mosha

minimale prej 5 muajsh dhe maksimalisht 83 vjeçarë. Megjithatë, shumica e rasteve u gjetën në dekadat e 5-ta, 6-ta dhe të 7-ta të jetës.

Konkluzione: Të dhënat e marra në mostrën aktuale tregojnë një tendencë të lehtë që këto sëmundje të shfaqen më shumë tek meshkujt. Ky rezultat është në kundërshtim me studimet e tjera të raportuara në literaturë. Këto rezultate mund të shpjegohen me faktin se meshkujt kanë tendencën të kontrollohen më shpesh, për shkak të privilegjit që ata gëzojnë në shoqërinë shqiptare. Siç tregohet edhe në studime të tjera, në të dyja llojet e gjëndrave të pështymës si ato të mëdha dhe të vogla, lloji më i zakonshëm i tumorit beninj është adenoma pleomorfe.

Fjalë kyçe: tumoret e gjëndrave të pështymës, tumoret malinje, tumoret malinje të gjëndrave salivare të mëdha, karakteristikat beninje.

44. MUNDËSI DHE KUFIZIME NË TRAJTIMIN E RETRUZIONIT MAKSILAR

Dr. Elona KONGO

Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë

Abstrakt

Edhe pse hasen më rallë se format e tjera të malokluzioneve, veçoritë e lidhura me karakteristikat skeletike, përkeqësimi i pamjes së jashtme, ndikimi i faktorëve gjenetikë rritin shkallën e vështirësisë dhe suksesit në trajtimin e tyre. Kanë indikacion thuajse absolut për tu trajtuar sa më herët të jetë e mundur, për të siguruar efekte skeletike.

Materiale & Metoda: Në këtë studim është përzgjedhur një mostër me 40 pacientë me klasë të IIItë skeletike të trajtuar me zgjeruesin e shpejtë maksilar dhe maskë faciale.

Rezultate: Në përfundim të fazës aktive të trajtimit tek të gjithë pacientët u arrit korrigjimi i klasës së IIItëskeletike i cili u dokumentua me anë të analizës cefalometrike. Ndër parametrat kontribues në këtë korrigjim ishin këndi SNA, SNB, dhe ANB.

Konkluzione: Tërheqja përpara e maksilës me anë të maskës ekstraorale të ankoruar ose jo në zgjeruesin e shpejtë maksilar siguron përmirësimin e raporteve sagitale dhe te profilit. Pavarësisht efikasitetit të provuar të protokolleve klinike të aplikuara kusht që rezultatet të jenë po aq efikase përpacientët është përzgjedhja e bërë pas diagnozës së hershme dhe të saktë. Po aq i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi i pacientit në mbajtjen e maskës faciale.

45. QASJA DIAGNOSTIKE TE PACIENTËT ME KSEROSTOMI TË KUSHTËZUAR MEDIKAMENTOZE

Dr. Abdyl IZAIRI, Prof. Dr. Maja PANDILLOVA

Abstrakt

Kserostomia përcaktohet si një gjendje ose ndjenjë e gojës së thatë që rezulton në ndryshime biokimike në sasinë dhe përbërjen e pështymës e cila mund të paraqesë komplikacione të mëtejshme në shëndetin oral. Hiposalivimi është definuar si një vlerësim objektiv i një shkalle të reduktuar të rrjedhës së pështymës. Benzodiazepinat dhe antidepresivet përbëjnë barnat e përshkruara më shpesh me veprimtari anksiolitike që mund të shkaktojnë hiposalivim.

Diabeti mellitus, ndonëse një çrregullim metabolik, zakonisht dërgohet me një nga simptomat e para me gojë, si xerostomia. Receptorët e shijeve janë ekspozuar ne menyre permanente të duhanpirësit, ku efekti primar është stimulimi i pështymës nga hipersalivimi i fituar nga përdorimi kronik i cigareve për të kaluar në hiposalivacion te mëvonshëm. Ky material shqyrton njohuritë aktuale të barnave që shkaktojnë dëmtim të krijimit dhe rrjedhjes së pështymës dhe kushteve të caktuara që janë lidhur me thatësinë e gojës.

Fjalë kyçe: kserostomia, hiposalivimi, medikamentet, diagnostike.

46. BENEFITET E FULL AUTOLOGUES NË GRAFTIM, METODAT DHE INSTRUMENTAT

Dr. Gurien DEMIRAQI, Dr. Eriola NOÇKA

Abstrakt

Qëllimi: Alveola e dhëmbëve, me përjashtime të rralla ndryshon në mënyrë domethënëse, pas heqjes së një dhëmbi. Kjo çon në nevojën që materiale të ndryshme grafti të aplikohen në alveolën postekstraktive, përpara se të vendoset një implant dentar ose proteza, për të ruajtur volumin e indeve të forta e të buta. Vetëm kështu ruajnë estetikën dhe lejojnë restaurimin normal. Materiali ideal i graftit të indeve të forta është osteokonduktiv, osteoinduktiv dhe osteogjenik. Kjo është arsyeja pse grafti i kockave autologe konsiderohet të jetë grafti i referencës “golden standard”.

Kocka autologe ka nevojë për situse donatore për t'u përftuar, gjë që zakonisht çon në nevojën e një ndërhyrjeje shtesë, jo gjithmonë e preferuar për pacientin dhe e thjeshtë për mjekun kurues.

Materiale & Metoda: Ekziston një biomaterial tjetër autolog, i cili ka të njëjtat vlera dhe qëndrueshmëri si kockat kortikale, që shpesh ne kemi në dispozicion dhe nuk e përdorim. Ky material është dhëmbi i ekstraktuar. Disa sisteme aktualisht lejojnë një dhëmb të ektraktuar që të transformohet në grimca të dentinës së dezinfektuar dhe/ose të dekalcifikuar, por edhe blloqe të saj, të gatshëm për implantim autolog, që lejon mbledhjen e kockës në alveolën implantare të krijuar ose në distancë. Sistemi i përdorimit të gjakut venoz BCGF dhe të ngjashëm me të, lejon krijimin e membranave të fibrinës për mbulimin e tyre dhe gjithashtu fibrinë të lëngshme që kompakton grimcat kockore në "Sticky Bone" dhe "Sticky Tooth". Teknologjitë më të fundit me disqe dhe Piezo lejojnë ndarje dhe ekspansion preciz të kreshtës alveolare apo marrje graftesh kocke autologe. Kompaktuesit dhe kondensuesit kockorë lejojnë kompaktimin e kockës për të përmirësuar stabilitetin kryesor. Bone Scraper-at lejojnë mbledhjen e kockës kortikale lehtësisht.

Rezultate: Përdorëm sistemin e bluarjes së dentinës autologe Smart Dentine Grinder, BCGF, Safe Scraper, Unica, Piezo etj. , në procedura të ndryshme. Këtu përfshihen krijimi e një situsi implantar optimal për implantim të mëvonshëm, apo ajo që është edhe më e leverdisshme, rritja dhe përmirësimi i situsit implantar, graftet në distancë në rastet e implantimeve konvencionale dhe imediate.

Konkluzione: Përdorimi i grafteve autologe, kockore dhe dentinare kur është e mundur, paraqet procedura jo gjithmonë të thjeshta për t'u aplikuar. Përfitimi i indeve të buta dhe të forta autologe, shpeshherë kërkon kohë për t'u përftuar dhe aftësi teknike që duan kohën e tyre për t'u arritur. Megjithatë graftet e përftuara paraqesin stabilitet shumë të mirë dhe lehtësi përdorimi. Gjithashtu, kostoja është e krahasueshme me materialet e graftit sintetik dhe heterolog, duke pasur kosto dhe efektivitet të mirë. Megjithatë benefitet e tyre çojnë në rezultatin final stabël dhe afatgjatë, i cili na bën optimist në përdorimin e tyre, gjithnjë e më të shpeshtë në të ardhmen.

47. TERAPIA E KAFSHIMIT TË HAPUR ANTERIOR NGA PARAFUNKSIONET

Dr. Franceska VINJOLLI

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Departamenti i Shkencave të Kirurgjisë

Abstrakt

Kafshimi i hapur anterior është një ndër malokluzionet më të veshtira për tu korrigjuar nga ana ortodontike sepse shpesh here vjen si rrjedhojë e faktorëve gjenetik të kombinuar me ato dentarë apo funksional duke dhënë kuadro klinike komplekse.

Kafshimi I hapur i shkaktuar nga faktorët lokal si parafunksionet përbën një situatë të vecantë e cila perkon me veset e thithjes së gishtit për një kohë të gjatë, biberonit apo gëlltitjes atipike, situatë e cila mund të quhet gjithashtu komplekse duke qenë se asistojme në një modifikim të okluzionit në të tre planet e hapësirës.

Gjate fazave të hershme kjo lloj problematike paraqitet shpesh here si një mosharmoni e tipit dentoalveolar e cila me avancimin e rritjes dhe mosndërhyrjen e duhur mund të transformohet lehtesisht në një situatë mosharmonie kockore.

Gjatë këtij leksioni do paraqiten kuadrot klinike të këtyre rasteve si dhe trajtimet të cilat duhen ndjekur të bazuara në rishikimet e fundit të literaturës dhe eksperiencës tone klinike.

48. TERAPIA PARADONTALE SI NJË DISIPLINË NË REHABILITIMIN ORAL

Dr. Ina ÇEKA

Departamenti i Kirurgjisë OMF, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Dipartimento di Parodontologia ed Implantologia, Universita degli Studi di Parma

Abstrakt

Qëllimi: Në praktikën e përditshme klinike nevoja për trajtim paradontal jo kirurgjikal apo kirurgjikal të pacientëve po paraqet tashmë një tendencë gjithnjë e në rritje. Ndjekja dinamike e tyre në kohë dhe në klinikë ndihmon diagnozën dhe trajtimin e duhur.

Materiale & Metoda: Pas një diagnoze të kujdesshme, vendosja nëse trajtimi jo kirurgjikal është i mjaftueshëm, apo nevojitet trajtim kirurgjikal është sfida e parë që na paraqitet. Në trajtimin kirurgjikal vendosja nëse duhet kirurgji resektive, rikonstruktive apo mukogingivare, nëse duket kirurgji e indeve të buta, apo duhen përfshirë edhe ato të forta.

Konkluzione: Në varësi të paraqitjes klinike të pacientit, ndjekjes hap pas hapi të përmirësimit, apo jo të gjendjes klinike pas diagnozës dhe trajtimit paradontal, kujdesjes së pacientit për higjienën dhe mbajtjen e rezultatit të krijuar nga paradontologu, vendosja e një plani individual trajtimi për çdo pacient paradontal do të ishte zgjidhja e duhur në kohë dhe në hapësirë klinike.

49. KURSI ENDODONTIK BAZË DHE I AVANCUAR PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË BRISTOL

Dr. Erlind PEPLA

Universiteti i Romës "La Sapienza" (Itali)

Abstrakt

Objektivi: Objektivi i këtij prezantimi është të rishikojë dhe të analizojë metodat e mësimdhënies për studentët universitarë të Universitetit të Bristol.

Materiale & Metoda: Mësimdhënia është e ndarë në kursin bazë të endodontisë, studentët e vitit të tretë, dhe në kursin e endodontisë së avancuar të përgatitur për studentët e vitit të katërt. Në këtë punim do të analizohen metodat e mësimdhënies, materialet e përdorura gjatë seancave laboratorike dhe leksioneve, duke patur parasysh të rejat nga Bota e Endodontisë, përditësimet nga Shoqata Europiane e Endodontisë. Megjithatë duhet të konsiderohet edhe aspekti i nevojave ekonomike.

Konkluzione: Libri i ushtrimeve që çdo student përdor është i përditësuar, por materialet e përdorura si dhëmbët Typodont dhe filet e përdorur për instrumentimin e kanaleve, mund të përmirësohen në mënyrë që procesi i mësimdhënies të bëhet më i kuptueshëm dhe efficient.

SESIONI 02

ABSTRAKTET E REFERIMEVE ORALE

50. HIPERPLAZIA GINGIVALE E SHKAKTUAR NGA CIKLOSPORINA NË SINDROMET MIELODISPLAZIKE

Dr. Adela PEROLLA[1], Dr. Jakup VRIONI[2], Prof. Dr. Tatjana CAJA[1], Prof. Dr. Arjan PUSHI[1]

[1]*Departamenti i Mjekësisë Interne, Shërbimi i Hematologjisë*

[2]*Departamenti i Kirurgjisë Maksilo-Faciale, QSUT "Nënë Tereza"*

Abstrakt

Hiperplazia gingivale është tejrritja e gingivave e karakterizuar nga zgjerimi dhe akumulimi i indit lidhor me praninë rastësore të shtimit të numrit të qelizave. Egzistojnë një varietet shkaqesh që sjellin hiperplazinë gingivale, duke filluar që prej një zmadhimi fals deri tek ai neoplazik, inflamator, i induktuar nga medikamentet dhe ai i shoqëruar me sëmundje sistemike[1]. Manifestimi klinik i hiperplazisë gingivale mund të variojë në severitet që nga format minore e deri te mbulimi komplet i dhëmbëve, duke krijuar si pasojë probleme estetike dhe funksionale për pacientin.

Tejrritja gingivale e induktuar nga medikamentet është një efekt anësor i njohur i inhibitorëve të kalcineurinës si psh. : ciklosporinë (CsA), i medikamenteve kalçibllokuese si psh. : amlodipinës dhe nifedipinës[2], dhe gjithashtu edhe i medikamenteve anti-konvulsivante dhe anti-epileptike [3].

Studimet epidemiologjike kanë treguar lidhjen midis sëmundjeve autoimune dhe sindromeve mielodisplazike dhe qoftë imuniteti i fituar qoftë ai i lindur janë shumë të aktivuar në folenë hematopoietike të MDS-së, prandaj, përdorimi i terapive me imunosupresorë do të përbënte një opsion ideal terapeutik për këtë grup neoplazish. Nga shumë studime është raportuar se përdorimi i ciklosporinës është shumë efikas në pacientët me transplant të veshkave, ku është parë se prevalenca e hiperplazisë gingivale së shkaktuar nga ciklosporina ishte 25%-30% [4] por ndërkohë që është provuar efikasiteti terapeutik i ciklosporinës në pacientët me MDS[5] me celularitet të ndryshëm në palcën kockore, veçanërisht për linjën eritroide dhe në pacientët me kariotip të mirë, tejrritja gingivale si pasojë e trajtimit raportohet rrallë në literaturë.

Ne po prezantojmë këtu një rast me hiperplazi gingivale të gjeneralizuar të lidhur me përdorimin e ciklosporinës në MDS, event ky që nuk është i zakonshëm.

Fjalë kyçe: sindromet mielodisplazike, ciklosporina, hiperplazia gingivale, terapia me imunosupresore.

51. NDIKIMI I ALTERNATIVAVE ANTISEPTIKE NË PËRPUNIMIN ENDODONTIK NË TRAJTIMIN E PULPITEVE

Prof. Asc. Agron METO, Dr. Emiljano TRAGAJ, Dr. Faustina KOLA

Departamenti i Terapisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT
Universiteti Aldent, Tiranë

Abstrakt

Një nga kushtet më të rëndësishme në efektivitetin e mjekimit endodontik është cilësia e përpunimit antiseptik, të kanalit të rrënjës. Preparati më efektiv për përpunim ka qenë dhe është 3-5% solucioni i hipokloritit të natriumit, si dhe kombinimet me ultratingujt, të cilët tregojnë veprim antimikrobik për llogari të nxehjes, duke lartësuar efektivitetin e solucioneve antiseptike.

Qëllimi: Të japim të dhëna klinike për përdorimin e lazerit në kombinim me antiseptikët, në trajtimin endodontik të pulpiteve dhe rekomandimet përkatëse për përdorimin e këtyre metodave.

Materiale & Metoda: Trajtuam për një periudhë 2 vjeçare 54 dhëmbë, mono dhe multiradikular, në 45 pacientë të moshës 20-65 vjeç. Në vartësi të shkallës së infeksionit, dhëmbët i ndamë në 2 grupe: grupi i parë me kanale rrënjësh të painfektuara, ku u grupuan dhëmbë të depulpuar për indikacione ortopedike; grupi i dytë me kanale rrënjësh të infektuara. 21 dhëmbë të padëmtuar u depulpuan për qëllime ortopedike, 13 me pulpit akut parcial, 12 me pulpit ulçeroz, 3 me pulpit akut total, 5 me pulpit hipertrofik. Për vendosjen e diagnozës përdorëm studimin me anën e radiografisë, ekzaminimin subjektiv dhe objektiv të pacientit. Për përcaktimin e gjatësisë së kanalit të rrënjës përdorëm apexlocator, për irrigim përdorëm solucionin e stabilizuar të 3% hipoklorit natriumit, i cili garanton tretjen maksimale të komponentit organik në shtresat e dentinës së zbutur, si dhe për zgjerimin e kanaleve me anën e 17% EDTA në formë likidi. Në fund, përpara opturimit të kanaleve realizuam përpunimin lazerik me Quicklaser®, me një fuqi lazerike 0. 8 W, me cilësi të theksuara antiseptike në endodonti. Të gjitha rastet u trajtuan në seancën para opturimit në një kohë trajtimi prej 20 sekonda, për çdo kanal me lëvizje spirale. Rastet u ndoqën në kohë të afërt deri në 6 muaj dhe në kohë të largët deri në 12 muaj.

Rezultate: Gjatë ekzaminimit të kryer në kohë të afërt vlerësuam praninë e nivelit të dhimbjes pas mjekimit endodontik, ndjeshmërinë e papëlqyeshme në kafshim dhe perkusion, ndjeshmërinë e vazhdueshme të dhimbjes (nga 1-6 ditë dhe më shumë), si dhe praninë e shenjave të inflamacionit në periodont. Në kohë të largët vrojtuam praninë e vuajtjeve, shenjat objektive të inflamacionit të periodontit, praninë

e ndryshimeve në indet periapikale në radiografi. Mjekimi endodontik shënoi efektivitet pas 12 muajsh, ku pas mjekimit munguan vuajtjet dhe në periodont u përcaktua një dinamikë pozitive. Në të gjitha rastet e trajtuara në grupin e parë pas 12 muajsh, rezultuan 98% pozitivë nga ana klinike dhe radiografike. Në grupin e dytë, rezultati pas 12 muajve arriti 95% pozitiv, nga ana klinike dhe radiografike.

Konkluzione: Rrezet lazer me gjatësi vale 980 nm zotërojnë veprim të shprehur antimikrobik dhe e ngrejnë në mënyrë të konsiderueshme efektivitetin e përpunimit antiseptik të kanaleve të rrënjës, në trajtimin endodontik të dhëmbëve, me infeksion në sistemin e kanaleve të rrënjëve.

52. RIKONSTRUKSIONI I DEFORMIMEVE POSTONKOLOGJIKE NË REGJIONIN MAXILLO-FACIAL. RAPORTIM I RASTEVE KLINIKE

Dr. Remi LIKAJ, Dr. Alba LIKAJ, Dr. Shk. Sonila MONE

Spitali Rajonal Vlorë

Abstrakt

Hyrje: Në regjionin Maxilo-facial hasim tumore beninje dhe malinje të përmasave të ndryshme, të cilat përveç heqjes adekuate në kufij të shëndoshë, duhet vlerësuar edhe rikonstruksioni i tyre postonkologjik.

Qëllimi: Prezantimi i këtyre rasteve klinike është të tregojm se si janë menaxhuar defektet e përmasave të ndryshme pas heqjes së tumoreve duke rivendosur formën, funksionin dhe estetikën, pa prishur cilësinë e jetës së pacientit.

Materiale & Metoda: Në këtë punim prezantojmë disa raste klinike të realizuara në Spitalin Rajonal Vlorë me tumore beninje dhe malinje në regjionin maxilo-facial si: perilabiale, labiale, nazale, bukale etj. Rikonstruksioni në tumore të vogla është realizuar për primam, ndërsa rikonstruksionet në tumore me përmasa më të mëdha është realizuar me autoplastike lokale të llojeve të ndryshme si: lembo avancuese, lembo bilobare, Z-plastike etj.

Konkluzione: Planifikimi dhe vlerësimi i kirurgjisë onkologjike në regjionin Maksilo-facial është shumë i rëndësishëm në: afërsine e tyre me strukturat vitale si:tufat e rëndësishme neurovaskulare të qafës, basis crani, globus oculi, hundë, menaxhimin e defekteve të mëdha postkirurgjikale, kontrolli i metastazave lokale

dhe regionale, kontrolli dhe ndjekja në kohë e tyre (follow-up).

53. SFIDAT E NDËRHYRJEVE IMPLANTARE NË STOMATOLOGJI

Dr. Shk. Aldo VANGJELI

Abstrakt

Qëllimi: Analizimi i hollësishëm i faktorëve preimplantarë, specifikimi i tyre jo vetëm duke e evidentuar atë sipas nofullave respektive, por edhe studimi më i detajuar sipas regioneve të veçanta është në fokusin e këtij punimi.

Materiale & Metoda: Për këtë punim kam shfrytëzuar eksperiencën time personale teoriko-praktike në trajtimin kirurgjikal të pacientëve të cilët janë paraqitur dhe i janë nënshtruar kirurgjisë implantare dhe jo vetem për një periudhë disa vjeçare. Në këtë punim do të paraqesim disa raste klinike të trajtuara në klinikën tonë.

Raste klinike: Pacienti M. S 50 vjeç paraqitet në klinikën tonë pas një ndërhyrje të dështuar implantare në të dy nofullat. Grafia panoramike jep këtë pamje. Ndërhyet në nofullën e sipërme dhe pas protezimit të saj grafia e kontrollit jep këtë pamje. Pacientja me të drejtë kërkon të riimplantojë edhe nofullën e poshtme. Vihet re atrofia kockore e shprehur si në gjatësi ashtu edhe në gjerësi. Ndaj kërkohet ndërhyrje korrektuese e cila kryet duke shfrytëzuar graft kockor autolog ndërsa është shfrytëzuar edhe memebrana e përfituar prej plazmës së pasuruar. Grafia e kontrollit paraqet këtë pamje. Pas afërsisht 5 muaj pacienti kryen ndërhyrje implantare. Grafia e kontrollit paraqet këtë pamje.

Konkluzione: Volumi kockor përcakton kriteret e vlerësimit individual për zgjedhjen e teknikës rikonstruktive e cila influencon qysh në fillim për zgjedhjen e procedurës më të mirë për kthimin morfo-funksional të indeve të buta e të forta duke pasur kujdesin maksimal në ruajtjen e estetikës implanto/protetike. Teknikat në dispozicion të kirurgut implantar për të pasur volum kocke të mjaftueshme për pozicionimin e implanteve janë të shumta dhe shpesh herë të sofistikuara. Vënia e tyre në shërbim të kirurgjisë implantare, implementimi sa më i mirë i tyre është detyrë e mjekut që merr përsipër trajtimin kirurgjikal të pacientit.

54. VLERËSIMI PSIKOSOCIAL NË PACIENTËT QË KËRKOJNË KIRURGJINË ORTOGNATIKE

Dr. Algen ISUFI[1,2], Dr. Irina ISUFI[1], Prof. Dr. Ramazan ISUFI[1,2]

[1]*Shërbimi i Kirurgjisë Oro-Maksilo-Faciale, QSUT "Nënë Tereza"*

[2]*Klinikë Dentare Private, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Për shkak të efektit të madh që trajtimi ortodontiko-kirurgjikal ka në estetikën faciale, kirurgjia ortognatike bën pjesë në grupin e kirurgjive estetike. Kjo kirurgji indikohet kryesisht në pacientë të rritur ku anomalitë dentofaciale nuk mund të menaxhohen vetëm me trajtim ortodontik. Përzgjedhja e duhur e pacientëve që do ti nënshtrohen kësaj kirugjie është një ndër çelësat e suksesit të saj..

Qëllimi: Të analizojmë motivacionin e pacientëve tanë për kirurgji ortognatike dhe sa kjo kirurgji ka ndikuar në cilësinë e jetës së tyre.

Materiale & Metoda: Në realizimin e këtij studimi morën pjesë 175 pacientë, të moshave nga 17-39 vjeç, të cilët u paraqitën pranë Shërbimit të Kirurgjisë OMF dhe klinikës sonë për të kërkuar kirurgji ortognatike. Me ndihmën e ortodontit, për të gjithë pacientët u krye diagnostifikimi i anomalisë dentofaciale, në sajë të ekzaminimit klinik ekstra dhe intraoral dhe ekzaminimeve suplementare si analiza cefalometrike dhe ajo e modeleve të studimit. Për të kryer vlerësimin psikosocial të pacientëve u aplikuan disa pyetsor. Pacientëve që kryhen kirurgjinë ortognatike ju kërkua gjithashtu të plotësonin disa pyetesor mbi sadisfaksionin nga trajtimi.

Rezultate: N=120 ose 68,5% e pacientëve paraqitën motivim intern për kirurgji. Kërkesa kryesore e pacientëve tanë ishte përmirësimi i estetikës faciale në n=112 (64%). N=58 ose 33% e pacientëve të marrë në studim ju nënshtruan kirurgjisë ortognatike. Në grupin e pacientëve që ju nënshtruan kirurgjisë; ishte përmirësuar Estetika në n=42 ose 72,4% të pacientëve, vetëvlerësimi në n=46 ose 79,3% të pacientëve dhe n=52 ose 89,6% e pacientëve do tja rekomandonin trajtimin dikujt tjetër.

Konkluzione: Vlerësimi psikosocial i pacientëve, duke analizuar motivacionin, gjëndjen psikologjike dhe statusin social është shumë i rëndësishëm në përzjedhjen e pacientëve që do ti nënshtrohen kirurgjisë ortognatike.

55. LIDHJET E DËMTIMIT TË SHTYLLËS KURRIZORE NGA PËRDORIMI I TELEFONIT CELULAR

Dr. Alketa QAFMOLLA[1], Prof. Asc. Edit XHAJANKA[1], M.Sc. Viktor KASAPI[2],

Prof. Dr. Ruzhdie QAFMOLLA[2]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë*

[2]*Universiteti Aldent, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Telefoni celular dëmton organizmin dhe trupin e njeriut ne mënyre te konsiderueshme. Sot fenomeni i përdorimit te celularit gjatë gjithë ditës dhe pa ndonjë kriter është quajtur: "Qafa e masazheve". Sot po rritet gjithenje e me shpejte numri i të rinjëve, të cilët kanë shumë probleme me qafën dhe shpatullat e tyre, dhe kjo vjen, sepse ata përdorin për kohë mjaft të gjatë dhe pa asnjë kufizim telefonin celular.

Qëllimi: Te percaktojme korelacionin (lidhjen) qe ekziston midis perdorimit te celularit dhe demtimit te shtylles kurrizore.

Materiale & Metoda: Ky studim epidemiologjik transversal është kryer për një periudhë rreth 6 muajsh (tetor 2017 - mars 2018). Në studimin tonë janë shqyrtuar në mënyrë strikte 145 subjekte të grup moshës 18-30 vjeç. Të dhënat e studimit u mblodhen duke përdorur një pyetësor të strukturuar, te plotësuar nga subjektet e studimit tonë, të cilët u zgjodhën pa asnjë përzgjedhje primare të përbërë nga studentë te Fakultetit te Mjekesise Dentare si edhe edhe nga "Universiteti Aldent" në Tiranë. Të dhënat e mbledhura u analizuan statistikisht.

Rezultate & Diskutime: Pjesa më e madhe e rasteve te studiuara e të përfshira në zgjedhjen tonë ishin femra (67,6%). Rezultatet e studimit tregojnë se 75,9% e subjekteve të përfshira në studim kanë pasur probleme me qafën dhe shpatullat dhe kokën e tyre e cila shpesh herë është e zhvendosur përpara. Shumica e subjekteve të përfshirë në studim kryen po ashtu edhe radiografi të shtyllës kurrizore dhe qafës. Gjithashtu, rezultatet e studimit treguan se rreth 52,4% e subjekteve tona kishin deformim të vertebrave të qafës në C3-C5 dhe rreth 53,1% ishin të deklaruar me lordozë. Rezultatet e studimit treguan një korrelacion (lidhje) statistikore të rëndësishem sipas gjinisë së subjekteve dhe dhimbjeve të tyre në qafë. Sipas radiografive të kryera, u verejt deformim i qafës i shoqëruar me lordoze. Në të njëjtën kohë në studim nuk u arrit ne ndonje përfundim në lidhje midis gjinisë dhe dhimbjeve të qafës dhe problemeve në shpatulla, ku ((= 0,130).

Konkluzione: Studimi ynë i parë ishte i bazuar në përvojat dhe literaturën e përbashkët të shfrytëzuar, nga ana jonë dhe ku jepen disa të dhëna për korrelacionin (lidhjen) midis përdorimit të telefonit celular dhe problemeve të qafës dhe shpatullave. Rezultatet e studimit tonë konfirmuan një korrelacion midis gjinisë dhe përdorimit të telefonit celular. Për të shmangur sa më shpejt të jetë e mundur dëmtimet e qafës duhet të krijojnë një strategji të qëndrueshme në përdorimin e telefonit celular gjatë ditës, trajtim fizik, ushtrime dhe lëvizje të shpatullave dhe disa masa të tjera parandaluese për të shmangur dëmtimet e tilla në organizmin dhe trupin e njeriut.

Fjalë kyçe: dëmtimet e qafës, dhimbjet e qafës, radiografit cervikale, demtime të qafës, lordozis etj.

56. REZISTENCA NDAJ FRAKTURËS E DHËMBËVE TË TRAJTUAR ENDODONTIKISHT ME KAVITETE HYRËS KONSERVATIVË, TË RESTAURUAR ME MATERIALE TË NDRYSHME KOMPOZITE

Dr. Shk. Almira ISUFI[1,2], Dr. Gianluca PLOTINO[1], Dr. Nicola Maria GRANDE[3], Dr. Pietro IOPPOLO[4], Dr. Rozela XHEMNICA[2], Dr. Jolanda TAGA[5], Dr. Luca TESTARELLI[1], Dr. Rossella BEDINI[4], Dr. Gianluca GAMBARINI[1]

[1]*Departamenti i Endodontisë, Sapienza Università di Roma, Romë, Itali*

[2]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Shqipëri*

[3]*Università Cattolica del Sacro Cuore, Romë, Itali*

[4]*Istituto Superiore di Sanità, Dipartimento di Tecnologie e Sanità, Romë, Itali*

[5]*Klinikë Dentare Private, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Qëllimi: Përcaktimi dhe krahasimi i rezistencës ndaj frakturës së dhëmbëve, të trajtuar endodontikisht, të restauruar me materiale të ndryshme kompoziti.

Materiale & Metoda: 40 molarë maksilarë dhe 40 mandibularë pas trajtimit endodontik dhe procedurave adezive u ndanë në 3 nëngrupe, për çdo tip dhëmbi (n=10): Grupi A: grupi i kontrolllit (dhëmbë intaktë); Grupi B: kavitetet hyrëse u restauruan me rezinë kompozite tradicionale (EsthetX; Dentsply-Italy, Rome, Italy); Grupi C: kavitetet hyrëse u restauruan me kompozit bulkfill flow (SDR; Dentsply-Italy); Grupi D: kavitetet hyrëse u restauruan me kompozit bulkfill (SonicFill; Kerr-California, USA). Kampionët iu nënshtruan forcës kompresive për testimin statik deri sa të ndodhte fraktura, forca maksimale për frakturën e kampionëve u mat (N) dhe u regjistrua tipi i frakturës. Të dhënat u analizuan statistikisht me analizën e variancës (ANOVA) dhe testet Bonferroni (P<0. 05).

Rezultate: Asnjë diferencë statistikisht e rëndësishme nuk u gjet ndërmjet grupeve të dhëmbëve intaktë, në krahasim me dhëmbët e trajtuar endodontikisht në të gjitha grupet (P<0. 05). Asnjë diferencë statistikisht e rëndësishme nuk u gjet në rezistencën

ndaj frakturës edhe ndërmjet dy grupeve të restauruara me kompozitë bulkfill SDR e SonicFill.

Konkluzione: Rezistenca ndaj frakturës e dhëmbëve të restauruar me rezinë kompozitë tradicionale dhe me kompozitë bulkfill ishte e ngjashme, në molarët maksilarë e mandibularë dhe nuk tregoi asnjë zvogëlim të rezistencës ndaj frakturës krahasuar me kampionët intaktë.

57. EFEKTI I SHPËLARËSVE TË GOJËS NË STABILITETIN E NGJYRËS SË KORONAVE TË PORCELANIT

Dr. Arjola ALUSHI[1], Dr. Brunilda KOÇI[2]

[1,2]*Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë*

Abstrakt

Pacientët me risk për t'u prekur nga sëmundjet periodontale dhe kariesi dentar, duke përfshirë edhe ata që i nënshtrohen trajtimeve me punime protetike fikse përdorin agjentë kimikë të kontrollit të pllakës bakteriale, siç janë shpëlarësit e gojës. Sidoqoftë, këta shpëlarës goje mund të rezultojnë me efekte të padëshirueshme, të tilla si, diskolorim të materialeve restauruese.

Qëllimi: Të evidentojmë efektin që kanë dy shpëlarës të ndryshëm të gojës, chlorhexidinë digluconate 0. 2% dhe listerinë, në stabilitetin e ngjyrës së koronave të metal porcelanit dhe koronave të zirkoniumit monolitik.

Materiale & Metoda: Në këtë studim u përdorën 6 korona (3 metal-porcelan dhe 3 zirkonium monolitik). Këto korona u ndanë në tre nëngrupe, ku secili nëngrup u zhyt në një nga tre solucionet e mëposhtme: chlorhexidinë, listerinë dhe ujë i distiluar (grupi i kontrollit). Ndryshimi i ngjyrës(ΔE^*ab) u vlerësua me spektrofotometër dhe sipas sistemit të Komitetit Ndërkombëtar të Ndriçimit (CIELab). Të dhënat e përftuara nga sistemi CIELab u analizuan statistikisht përmes testit Tukey HSD dhe Kruskal Wallis.

Rezultate: Nga rezultatet e studimit u konkludua ndryshim sinjifikativ në Δa dhe Δb midis dy materialeve($p=0.001$), nuk u konkludua ndryshim sinjifikativ në ΔL($p=0.475$) pas zhytjes në chlorhexidinë. Pas zhytjes së porcelanit dhe zirkoniumit në listerinë, rezultatet e studimit treguan ndryshim sinjifikativ të ΔL($p=0.025$) dhe nuk u konkludua ndryshim sinjifikativ midis Δa($p=0.712$) dhe Δb($p=0.537$). Gjithashtu nuk u konkludua ndryshim sinjifikativ midis ΔL, Δa dhe Δb pas zhytjes në ujë të

distiluar. Megjithëse ndryshimi i vlerave mesatare të ΔE është statistikisht sinjifikativ, këto ndryshime nuk janë të perceptueshme për syrin e njeriut.

Konkluzione: Ndër profesionistët ekziston mendimi se punimet e metal porcelanit dhe të oksidit të zirkoniumit nuk ndryshojnë ngjyrë me kalimin e kohës, si pasojë e përdorimit të agjentëve kimikë, përfshirë edhe shpërlarësit e gojës. Studimi aktual tregoi se porcelani feldspat dhe zirkoniumi monolitik iu nënshtruan ndryshimeve të ngjyrës, pas zhytjes në chlorhexidinë dhe listerinë. Megjithatë, këto ndryshime nuk ishin të perceptueshme nga syri i njeriut. Ndryshimet e ngjyrave ishin brenda sferave të pranueshme klinike. Sipas studimit rezulton se pacientët duhet të ndihen të sigurt me listerinën, si shpërlarës goje, në rast se në gojë janë protezuar me korona metal porcelani apo zirkonium monolitik.

Fjalë kyçe: Qeramikë, chlorhexidinë, listerinë, ngjyrë.

58. TEKNIKAT E FIKSIMIT TË KURORAVE DHE URAVE MBI IMPLANTE. AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E TYRE

Dr. Benarda BEQARAJ

Klinikë Private Dentare, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Një nga shkaqet lokale të inflamacionit të indeve të buta përreth implantit është infiltrimi i cementit. Ai ka lidhje direkte me sëmundjet periimplantare dhe është shkaktar për humbjen kockore dhe dështimin e implantit. Punimet protetike mbi implante paraqesin sfidë të vazhdueshme, si në aspektin funksional ashtu dhe estetik.

Qëllimi: Ky prezantim ka për qëllim njohjen me teknikat e cementimit të kurorave teke dhe urave mbi implante, disavantazhet dhe përparësitë e secilës prej tyre.

Materiale & Metoda: Do të prezantojmë disa raste klinike të punimeve fikse mbi implante. Në të gjitha rastet janë aplikuar teknika me vidhosje dhe cementim ekstraoral.

Rezultate: Bazuar në protokollin e trajtimit pacientët janë ndjekur dhe vlerësuar çdo 6 muaj. Është vlerësuar gjendja e indeve të buta e të forta dhe punimi protetik mbi implant.

Konkluzione: Pozicioni i implantit në harkadën ndikon në përzgjedhjen e llojit të

cementimit. Teknika e cementimit me vidhosje të punimeve mbi implante paraqet përparësi, në raport me teknikat e tjera. Ajo siguron ruajtjen e indeve periimplantare nga infiltrimi i cementit. Me anë të kësaj teknike sigurohet jetëgjatësia e indeve të buta e të forta dhe estetika e tyre.

59. PERIODONTITI AGRESIV NË 3 HAPA TË THJESHTË

Dr. Besjan ABAZI[1], Dr. Albina SHEHU[2]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

[2]*Klinikë Dentare Private, Tiranë*

Abstrakt

Periodontiti agresiv është një sëmundje me zhvillim të shpejtë, që haset në pacientë të shëndetshëm në aspektin sistemik. Në dallim nga format e tjera të sëmundjes periodontale, në këtë sëmundje vihet re një humbje e shpejtë kockore, e cila nis në moshë të re. Plani i përgjithshëm i trajtimit të kësaj patologjie synon të krijojë një kuadër klinik, për të ruajtur sa më shumë dhëmbë për sa më shumë kohë.

Qëllimi: Menaxhimi i sëmundjes dhe ruajtja e dhëmbëve të pacientit nëpërmjet një protokolli terapeutik të thjeshtë, të ndihmuar nga aplikacionet kompjuterike.

Materiale & Metoda: Case report; trajtimi i rasteve klinike.

Rezultate: Nëpërmjet protokollit të punës që ndjekim është arritur të parandalohet më tej dëmtimi i strukturës periodontale. Përdorimi i programeve kompjuterike për vlerësimin e nivelit kockor është i domosdoshëm, pasi humbja e kockës është treguesi më i rëndësishëm për statusin e sëmundjes. Më tej, sistemi kompjuterik i kartelës periodontale është një ndihmë suplementare.

Konkluzione: Periodontiti agresiv mbetet një sfidë për mjekun stomatolog. Sa më vonë të paraqitet pacienti në klinikë, aq edhe më të vogla janë mundësitë për ruajtjen e denticionit. Faktorë të rëndësishëm në ndërtimin e një plani terapeutik afatgjatë janë vlerësimi klinik i hollësishëm, vlerësimi radiografik pre/post terapi dhe faza e mirëmbajtjes. Gjithsesi, përkushtimi i pacientit mbetet element thelbësor në përcaktimin e prognozës.

Fjalë kyçe: periodontit agresiv, trajtimi, dentistri dixhitale.

60. RËNDËSIA KLINIKE E KANALEVE MANDIBULARE BIFID DHE TRIFID

Dr. Bisela ASLLANAJ

Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë
Departamenti i Kirurgjisë Oro-Maksilofaciale

Abstrakt

Sfondi: Kanalet mandibulare me bifid (BMC) dhe trifid janë variacionet të anatomisë normale me incidencë që varionë nga 0. 08% në 65. 0%. Variacione të tilla kanë një ndikim të rëndësishëm klinik.

Shpjegimi për një anestezi jo të mjaftueshme mandibulare mund të shpjegohet me një kanal shtesë mandibular, sidomos kur janë të përfshira dy foramina mandibulare. Për më tepër, gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale në mandibul, një paketë neurovaskulare e dytë apo e tretë mund të dëmtohet duke shkaktuar parestezi, neuromë ose hemoragji.

Rasti klinik: Në këtë artikull janë paraqitur dy raste klinike. Një pacient kishte një kanal bifid në të dy anët e mandibulës, dhe pacienti tjetër kishte një kanal bifid në një anë dhe një kanal trifid në anën tjetër.

Diskutime: Vlerësimi fillestar për praninë e kanalit mandibular bifid ose trifid mund të bëhet nga një grafi panoramike. Në rastin e një kirurgjie në mandibulë mund të duhet një ekzaminim shtesë i tipit skaner.

Fjalët kyce: nervi alveolar inferior, kanali mandibular bifid, kanali mandibulae trifid, trajtimi kirurgjikalë.

61. ALERGJIA NGA REZINA DHE NGACMIMET E MUKOZËS NË TË PROTEZUARIT ME PROTEZA TË LËVIZSHME

Std. Eris KOTORRI, Prof. Asc. Edit XHAJANKA, Dr. Koço GJILO, Dr. Endrit PAPARISTO

Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Shpesh në pacientët me proteza të lëvizshme hasen ankesa për diskomfort të mukozës nën protezë, si djegie, kruarje, skuqje, etj. Vihet re një tendencë në rritje për t'ia atribuar këto simptoma alergjisë nga rezina e protezës.

Qëllimi: Vlerësimi i diagnozës në rastet e referuara si "alergji nga rezina e protezës" dhe përcaktimi i shkaktarëve të këtij fenomeni.

Materiale & Metoda: Gjatë 5 viteve të fundit u ekzaminuan dhe u ndoqën 71 pacientë pranë Klinikës Stomatologjike Universitare, me diagnozë paraprake "alergji nga rezina e protezës". U bë ekzaminim i protezës mbi cilësinë e përgatitjes, vjetërsinë, ribazimin, mirëmbajtjen, llojin e rezinës së pllakës së protezës (rozë ose transparente). U bë ekzaminim mikrobiologjik në raste të dyshuara për kandidozë, konsulta me specialistët përkatës në raste të dyshuara për sëmundje. sistemike;

Rezultate & Diskutime: 55 pacientë kishin protezë më te vjetër se 5 vjet; 23 pacientë – ribazime; 27 pacientë – proteza transparente. Rezultatet e studimit tonë janë në mbështetje të hipotezës se alergjia nga rezina e protezës është një fenomen shumë i rrallë. Risku më i lartë i shfaqjes së alergjisë është nga proteza të përgatitura jashtë standarteve, ose nga përdorimi i rezinave autopolimerizuese. Shkaqe të shpeshta janë kandidoza, higjena jo e mirë, diabeti, anemia, hiposalivacioni, faktorë psikogjenë si menopauza; irritimi nga monomeri i lirë.

Konkluzione: Alergjia nga rezina e protezës është shumë e rrallë dhe shkaktohet nga ngjyruesi i rezinës. Përgatitja e protezave duke respektuar rigorozisht kërkesat teknologjike të polimerizimit është domosdoshmëri dhe parandalon lindjen e alergjisë ose irritimit nga monomeri në shumicën e pacientëve edhe patch-test pozitiv.

62. HIPERPLAZIA E GINGIVËS: DIAGNOZA DIFERENCIALE DHE PËRMBLEDHJE E LITERATURËS

Dr. Eriselda SIMONI[1], Prof. Asc. Merita BARDHOSHI[2]

[1]*Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë*

[2]*Fakulteti i Mjekësië Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Hiperplazia (rritja) gingivare është një nga veçoritë më të shpeshta të sëmundjeve gingivare. Megjithatë, për shkak të shfaqjes në forma të ndryshme, vendosja e diagnozës është mjaft e rëndësishme për klinicistin. Ato mund të klasifikohen sipas etiopatogjenezës, lokalizimit, përmasave, shtrirjes, etj. Një diagnozë diferenciale

e bazuar në literaturën e njohur dhe eksperiencën klinike na çon në diagnozën përfundimtare ose në përjashtimin e saj. Vendosja e diagnozës së saktë është thelbësore për këto patologji, pasi trajtimi dhe prognoza ndryshon nga një patologji në tjetrën. Madje në disa raste, ku lezioni gingival është shenja fillestare e një patologjie sistemike, vendosja korrekte e diagnozës mund t'i shpëtojë edhe jetën pacientit, pasi çon në trajtim të hershëm të patologjisë sistemike. Qëllimi i këtij punimi është të nënvizojë veçoritë e tipeve të ndryshme të lezioneve gingivare, për të ndihmuar mjekun të bëj dallimin midis tyre. Madje mund të ketë ende disa lezione që paraqiten në mënyrë të pazakontë, për të cilët sfida është edhe më e vështirë. Duke njohur format e zakonshme dhe të rralla të lezioneve është më e lehtë për të formuluar një diagnozë diferenciale të lezionit gingivar të lokalizuar (i izoluar, diskret, regjional), ose të gjeneralizuar.

Fjalë kyçe: diagnozë diferenciale, hiperplazia gingivare, rritja gingivare, vendimarrje.

63. TERAPIA INTERCEPTIVE E MALOKLUZIONIT TË KLASËS SË II-TË ME ANË TË HEADGEAR – RASTE KLINIKE

Dr. Evisi BESHIRI NASTASI[1], Dr. Yllka ABAZI[1], Dr. Franceska VINJOLLI[1]

[1]*Klnika Universitare "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë*

Abstrakt

Kloehn konfirmoi përdorimin e headgear cervikal edhe në rastet kur duam të frenojmë rritjen e maksilës. Forcat të cilat duhet të përdorim gjatë trajtimit me headgear janë si në vijim: Forca të lehta prej 150-250 gr. për anë, të cilat mund të sjellin një distalizim të dhëmballëve të sipërme; Forca të rënda prej 450-500 gr. për anë, të cilat mund të prodhojnë një efekt skeletik, ose mund të përdoren për të ankoruar pjesën e maksilës posteriore.

Qëllimi: Korrigjimi sagital i raportit molar në klasë të I-rë; Drejtimi korrekt i rritjes së maksilës; Korrigjimi i overbite dhe zvogëlimi në vlera normale i overjetit; Përmirësimi i indeve të buta dhe estetikës; Vendosja në harmoni e inklinimit të dhëmbëve dhe koordinimi i rregullt i harkadave; Gjetja e hapësirës për kaninin, në rastin kur kemi humbje ankorimi.

Raste klinike: Rastet klinike prezantohen me një malokluzion të klasës së dytë, ndarja e parë në grupmoshën 9-12 vjeç. Ata paraqiten me një protruzion të maksilës dhe

një vestibularizim të incizivëve të sipërm. Problematika e ritensionit të kaninëve të sipërm ndodh shpesh, nga një humbje e parakohshme e dhëmballëve të qumështit. Pacientët e trajtuar me headgear kanë patur një bashkëpunim maksimal. Mbas 11 deri 12 muaj në fazë aktive me head gear, në disa raste u vazhdua me terapinë fikse për të drejtuar e niveluar harkadat.

Konkluzione: Me anë të trajtimit të parakohshëm mund të arrijmë në një përmirësim të estetikës dhe në një zgjidhje të dukshme të pozicionimit të buzës së sipërme me atë të poshtme. Mbas trajtimit u arrit një raport i klasës së parë, në nivel të kaninëve e molarëve. Gjithashtu, u reduktua overjet dhe u normalizua overbite. Vlerat cefalometrike tregojnë një përmirësim domethënës në nivelin skeletal dhe dental. Vihet re një zvogëlim i këndeve ANB, SNA, Inc. sup^PF dhe IMPA. Terapia me headgear tregoi një efekt pozitiv në distalizimin e molarëve të pare, në nivel të maksilës dhe ndryshime të dukshme në frenimin e zhvillimit të saj.

64. VLERËSIMI I EFIKASITETIT TË DY PROTOKOLLEVE TË NDRYSHME IRRIGIMI PËRPARA OBTURIMIT TË KANALIT TË RRËNJËS

Dr. Florjan ZOTO[1], Prof. Dr. Andi KORAQI[2], Dr. Orsjola NIKA[1], Dr. Odeta ZOTO[3]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

[2]*Fakulteti i Mjekësisë,Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

[3]*Klinikë Dentare Private, Tiranë*

Abstrakt

Bakteriet luajnë rolin etiologjik kryesor në zhvillimin e patologjive endodontike. Objektivi ideal i trajtimit endodontik të sistemit të kanaleve të rrënjës është sterilizimi i kanalit, pra një kanal pa bakterie në kohën e obturimit.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë efikasitetin e dy protokolleve të ndryshme irrigimi (Grupi I – NaOCl 3% dhe Grupi II – NaOCl 3% + EDTA 17% + CHX 2%), në përpunimin kimik të sistemit të kanaleve të rrënjës, në diagnozat e periodontitit apikal asimptomatik primar dhe periodontitit apikal asimptomatik sekondar (ritrajtimeve endodontike).

U analizuan 116 raste trajtimesh intrakanalare të patologjive endodontike: periodontite apikale primare dhe periodontite apikale sekondare (ritrajtime endodontike), me dy

protokolle të ndryshme irrigimi për secilin grup. Pacientët u përzgjodhën me një shpërndarje rastësore, sipas paraqitjes së tyre në klinikë.

Vlerësimi i efikasitetit të dy protokolleve të irrigimit, u përcaktua nëpërmjet matjes së ngarkesës bakteriale, me anë të metodës me kultivim, përpara dhe pas preparimit kimiko-mekanik të sistemit të kanaleve të rrënjës.

Protokolli me kombinim të irrigantëve tregoi rezultate superiore ndaj grupit me protokollin e irrigimit vetëm me anë të NaOCl 3%, në rastet e ritrajtimeve endodontike, përsa i përket kulturave pozitive në kanal para obturimit. Gjatë trajtimit të patologjive endodontike për të ndihmuar në suksesin e trajtimit, duhet të vihet theksi në procedurën e dezinfektimit kimik të kanalit, si një fazë mjaft e rëndësishme që ndikon direkt në rezultatin e trajtimit endodontik.

Rekomandohet përdorimi i një protokolli irrigimi të kombinuar, pasi asnjë irrigant i vetëm nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat e një irriganti ideal endodontik.

65. NDJEKJA DHE MIRËMBAJTJA E PACIENTIT IMPLANTAR

Dr. Gresa BABOÇI

Klinikë Dentare Private, Tiranë

Abstrakt

Diferencat në strukturat e suportit bëjnë që implantet dentare të jenë më të ndjeshëm ndaj inflamacionit dhe rezorbimit kockor, krahasuar me dhëmbët natyralë. Për këtë arsye implantet kanë nevojë për monitorim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme, që përfshin kontrollin e shëndetit oral dhe të përgjithshëm të pacientit, mirëmbajtjen profesionale të implanteve dhe një kujdes të veçantë të pacientit në kushte shtëpie. Sugjerohet që vizitat periodike në klinikë të bëhen çdo 3 muaj për vitin e parë, pas vendosjes së implantit dhe çdo 12 muaj për vitet në vazhdim. Këto vizita duhet të përfshijnë: grafi intraorale të implanteve, sondazh të sulkuseve, kontroll për prani të pllakave bakteriale supra dhe sub gingivale, prani inflamacioni të indeve rrethuese, vlerësim të stabilitetit/mobilitetit dhe kontroll të okluzionit. Higjiena profesionale në klinikë duhet të bazohet në përdorimin e instrumentave manualë, apo majave ultrasonike jo metalike, si: instrumenta plastike të përforcuar me grafit ose instrumenta metalikë të larë në ar. Përsa i përket përdorimit të air-flow në literaturë ka polemika. Disa autorë kanë hedhur dyshime mbi faktin se pluhuri abraziv i air-flow mund të shkaktojë dëme në sipërfaqen e titaniumit dhe se presioni i lartë i ajrit mund të çojë në shkëputje të indeve të buta nga implanti, duke provokuar enfizema. Duke qenë se numri i pacientëve që kërkojnë implante dentare është në rritje, bëhet

gjithmonë e më e rëndësishme për dentistin të njohë diferencat midis kujdesit të dhëmbëve natyralë dhe kujdesit të implanteve, e të pranojë sfidat e mirëmbajtjes së këtyre restaurimeve.

66. EFEKTI I TEPARISË KONSERVATIVE PERIODONTALE TEK PACIENTËT ME SËMUNDJE SISTEMIKE

Dr. Ilma ROBO, Prof. Dr. Vera OSTRENI, Dr. Fjona HAMZAI, Dr. Saimir HETA

Albanian University, Departamenti i Stomatologjisë, Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Terapia periodontale konservative pavarësisht etapave mëse të përcaktuara të protokollit të punës, shprehet me rezultatet klinike që variojnë nga sëmundjet sistemike, graviteti dhe kontrolli i pacientit ndaj tyre. Këto rezultate janë të matshme dhe të kontrollueshme klinikisht, madje janë edhe si vlerësuese të stadeve të ndryshme të agravimit apo përmirësimit të sëmundjeve.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i rezultateve klinike të terapisë jokirurgjikale periodontale, në mënyrë të veçantë tek pacientët kardiakë, diabetikë, nefropatë dhe gastrointestinalë. Prezantimi klinik i sëmundjeve nga të cilat vuajnë këta pacientë, pasohet nga përzgjedhja e disa prej tipologjive të pacientëve sipas klasifikimit më lartë, ndjekur nga vlerësimi i dokumentuar i statusit periodontal para dhe 1 javë pas trajtimit periodontal jokirurgjikal të pacientit.

Materiale dhe Metoda: Studimi u realizua në 311 pacientë në total, prej të cilëve 206 ishin të sëmurë të përfshirë në vlerësim. Nga këta, të përfshirë në studimin tonë: 80 ishin pacientë kardiakë, 76 pacientë diabetikë, 43 pacientë nefropatë, 7 pacientë gastrointestinalë, pasi plotësonin kriteret e përfshirjes. Pacientët e përfshirë në studim janë ndarë sipas moshës, gjinisë dhe statusit socio-shëndetësor.

Rezultate: Nga rezultatet vihet re vonesa në shërim tek pacientët diabetik, të plagëve në kavitetin oral. Sasia minimale e pllakës bakteriale tek pacientët me sëmundje gastrointestinale është elementi më tipik i kësaj kategorie. Shfaqja e hipertrofive gingivale tek pacientët me hypertension, të trajtuar me kalçibllokuesit dhe ngjyrimet më të zbehta të gingivave, gjatë trajtimit të pacientëve nefropatë janë elementet tipike, të hasuara tek kategoria përkatëse e pacientëve. Prekshmëria e pacientëve kundrejt kombinimeve të sëmundjeve që ndjekin dhe nxisin njëra-tjetrën, ishte më e lartë tek lidhja pacientë kardiakë dhe diabetikë, sesa tek lidhja pacientë nefropatë dhe diabetikë. Pacientët kardiakë nëse flasim për procesin e shërimit, në vlera të sondimit,

reagonin më ngadalë, sesa pacientët diabetikë. Ky element duhet të ndiqet më tej, nga analizimi i mëtejshëm i faktorëve risk që kanë këto kategori, kundrejt shfaqes së sëmundjeve periodontale.

Konkluzione: Indeksi i hemoragjisë shprehte reduktime të ndjeshme gjatë procesit të shërimit, në rend zbritës. Më të lartë ishin ndryshimet tek pacientët diabetikë, më pas tek pacientët gastrointestinalë, nefropatë dhe të fundit ishin pacientët kardiakë. Sëmundjet sistemike kanë lidhje të drejtpërdrejtë me statusin periodontal të pacientëve të prekur prejt tyre. Kjo lidhje është e ndërsjelltë, pasi ashtu si sëmundjet sistemike shkaktojnë sëmundje periodontale, edhe sëmundjet periodontale shkaktojnë sëmundje sistemike, që madje rrezikojnë edhe jetën e pacientit.

Fjalë kyçe: diabet, sëmundje kardiovaskulare, gastrointestinale, nefropati, terapi periodontale.

67. PROTEZAT DENTARE ELASTIKE: NJË ZGJIDHJE ALTERNATIVE PËR PACIENTËT ME PROTEZA AKRILIKU (STUDIM KLINIK)

Dr. Ilvia TABAKU ALIMEHMETI

Klinikë Dentare Private, Tiranë

Abstrakt

Humbja e dhëmbëve që mund të vijë nga traumat, prishje të dhëmbit, sëmundje të mishrave, patologji të përgjithshme etj, përbën shqetësim si nga ana psikologjike dhe estetike, ashtu edhe fonetike dhe funksionale. Zëvendësimi i dhëmbëve të humbur është i domosdoshëm, që të rregullohet defekti dhe të rikthehet funksioni në mënyrën sa më të mirë të mundshme. Prej vitesh, polimetil metakrilati është përdorur për përftimin e protezave dentare. Këto lloj protezash kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Disa prej problematikave me protezat e akrilikut janë vështirë të adresohen, siç janë, inserimi në zonat retentive, thyeshmëria (brishtësia) e metil metakrilatit, e cila bëhet shkak për fraktura, si dhe alergjia nga monomeri i metil metakrilatit. Me prezantimin e protezave të reja me material bazë prej derivateve të najlonit, që në 1950, iu hap rruga protezave të reja elastike. Ato sigurojnë jo vetëm një estetikë të mirë, por edhe përshtatje dhe adaptim më të mirë, në pacientët me mungesa të pjesshme.

Materiale & Metoda: 50 pacientë me mungesë të plotë dhe të pjesshme të dhëmbëve u përfshinë në studim. Mosha e pacientëve ishte nga 30-80 vjeç, prej të cilëve 32

ishin meshkuj dhe 18 femra. Këto raste të përzgjedhura ishin me proteza ekzistuese prej akriliku dhe me pakënaqësi ndaj tyre. Studimi u krye në dy klinika private, në një hark kohor 5 vjeçar (rastet e përfshira në studim kanë minimumi 2 vite që janë adaptuar me protezat e reja prej najloni). Ndër problematikat kryesore në protezat konvencionale prej polimetil metakrilati përmendim: irritime në mukozë, erë e keqe nga goja, vështirësi në heqje dhe rivendosje të protezës, thyerje të shpeshta, etj. Së bashku me miratimin e pacientëve për të marrë pjesë në krahasimin e eksperiencës me protezën e re u analizua edhe një pyetësor. Të gjitha rastet u vlerësuan për këto parametra: halitoza, irritimi mukozal, lehtësia në inserim dhe heqje të protezës, shpeshtësia e frakturave apo krisjeve, si dhe rehatia gjatë funksionimit të protezës.

Rezultate: Pacientët u paraqitën në klinikë në intervale të rregullta rikontrollesh. Vetëm 10 raste rezultuan me halitozë (20%) dhe 7 me acarime mukozale (14 %). Pjesa tjetër e pacientëve përfshirë në studim ishin shumë të kënaqur me protezën e re. Për analizimin dhe llogaritjen e rezultateve u përdor një test jo i bazuar në parametra të paracaktuara (ankesat e marra nga pacientët), por llogaritje statistikore hipotetike, e përdorur për të krahasuar dy modele (materiali bazë akriliku dhe najloni), që lidhen me një subjekt (proteza dentare). Pjesa më e madhe e pacientëve në studim ishin shumë të kënaqur me cilësitë dhe funksionimin më të mirë të strukturave oro faciale me protezën e re. Studime klinike me tematikë dhe fokus të njëjtë janë kryer dhe në vende të lindjes (Indi). Në krahasim me studimin tonë pacientët që i janë përgjigjur pyetësorit ishin 100% të kënaqur me protezën e re elastike, ndërsa në studimin tonë 98%. Probleme me teknikën e përgatitjes së protezës së najlonit janë vënë re në studime paralele, që kanë shkaktuar shkëputje të dhëmbëve nga proteza (gjë e cila tek ne nuk ka ndodhur).

Konkluzione: Brenda kufijve të studimit tonë konkludojmë që gjenerata e re e materialeve me bazë najloni ka një performancë më jetëgjatë. Megjithatë rekomandojmë studime edhe më të thelluara dhe jetëgjata me këtë fokus.

68. MENAXHIMI I INFEKSIONEVE TË HAPËSIRËS SË THELLË TË QAFËS

Dr. Jakup VRIONI, Dr. Renato ISUFI, Prof. Dr. Ramazan ISUFI

Departamenti i Kirurgjisë OMF, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT

Abstrakt

Njohuritë për menaxhimin e infeksioneve të llozhave të thella të qafës janë të domosdoshme në praktikën e përditshme të kirurgut oral dhe maksilofacial. Vendimet për menaxhiminin e tyre duhet të merren në varësi të përparimit të

sëmundjes. Ndërhyrjet për menaxhimin e tyre kërkojnë aftësi të mira kirurgjikale. Kirurgu duhet të vendosi për menaxhimin mjekësor dhe kirurgjikal të tyre, ku përfshihet përzgjedhja e antibiotikëve, kur të ndërhyhet, çfarë procedure të bëhet dhe si të sigurohen rrugët e frymëmarrjes. Për të marrë këto vendime kirurgu duhet të njohë mirë anatominë e regjionit, etiologjinë e infeksionit dhe menaxhimin mjekësor dhe kirurgjikal. Komplikacionet më të rënda të këtyre infeksioneve mund të jenë trombozë e venës jugulare, thyerje e arteries karotis dhe mediastinit.

Fjalë kyçe: Infeksion, llozha të thella të qafës, menaxhim kirurgjikal.

69. DËMTIMET E PROTEZAVE TË LËVIZSHME NË PËRDORIM

Dr. Kaltrina BEQIRI, Dr. Shk. Sherif SHAQIRI

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Maqedoni

Abstrakt

Qëllimi: Studimi ynë do të tregojë llojin dhe frekuencën e dëmtimeve të protezave dentare të lëvizshme në përdorim dhe do të përcaktojë korelacionin mes tyre.

Materiale & Metoda: Në studim kanë marrë pjesë 246 pacientë, të cilët janë paraqitur në klinikën tonë dentare, me ankesa mbi dëmtimet e protezave të tyre në përdorim. Nga totali i pacientëve 65. 85% ishin meshkuj dhe 34. 15% ishin femra. Mosha e tyre varionte nga 41-77 vjeç, me një mesatare prej 61. 7 vjetësh. Të dhënat e fituara janë hedhur në kartela të posaçme dhe të përpiluara sipas OBSH-së, të adaptuara dhe të modifikuara për natyrën e studimit tonë dhe veçmas për çdo pacient.

Rezultate: Rezultatet e fituara tregojnë se ankesat për dhëmbë të humbur janë në përqindje më të lartë (38. 62%), të ndjekura nga mungesa e pjesëve të protezave të dëmtuara me 12. 19%, ndërsa thyerja e skeletit është në përqindje më të ulët (3.6%).

Konkluzione: Bazuar në rezultatet mbi shkaktarët e dëmtimit të protezave në përdorim arrijmë në përfundimin se:

- Mosrespektimi i afateve për konsolidimin e kockës të kreshtave hojëzore, ndikon që gjatë përtypjes të shkaktohen dëmtimet e protezave dentare të lëvizshme.
- Pakujdesia e pacientëve për pastrimin e protezave të lëvizshme ndikon drejtpërdrejtë në dëmtimin e tyre. Parafunksionet luajnë rol me rëndësi në dëmtimin e protezave dentare të lëvizshme.

Fjalë kyçe: Protezat e lëvizshme, dëmtim i protezave, frekuenca, korelacioni.

70. HUMBJA E PARAKOHSHME E DHËMBËVE TË QUMËSHTIT DHE PASOJAT NË HARKADË

Dr. Klaudia FRROKU, Dr. Rozela XHEMNICA

Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Humbja e dhëmbëve të qumështit para kohe sjell një sërë pasojash në harkadë, kështu që theksimi i situatës për gjendjen orale te fëmijët është i rëndësishëm për të dhënë alarmin. Ai do të sjellë parandalim, kurim dhe promovim kundrejt kësaj grupmoshe.

Qëllimi: Qëllimi kryesor është të evidentohet frekuenca e humbjeve para kohe të dhëmbëve të qumështit, si dhe të dhëmbëve të kariuar në më shumë se ¾ e kurorës, si potencial i lartë për humbjen parakohe të këtyre dhëmbëve. Duam gjithashtu të realizojmë përcaktimin e dhëmbit, që është më shpesh i humbur parakohe, apo me karies në më shumë se ¾ e kurorës.

Materiale & Metoda: U morën në studim 180 të grupmoshës 6-7 vjeç, në shkollat fillore të Tiranës. U përdorën doreza njëpërdorimshe dhe dritë e fortë ekzaminimi. U morën shënime mbi humbjet para kohe të denticionit të përkohshëm, si dhe të dhëmbëve të kariuar si potencial i lartë për humbjen para kohe të tyre.

Rezultate & Konkluzione: Për totalin e pacientëve mbizotëron 4H në 87 (35. 2%) të gjetjeve, ndjekur nga 5H në 47 (19%) të gjetjeve, (p<0. 01). Edhe sipas gjinisë, mbizotërojnë po këto gjetje në përqindje, pothuajse të njëjta si tek vajzat dhe tek djemtë, pa ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p=0. 4). Në Kuadratin e I dhe të II mbizotërojnë 4H, përkatësisht 44. 2% dhe 46. 9%, ndërsa në Kuadratin e III dhe të IV mbizotërojnë 5H, përkatësisht 20. 3% dhe 21%, me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p<0. 01).

71. ERGONOMIA DHE MENAXHIMI NË PERFORMANCË DHE PARANDALIM

Dr. Kreshnik ÇOTA

Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT

Abstrakt

Qëllimi: Ergonomia dentare paraqitet tashmë si një shkencë e konsoliduar dhe

merr hapësirë gjithnjë e më të madhe në praktikën e përditshme profesionale, si rrjedhojë e avantazheve që ofron aplikimi i koncepteve të saj. Qëllimi i këtij punimi është rivlerësimi i protokolleve, falë të cilave arrihet menaxhimi i duhur i strukturës ambulatore dhe performancës së dhënë përgjatë ndërhyrjeve dentare. Ndër të tjera vlen për t'u nënvizuar parandalimi i faktorëve iatrogjenik, si tek pacienti po ashtu dhe tek vet kliniku. Zgjodha të shtjelloj këtë tematikë, pasi akoma sot edhe pse ergonomia dhe efektet pozitive që kjo shkencë mundëson janë të njohura për të gjithë, shpeshherë lihen në harresë në performancën e përditshme terapeutike.

Materiale & Metoda: Metodologjia e ndjekur bazohet në idetë e fituara nga studime pasuniversitare, së bashku me një review të artikujve shkencorë në PubMed. Materiali klinik u mundësua nga puna dhe rezultate klinike të fituara në vite nga këto protokolle, në grupmosha të ndryshme pacientësh, me nivele të ndryshme bashkëpunimi.

Rezultatet & Konkluzione: Avantazhet e fituara falë zbatimit rigoroz të protokolleve të parashtruara konceptualisht nga ergonomia dentare, nënvizojnë rëndësinë e veçantë që paraqet kjo shkencë. Falë rezultateve inkurajuese të fituara, nëpërmjet studimeve analitike, si në performancë dhe në parandalim, u krijuan kushte të përshtatshme për të avancuar drejt një protokolli operativ korrekte dhe efikas. U arrit në përfundimin se respektimi i protokollit ergonomik sjell avantazhe cilësore dhe sasiore në performancat proceduriale dentare, në parandalimet iatrogjenike dhe faktorët jetik të klinikut.

72. TRAJTIMI JO-KIRURGJIKAL I ANOMALISË SË KLASËS III. RASTE KLINIKE

Dr. Manjola GUSHO, Prof. Dr. Xhina MULO, Dr. Fatmir LELA, Dr. Edlira SUBASHI

**Fakulteti i Mjekësisë Dentare,Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Anomalia e klasës së III është një sfidë për sa i përket trajtimit ortodontik. Jo të gjithë pacientët me anomali të klasës së III janë kandidatë për ndërhyrje kirurgjikale. Trajtimi ortodontik nëpërmjet kamuflimit tek disa pacientë me klasë të III skeletike, të lehtë ose të moderuar, mund të arrihet dhe nëpërmjet disa alternativave trajtimi ortodontik me aparate fikse. Rastet klinike paraqesin trajtim jo-kirurgjikal të anomalisë së klasës së III, mbështetur në protokolle trajtimi të thjeshta me aparate fikse, me sistemin self-ligating. Në fund të trajtimit kemi arritur të përmirësojmë dukshëm profilin dhe estetikën e pacientit.

Qëllimi: Ky prezantim ka për qëllim të tregojë protokollin e plotë të trajtimit të disa rasteve klinike me anomali të klasës së III skeletale, tek pacientë adoleshentë, me

potencial rritjeje. Rastet klinike të përzgjedhura paraqesin harqe me grumbullime dentare, kafshim të kryqëzuar në zonën frontale, në zonën distale, si dhe kompensime dentare në maksilë dhe mandibulë. Profili i pacientëve është konkav me kombinim retruziv të maksilarit dhe protruzion të mandibulës.

Materiale & Metoda: Trajtimi ortodontik tek të gjithë pacientët është trajtim me një fazë të vetme, me anë të aparateve fikse, sistemit self-ligating. Është bërë përzgjedhja e torque që në fillim të trajtimit, janë përdorur elastikë të lehtë që në momentin e aplikimit të aparatit, si dhe harqe high-tech CuNiTi. Koha mesatare e trajtimit varion në 24-26 muaj.

Rezultate: Tek të gjitha rastet klinike, harqet dentare u zgjeruan mjaftueshëm për rreshtimin e dhëmbëve. Kryqëzimet dentare frontale dhe distale u zgjidhën me sukses. Nuk lindi nevoja për ekstraksione dentare, dhe u përdor stripping në harkun mandibular. Profili i pacientëve u përmirësua dukshëm.

Konkluzione: Çelësi i suksesit qëndron tek përzgjedhja e duhur e rasteve klinike, duke bërë dallimin e anomalisë së klasës së III, e cila mund të trajtohet në mënyrë të suksesshme me trajtimin ortodontik, në ato raste kur zgjidhjen e kanë tek kirurgjia ortognatike. Mosha e pacientit është një nga elementët kyç në suksesin e trajtimit. Vlera e Wits si dhe profili i pacientit përbëjnë parametrat thelbësorë për suksesin e trajtimit.

Fjalë kyçe: Klasë e III skeletike, kamuflim ortodontik, kafshim i kryqëzuar, kirurgji ortognatike.

73. MËNYRAT E SHTRESËZIMIT TË KOMPOZITIT NË DHËMBËT FRONTAL

Dr. Mentor SMAILAJ

Klinikë Dentare Private, Prizren (Kosovë)

Abstrakt

Në këtë prezantim do të sqarohet mënyra e shtrësimit të kompozitit në dhëmbët frontal në rastet e frakturave, kariesit dhe në punimet e fasetave direkte me komposit. Nga ana tjetër, do të sqarohet gjithashtu se si duhet ta studiojmë rastin paraprakisht me anë të fotografisë dentare dhe se si realizohet ajo. Do të referohen raste klinike me anë të të cilave do të prezantohet teknika shtresë pas shtrese, imitimi i morfologjisë dhe histologjisë së dhëmbit në shtresat e tij përmes kompozitit dhe instrumentari, të cilin përdorim.

Ky prezantim ka për qëllim të sqarojë rëndësinë e teknikës Layering në mënyrë që restorimet dentare me komposit në dhëmbët frontal të jenë sa me praktike të qëndrueshme dhe po ashtu të jenë sa më natyrale dhe të padallueshme.

74. SUKSESI I PROTEZAVE TOTALE, INVESTIGIM I DETAJUAR I PROTOKOLLEVE, SKEMAVE OKLUZALE DHE PYETËSORËVE TË VLERËSIMIT

Dr. Neada HYSENAJ, Prof. Asc. Edit XHAJANKA, Prof. Asc. Merita BARDHOSHI

Klinika Stomatologjike Universitare, Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Abstrakt

Hyrje: Suksesi në protezat tradicionale mund të vlerësohet nëpërmjet kritereve subjektive dhe objektive. Si faktorë determinues në suksesin e protezave mund të përmendim: cilësinë e protezave, gjendjen e formacioneve anatomike, marrëdhënien pacient-mjek, qëndrimi i pacientit përkundrejt punimeve protetike të lëvizshme, personaliteti i pacientit, faktorët socio-ekonomik.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është identifikimi dhe analiza e protokolleve të ndryshëm të realizimit të protezave dhe skemave okluzale që mund të kontribuojnë në suksesin e protezave, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit.

Materiale & Metoda: U realizua një kërkim i literaturës, nëpërmjet databazës elektronike Pubmed, duke përdorur si fjalë kyçe: konstruktimi i protezave totale, fabrikimi i protezave totale, okluzioni i protezave totale, skema okluzale e protezave totale.

Rezultate: Nga studimet e analizuara nuk u identifikuan ndryshime të rëndësishme ndërmjet metodave të konstruktimit të protezave: të thjeshtë, tradicionale, CAD-CAM. Gjithashtu nuk u gjetën diferenca të rëndësishme në studimet që krahasonin protezat e konstruktuara me okluzion të balancuar bilateral, të lingualizuar, monoplan apo të guiduar nga kanini.

Konkluzione: Brenda limiteve të këtij studimi mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme: a)Pacientët përshtaten me të gjitha metodat e konstruktimit të protezave, kur respektohet rigorozisht zbatimi i protokollit, b)Protokollet e thjeshtuara të konstruktimit ofrojnë kosto më të ulët dhe kohë më të shkurtër të fabrikimit të protezave, c) Pacientët përshtaten lehtë me çdo okluzion të skemës bilaterale të

bilancuar, d) Okluzioni i lingualizuar siguron stabilitet dhe performancë mastikatore më të mirë në pacientët me kreshtat reziduale shumë të rezorbuara.

Fjalët kyçe: Proteza totale, protokolli i konstruktimit, CAD CAM, skema okluzale, okluzion i lingualizuar, pyetësor, OHRQoL.

75. SI NDIKON PREPARIMI MINIMAL INVAZIV NË LIDHJEN E QERAMIKËS ME INDET E FORTA TË DHËMBIT – STUDIM EKSPERIMENTAL

Dr. Rozafa DRAGUSHA

Klinikë Dentare Private, Tiranë (Shqipëri)

Abstrakt

Adezioni ka influencuar thellësisht në stomatologji, duke e transformuar atë në një dentistri minimale invazive. Kufijtë e kësaj dentistrie janë studiuar gjerësisht, duke e vënë fokusin në indet e dhëmbit dhe tek materialet dentare. Është i pranishëm një skepticizëm në lidhje me faktin nëse ruajtja indore shoqërohet me forcë më të madhe lidhëse. Pjesa më e madhe e autorëve, në lidhje me preparimet minimale invazive, sugjerojnë preparimin e smaltit sipërfaqësor për të patur një forcë lidhëse më të madhe.

Qëllimi: Studimi eksperimental invitro kishte për qëllim të krahasonim forcën lidhëse në shkëputje (SBS) të një qeramike të presuar mbi smaltin e papreparuar, smaltin e preparuar dhe në dentinë.

Materiale & Metoda: Nga 284 dhëmbë të mbledhur, 149 u përzgjodhën si përplotësues të kritereve të përzgjedhjes: kurorë intakte, mungesë kariesi dhe mungesë restaurimi. Secili dhëmb iu nënshtrua matjeve të SBS, të cementimit adeziv të një cilindri qeramike të presuar në tre thellësi preparimi. Nivelet e thellësisë së preparimit ishin: smalt sipërfaqësor i papreparuar, smalt i preparuar dhe preparim në dentinë. Vetëm 136 dhëmbë (57A dhe 79P) mundën të kalonin të treja situatat e matjeve dhe rezultatet e tyre u përdorën për krahasimin statistikor.

Rezultate: Testet e normalitetit treguan që shpërndarjet e vlerave të mbledhura nuk ishin normale, prandaj për të krahasuar grupet u përdor testi joparametrik Wilkoxon signed rank test. Mesatarja e SBS të qeramikës së cementuar ishte 13. 208 ± 9. 3303 MPa mbi smalt të papreparuar, 13. 210 ± 7. 9426 MPa mbi smalt të preparuar dhe 9.

984 ± 5. 8593 MPa mbi dentinë. Vlera më e lartë u mat mbi smaltin e papreparuar (48. 0 MPa), ndërkohë që vlera më e ulët u mat mbi dentinë (1. 2 MPa). Vlerat e SBS kishin diferencë të rëndësishme statistikore vetëm ndërmjet dentinës dhe dy thellësive të tjera (smalt i papreparuar p=0. 006 dhe i preparuar p=0. 002), ndërkohë që ndërmjet vlerave në smalt të preparuar dhe smalt të papreparuar nuk u gjet ndryshim i rëndësishëm statistikor (p=0. 534).

Konkluzione: Cementimi adeziv i qeramikës, me sistemet gdhend dhe shpëlaj tregoi që nuk kishte diferencë të SBS mbi smalt, të preparuar apo jo. Ndërkohë që, vlerat e SBS u reduktuan në mënyrë të rëndësishme statistikisht kur preparimi arriti në thellësinë e dentinës. Brenda limiteve të këtij studimi mund të konkludojmë që, duke ndjekur indikacionet e duhura klinike, ne duhet të jemi minimal invaziv duke qëndruar në smalt dhe mund të jemi maksimalisht konservativ, duke ruajtur të papreparuar smaltin sipërfaqësor.

76. VLERËSIMI KLINIK I NDIKIMIT TË SHKALLËS SË ERUPSIONIT TË DHËMBIT TË PJEKURISË NË NDËRLIKIMET E INFEKSIONEVE AKUTE

Dr. Seha MUSTAFAI, Dr. Kaltrina BEQIRI, Dr. Shk. Amet DEMIRI

Klinikë Dentare Private, Tetovë (Maqedoni)

Abstrakt

Qëllimi: Të përcaktojë praninë e një korrelacioni ndërmjet shkallës klinike dhe radiografike, të erupsionit të dhëmbit të pjekurisë dhe frekuencën e shkallës së ndërlikimit të infeksionit akut.

Materiale & Metoda: U kryen analiza në 297 pacientë (126 meshkuj dhe 171 femra), të moshës 16-56 vjeç. Ekzaminimi klinik dhe radiografik vërtetoi praninë e impaksionit të pjesshëm ose të plotë, të dhëmbit të pjekurisë. Analizat u kryen në një periudhë 24-mujore në pavionin e Kirurgjisë Orale, në Tetovë.

Rezultate: Numri i të anketuarve, ku me ekzaminim klinik rezultoi impaksion i pjesërishëm i dhëmbit ishin 219 raste (73,73%), nga të cilat 181 raste (82. 64%) kanë pasur shenja të infeksionit. Impaksion të plotë të dhëmbit janë regjistruar në 78 të anketuar (26,27%), ku 34 prej tyre (43,59%) ishin të infektuar. Pjesërisht të eruptuar, në 124 raste (68,51%) u paraqitën me infeksion të lehtë. Në mbi 60% të të gjithë të anketuarve me ndërlikime infektive u shoqëruan me shkallë më të lartë të eruptimit.

Shkalla më e lartë e eruptimit të dhëmbit të pjekurisë shkaktonte një infeksion të lehtë, në 124 raste (56. 62%) dhe në 57 raste (26,03%) u paraqitën forma më të rënda të infeksionit. Shkallë më të lartë erupsioni në nivelin e rrafshit okluzal tregoi dhëmbi i pjekurisë.

Konkluzione: Në 181 raste (82. 64%) të molarëve gjysëm të impaktuar mandibular ka pasur shenja të infeksionit. Shkallë më të lartë erupsioni në nivelin e rrafshit okluzal tregoi dhëmbi i pjekurisë.

Fjalë kyçe: dhëmbi i pjekurisë, impaksion, infeksione.

77. SKANERI NË STOMATOLOGJI - RASTE KLINIKE

Dr. Shk. Valbona DISHA[1], Dr. Nilena NASI[1]

[1]*Fakulteti i Stomatologjisë, Albanian University, Tiranë*

Abstrakt

Një nga qëllimet kryesore në stomatologjinë klinike është trajtimi i duhur i pacientëve, në të cilën përfshihet diagnoza dhe prognoza korrekte. Diagnoza është rezultat i vlerësimit të shenjave dhe simptomave të pacientëve dhe interpretimi ashtu si duhet i tyre. Në disa raste këto shenja mund të modifikohen nga një sërë faktorësh, si gjendja emocionale e pacientit, eksperienca e kaluar, grada e dëmtimit indor etj. Në këto raste diagnoza klinike bëhet e vështirë.

Në fazën e vendosjes së diagnozës mund të aplikojmë një sërë testesh. Skaneri në ditët e sotme po gjen një përdorim të madh në stomatologji, për shkak të saktësisë në zbulimin e lezioneve periapikale, krahasuar me ekzaminimet e tjera radiologjike, si panorameksin dhe radiografitë periapikale.

Ky punim paraqet karakteristikat klinike dhe trajtimin e dy rasteve klinike. Rasti i parë ishte me sinuzit dhe i dyti me infeksion periapikal. Në të dyja rastet klinike të paraqitura, skaneri luajti rol kyç në vendosjen e diagnozës dhe planin e trajtimit.

Fjalë kyçe: diagnoza, diferenciale, dhimbje dhëmbi, skaner.

78. ASIMETRIA NË ORTODONCI

Dr. Yllka ABAZI

Abstrakt

Qëllimi: Inkuadrimi korrekt i rasteve klinike që paraqesin asimetri funksionale, dentare dhe skeletale.

Materiale & Metoda: Nëpërmjet kërkimit të literaturës dhe prezantimit të rasteve klinike ofrohet një klasifikim i problematikës së asimetrisë, duke u referuar në mënyrë të veçantë etiologjisë, diagnozës dhe trajtimit ortodontik.

Rezultate: Etiologjia e asimetrisë është multifaktoriale, e cila nënkupton influencën gjenetike, kongjenitale apo atë të përfituar, që ndikojnë në realizimin e kësaj problematike. Ekzaminimi klinik, analiza radiografike, studimi i modeleve të allçisë ndihmojnë në përcaktimin e diskrepancës së linjave të mesme me origjinë dentare, funksionale apo atë skeletale, e cila ka vlerë për menaxhimin koherent të trajtimit ortodontik.

Konkluzione: Interceptimi i hershëm i asimetrisë riekuilibron rritjen harmonike të pacientit, duke eliminuar realizimin e një kuadri më të rëndë të këtij malokluzioni.

SESIONI 03

ABSTRAKTET POSTER

79. TRAJTIMI MULTIDISIPLINAR NË NJË PACIENT ME ANOMALI DENTOSKELETIKE SI PASOJË E TRAUMËS ME ARMË ZJARRI NË FËMIJËRI (PREZANTIM RASTI)

Dr. Irina ISUFI[1], Dr. Algen ISUFI[1,2], Prof. Dr. Ramazan ISUFI[1,2]

[1]*Klinikë Dentare Private, Tiranë*

[2]*Shërbimi i Kirurgjisë Oro-Maksilo-Faciale, QSUT "Nënë Tereza"*

Abstrakt

Pacienti M. D, 19 vjec i seksit mashkull u paraqit në klinikën tonë me shqetësimin primar zëvendësimin e mungesave dentare. Në ekzaminimin klinik, u vu re prania e një anomalie dentare dhe skeletike, mungesa e 21. 22, prania e defektit kockor në këtë rregjion, si dhe një cikatrice në rregjionin e këndit të mandibulës krahu i djathtë. Në anamnezë pacienti referon për traumë me armë zjarri në moshën 1 vjecare. Për vendosjen e diagnozës, u kryen ekzaminimet e nevojshme ekstra dhe intraoral, u morën masat për modelet e studimit, ekzaminimet radiologjike, panorameksi, grafia laterale dhe ajo posterior-anteriore, si dhe ekzaminimet suplementare si analiza e modeleve të studimit, cefalometria, fotografimi i pacientit dhe analiza e estetikës faciale. Pasi u vendos diagnoza, me miratimin e pacientit duke u konsultuar dhe me kirurgun maxillo facial u hartua plani i trajtimit ortodontiko kirurgjikal dhe ai për zëvendësimit protetik. Trajtimi ortodontik, konsistoj në ortodonci pre dhe postoperatore, krijimi i hapesirës së nevojshme për zëvendësimin protetik në maksilë dhe mbyllja e hapësirës të dhëmbëve që mungonin në mandibul. Trajtim kirurgjikal konsistoi në kirurgji ortognatike në nofullën e poshtme, BSSO dhe graft kockor në rregjionin e 21, 22. Trajtim protetik, zëvendësimin e mungesave dentare me ure fikse zirkon-porcelani, u krye pas përfundimit të trajtimit ortodontiko-kirurgjikal. I gjithë trajtimi zgjati 24 muaj, ndjekja post operatore u krye 6 dhe 12 muaj pas heqjes se aparatit fiks.

80. VLERËSIMI RADIOGRAFIK I STATUSIT PERIAPIKAL DHE PREVALENCËS SË TRAJTIMEVE ENDODONTIKE NË

POPULLATËN ADULTE SHQIPTARE, TË EKZAMINUAR NË 2013-2018

Amiola FERRO[1], Andia KUSTA[1], Ina TROKSI[1], Inesa MILLOSHI[1], Ina ZISKO[1], Erlind PEPLA[2], Almira ISUFI[1]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT*

[2]*Universiteti i Bristol, Bristol (UK)*

Abstrakt

Qëllimi: Të përcaktojë prevalencën e radiolucencave periapikale dhe të trajtimeve endodontike në popullatën adulte shqiptare. U vlerësua statusi periapikal dhe gjatësia e mbushjeve të rrënjëve, të 1000 pacientëve adultë, me anë të grafive panoramike të gojës.

Rezultate: Në total, 93% e subjekteve kishin dhëmbë të trajtuar endodontikisht. 18. 5% e dhëmbëve të ekzaminuar ishin të trajtuar endodontikisht, nga të cilët 41% paraqesnin radiolucenca periapikale. 4% e dhëmbëve të trajtuar endodontikisht paraqesnin mbushje që tejkalonin apeksin dhe prevalenca më e madhe e radiolucencave periapikale u gjet në molarët e parë dhe premolarët e dytë maksilarë.

Konkluzione: Prevalenca e dhëmbëve të trajtuar endodontikisht paraqitet më e lartë në popullatën shqiptare, sesa në Europë ose në Amerikë. Megjithatë, raporti i dhëmbëve me një radiolucencë periapikale, me dhëmbët e trajtuar endodontikisht ishte brenda kufijve të raportuar në shtetet e tjera.

81. RELACIONI I TRAUMËS DENTARE ME PROTUZIONIN DENTAR

Çeljana TOTI, Marialena STEFANI, Etleva DROBONIKU, Dorjan HYSI

Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Dëmtimet traumatike dentare (DTD) në fëmijë dhe adoleshtë janë kthyer në një nga problemet më serioze me të cilin po përballet shëndeti publik. Etiologjia e këtyre dëmtimeve përfshin një spektër të gjerë variablash, duke përmendur faktorë klinikë dhe socio-ekonomikë.

Qëllimi: Të vlerësojërelacionin midis traumës dentare dhe protruzionit dentar në

fëmijët e grupmoshës 6-15 vjeç të një shkolle publike 9-vjeçare të Tiranës. Gjithashtu të vlerësojë prevalencën e DTD-ve, shpërndarjen sipas gjinisë dhe moshës, dhëmbin dhe tipin më frekuent të traumës, relacionin me faktorë të tjerë predispozues si klasa molare, mbulimi incizival, kompetenca labiale, lloji i respiracioni dhe statusi socio-ekonomik.

Materiale & Metoda: Ky studimi "cross-sectional" u realizua në nje mostër prej 430 pacientësh të moshës 6-15 vjeçnë periudhën Mars-Maj 2018 në një shkollë publike 9-vjeçare në Tiranë. Nëpërmjet ekzaminimit klinik u morën të dhënat në lidhje me traumën dentare, faktorët oralë dhe llojin e respiracionit. U regjistrua dhëmbi i prekur dhe tipi i traumës sipas klasifikimit të McDonald; shkalla incizivale, mbulimi incizival, klasa molare dhe kompetenca labiale. Në vijim u krye plotësimi i pyetësorit në lidhje me nivelin arsimor të nënës të përllogaritur në vite shkollimi dhe informacioni në lidhje me arsyen e traumës. Të dhënat e grumbulluara u analizuan statistikisht nëpërmjet SSPS versioni 20. 0.

Rezultate: Analiza statistikore demostroi se ekzistonte njërelacion statistikisht i rendësishëm midis protruzioni dentar dhe TDT-ve në dhëmbët anteriorë ($p<0.001$), ku me rritjen e vlerës së overjet-it, rritet dhe risku për traumë dentare. Nga 430 fëmijë të ekzaminuar, 113 kishin dhëmbë të dëmtuar (prevalencë 26. 3%). Incizivi central maksilar ishte dhëmbi më i prekur nga trauma dentare dhe fraktura e smaltit pa prekje apo me prekje minimale të dentinës ishte tipi më frekuent. Nuk u vu re një diferencë e rëndësishmë midis gjinive përsa i përket prezencës së traumës dentare. Rezultoi se fëmijët me buzë inkomptente janë më të predispozuar ndaj DTD-ve të dhëmbëve frontalë ($p=0.001$). Faktorë të tjerë si mbulimi incizival, klasa molare, respiracioni oral dhe niveli arsimor i nënës nuk predispozojnë për trauma dentare.

Konkluzione: Këto rezultate na sjellin në konkluzionin se traumat dentare janë një problem frekuent, me një prevalencë relativisht të lartë. DTD-të janë mëtë predispozuara nga disa faktorët oralësi protruzioni dentar dhe inkompetenca labiale, përkundrejt atyre socio-ekonomikë e faktorëve të tjerë klinikë. Strategji parandaluese dhe orientuese të pacientëve në lidhje me faktorët e riskut ndaj traumave dentare, duhen implementuar në strategjitë e kujdesit shëndetësor të përgjithshëm.

82. PËRDORIMI I APEX LOCATOR NË TRAJTIMIN ENDODONTIK NË FËMIJË

Enida PETRO[1], Manola KELMENDI[2], Dorjan HYSI[1], Etleva DROBONIKU[1]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

[2]*Klinika Stomatologjike Universitare*

Abstrakt

Hyrje: Gjatë trajtimit endodontik në fëmijë është e rëndësishme matja e saktë e gjatësisë së kanalit të rrënjës, për të shmangur ndërlikimet që vijnë si rezultat i mbushjes së gabuar, sidomos në rastet me apeks të paformuar në dhëmbët e përhershëm apo kur ka filluar rezorbimi në dhëmbët e përkohshëm. Përdorimi i apex locator është efikas në matjen e gjatësisë së kanalit, nuk shkakton dhimbje, shkurton seancat e punës dhe shmang ekspozimin e fëmijës ndaj rrezatimit.

Qëllimi: Vlerësimi i përdorimit të apex locator në matjen e gjatësisë së kanalit të rrënjës, në dhëmbët e përkohshëm dhe të përhershëm në fëmijë, si dhe krahasimi i rezultateve nëpërmjet radiografisë dixhitale.

Materiale & Metoda: Në këtë studim u vlerësuan 24 dhëmbë frontalë të sipërm monoradikularë, nga të cilët 12 dhëmbë të përkohshëm dhe 12 dhëmbë të përhershëm, që kishin nevojë për trajtim endodontik, në 19 fëmijë të moshës 5-14 vjeç. Në 6 dhëmbë të përkohshëm kishin filluar shenjat e rezorbimit fiziologjik, ndërsa 6 dhëmbë të përhershëm ishin me apeks të paformuar. Në të gjithë dhëmbët u aplikua teknika e pulpektomisë nën veprimin e anestezisë lokale. Më pas u bë irrigimi i kanaleve me solucion hipoklorit natriumi 1% dhe tharja e tyre me paper point. Matja e gjatësisë së kanalit të rrënjës u realizua me Apex Pointer + duke ndjekur me përpikmëri instruksionet e përdorimit. Rezultatet u krahasuan me ato të marra nëpërmjet radiografisë dixhitale me instrument në kanal. Të dhënat u analizuan në programin SPSS. 18 nëpërmjet testeve përshkruese dhe Hi square test. Si nivel sinjifikativ u konsiderua vlera e $p \leq 0.05$.

Rezultate: Në dhëmbët e përkohshëm pa rezorbim fiziologjik, të gjitha rastet tregonin se instrumenti kishte arritur apeksin si në ekzaminimin me apex locator ashtu dhe në atë me radiografi dixhitale. Në dhëmbët e përkohshëm ku kishte filluar rezorbimi fiziologjik, vetëm një rast tregoi se instrumenti kishte kaluar apeksin gjatë ekzaminimit me apex locator, gjë që nuk rezultoi e saktë gjatë ekzaminimit radiologjik. Në dhëmbët e përhershëm vetëm dy raste me apeks të paformuar treguan rezultat fals. Në të gjitha rastet vlera e rezultateve të sakta të shprehura në përqindje ishte më e madhe se vlera e rezultateve false, me diferencë statistikisht sinjifikante. Përqindja e rezultateve të sakta ishte më e madhe në dhëmbët e përkohshëm krahasuar me dhëmbët e përhershëm në vlera absolute, por kjo diferencë nuk ishte statistikisht sinjifikante.

Konkluzione: Rezultatet e këtij studimi tregojnë se në shumicën e rasteve, matja e gjatësisë së kanalit të rrënjës me anë të apex locator është e saktë, si në dhëmbët e përkohshëm dhe në ata të përhershëm. Rezultatet e gabuara vihen re vetëm në një rast me rezorbim fiziologjik, në dhëmbët e përkohshëm dhe në dy raste me apeks të paformuar në dhëmbët e përhershëm. Kjo metodë është mjaft efikase për matjen e gjatësisë së kanalit të rrënjës, në të dy sistemet dhëmbore dhe garanton një trajtim endodontik të suksesshëm, të sigurt dhe komod për pacientët e vegjël.

83. HUMBJA TRAUMATIKE E INCIZIVIT CENTRAL PERMANENT NË FËMIJË DHE MANAXHIMMI I PASOJAVE (RAST KLINIK)

Dr. Ersela ALIKAJ[1]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT*

Abstrakt

Lëndimet traumatike janë ndër episodet më të disfavorshme në jetën e një fëmije. Humbja e hershme e dhëmbëve të përhershëm frontalë, në fëmijët në rritje, në mënyrë të veçantë paraqet një situatë të rëndë, pasi përveç dhimbjes prej traumës së përjetuar nga fëmija, preket në mënyrë të ndjeshme estetika, fonetika dhe padyshim aspekti psiko-emocional i fëmijës. Kur një dhëmb i përhershëm ka humbur, dhëmbët ngjitur kanë tendencë të migrojnë në hapësirën e krijuar, duke sjellë ngushtim të hapësirës. Rifitimi i hapësirës me aparate të lëvizshëm gjithmonë varet nga bashkëpunimi i fëmijëve në mbajtjen e aparatit, si dhe respektimin e vizitave periodike të aktivizimit nga mjeku gjatë gjithë kohës së trajtimit.

Qëllimi: Të tregojë pasojat e mosndërhyrjes në kohë pas humbjes traumatike të dhëmbit permanent. Të tregojë rezultatet që arrihen me përdorimin e një aparati të thjeshtë ortodontik. Të tregojë rëndësinë e trajtimit në kohë dhe rëndësinë e informimit të prindërve dhe pacientëve lidhur me avulsionin.

Materiale & Metoda: Në këtë punim është paraqitur rasti klinik i pacientit të moshës 9 vjeçare, që ka humbur incizivin central të djathtë (11) dhe është paraqitur pas një periudhe më të gjatë se 1 vjeçare, për të korrigjuar pasojat estetike dhe funksionale të humbjes së këtij dhëmbi. Është paraqitur gjendja me foto dhe radiografia në momentin e paraqitjes në klinikë. Është trajtuar me aparat të lëvizshëm për rregullimin e malokluzionit dhe rekuperimin e vendit. Është ndjekur për rreth 1 vit dhe janë paraqitur dy mënyra të ruajtjes së hapësirës dhe gjendja në fund të trajtimit.

Konkluzione: Humbja traumatike e një dhëmbi frontal permanent, bën pjesë në aksidentet dentare më "fatkeqe" për një fëmijë. Ndërhyrja e urgjencës konsiston në mjekimin e plagëve të mundshme dhe reimplantimin sa më shpejt të dhëmbit të avulsuar. Në rastet kur reimplantimi i dhëmbit të avulsuar nuk mund të realizohet, atëherë është e domosdoshme vendosja e ruajtësit të hapësirës, në mënyrë që të parandalohen zhvendosjet e dhëmbëve fqinjë, zhvendosje të cilat me kalimin e kohës do të rezultojnë në malokluzion, estetikë të varfër si dhe probleme funksionale.

Në rastin kur kjo ka ndodhur, del detyrë për mjekun ortodont të korrigjojë malokluzionin, të rifitohet hapësira e dhëmbit të humbur, si dhe të ruhet kjo hapësirë dhe të bëhet zëvendësimi i përkohshëm i dhëmbit të munguar, deri kur të përfundojë

rritja e pacientit e të bëhet zëvendësimi definitiv i tij.

84. PËRDORIMI I PRF-SË DHE GRAFTEVE KOCKORE PËR TRAJTIMIN E KISTEVE TË NOFULLAVE

Dr. Shk. Fatmir LELA, Prof. Dr. Xhina MULO, Dr. Egi MULO

Abstrakt

Hyrje: Plazma e pasur me Trombocide është një risi e kohëve të fundit, që përdoret gjerësisht në mjekësinë e përgjithshme, në kirugjinë maksilo - faciale dhe orale. Një kuagulim natyral i gjakut përmban: 95% të qelizave të kuqe të gjakut, 5% trombocite, më pak se 1% të qelizave të bardha dhe një sasi të shumtë të fijeve fibrine. Një kuagulim i gjakut PRF përmban: 4% të qelizave të kuqe të gjakut, 95% trombocite, si dhe 1% të qelizave të bardha të gjakut. Pra duke u nisur nga këto të dhëna, PRF mund ta quajmë nje kaskadë rigjenerimi dhe shërimi të indeve të forta dhe të buta të nofullave.

Qëllimi: Të shikojmë efektin e shërimit të kisteve të nofullave, me përdorimin e plazmës së pasur me trombocide, grafteve kockore humane dhe me membranë të rezorbueshme.

Materiale & Metoda. Paraqitja e rasteve klinike, ku kemi aplikuar PRF bashkë me graftet kockore dhe membranë, në kistet e nofullave.

Kistet Radikulare: Janë patologjitë më të zakonshme që ndodhin në indet e forta dhe të buta të zgavrës së gojës. Janë kavitete brenda së cilave, shumë herë gjendet qesja epiteliale e mbushur me kristale kolesterine dhe shumë herë me pus mikrobik në kistet inflamatore. Kohët e fundit ka disa procedura të trajtimit për të përmirësuar gjendjen postoperatore dhe për të rritur rigjenerimin e shpejtë të indeve të forta. Një nga këto procedura është përdorimi i PRF, grafteve kockore humane nën membranën e kolagjenit.

Konkluzione: Nga rezultatet tona mundet të konkludojmë se përdorimi i PRF bashkë me graftet kockore humane dhe membranën e rezorbueshme:

- Është një modalitet trajtimi për mjekimin e kisteve kockore të nofullave;
- Rezultoj me një shërim të shpejtë dhe të plotë të defekteve kockore të krijuara nga kjo patologji, në krahasim me të gjitha ndërhyrjet e tjera kirurgjikale të përdorura përpara kësaj metode;

• Dha rezultate të qëndrueshme gjatë gjithë fazës post operative; duke rezultuar përgjithësisht në shërimin e qetë;

Rekomandime:

1. Duhet të respektohen me përpikmëri dhe detaje të gjitha fazat e interventit kirurgjikal.

2. Pastrimi i mirë i kistit, mbushja e dhëmbëve që ka shkatuar kiste, mbushja e defektit kockor me PRF, kockë humane dhe membranë të rezorbueshme, është metoda më e mirë dhe më e shpejtë për shërimin e këtyre patologjive.

3. Rëndësi i duhet kushtuar gjithashtu përgatitjes së lembos, teknikës së përdorur dhe suturimit të përshtatshëm.

4. Rezultatetmë inkurajuese mund të arrihen kur përdoren PRF, grafte kockore humane nën membranë.

5. Po kaq i rëndësishëm është edhe kujdesi postoperativ si nga ana e pacientit, ashtu edhe mjekut.

85. TRAJTIMI KIRURGJIKAL DHE JO-KIRURGJIKAL I PACIENTËVE ME PERIODONTIT KRONIK

Dr. Mirlinda A. SOPI

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Qëllimi kryesor i terapisë paradontale është mënjanimi i inflamacionit dhe mbajtja e një parodonciumi të shëndoshë e funksional. Në zgjedhjen e metodës terapeutike dhe në suksesin e arritur, kryesisht ndikon shkalla e ndryshimeve patologjike në parodoncium. Qëllimi i këtij hulumtimi është të krahasohen efektet terapeutike të metodës jo kirurgjikale (Kiretazha e xhepave paradontal) dhe kirurgjikale (Llambo e modifikuar Widman), në trajtimin e periodontitit kronik.

Materiale & Metoda: Në hulumtim janë përfshirë dy paciente femra, B. G (26 vjeç) dhe M. I (54 vjeç), me periodontit kronik, me xhepa të thellësisë 5-7 mm në të katër kuadrantet. Në vizitën e parë janë bërë matjet paradontale përmes indekseve: indeksi i pllakës sipas Greene – Vermilion-it (IP), indeksi gingivar sipas Loe – Sillnes (IG), niveli i epitelit ngjitës (NEN), atrofia e gingivës (AG), thellësia e xhepave paradontal

(THXHP), indeksi i luhatjes së dhëmbit (ILDH). Përmes Rö grafisë dixhitale është planifikuar trajtimi dhe vlerësimi i rezultateve terapeutike. Te njëra paciente është aplikuar terapi bazike paradontale (mënjanim i pllakës dhe kalkulusit të dhëmbit) dhe kiretazhë të xhepave paradontal, ndërsa te pacientja tjetër kiretazha e xhepave paradontale dhe ndërhyrje kirurgjikale me lambo.

Rezultate: Rezultatet treguan se të dy metodat terapeutike u treguan efikase në kontrollin e pllakës dentare dhe mënjanimin e inflamacionit gingivar. Ndërsa dallim sinjifikant vërehet në zvogëlimin e thellësisë së xhepave paradontal tek pacientja me trajtim kirurgjikal paradontal.

Konkluzione: Qëllimi i trajtimit paradontal është të bëhet mënjanim i plotë i indit patologjik, ruajtjes së indit të shëndoshë dhe krijimit të kushteve për mirëmbajtje më të mirë të higjienës orale. Në rastet kur procesi patologjik zhvillohet në vende të papërshtatshme, ose xhepat janë të një thellësie të tillë, ku përmes kiretazhës nuk mund të mënjanohet indi patologjik, përpunimi me ndërhyrje kirurgjikale, me lambo Widman është më efektiv krahasuar me kiretazhën e mbyllur.

Fjalë kyçe: Periodontiti, Lambo Widman, Kiretazha e xhepave paradontal.

86. BEST BITE DISCLUDER

Nezaqete KORBI, Ardita MEÇO, Ervin MEÇO

Klinikë Dentare Private, Tiranë

Abstrakt

Dhimbjet faciale të kokës e qafës, të shkaktuara nga interferencat okluzale janë një problem me të cilin përballen një numër i madh pacientësh. Shumë prej tyre shkojnë çdo ditë, nga një klinikë në tjetrën, pa zgjidhur problemin e dhimbjes. Studimet e sotme tregojnë se eleminimi i dhimbjeve të spazmave të shkaktuara nga interferencat okluzale, të shoqëruara me mjekimet e duhura okluzale, mund të ulin reagimin e fijeve muskulare, që shoqërohen nga fijet nervore përkatëse. Kjo bën që pacientët t'i dallojnë ato nga dhimbjet kronike si tensioni, dhimbja e kokës, migrena, fibromialgjia etj.

Qëllimi: Të prezantojmë B. B. Discluder, si një metodologji që bën diagnozën diferenciale të dhimbjes së kokës, faciale dhe të qafës. Të evidentojmë biomekanikën e artikulacionit temporo-mandibular. Të shpjegojmë çfarë është B. B. Discluder, si funksionon ai dhe të interpretojmë rezultatet. Të tregojmë përfitimet e B. B. Discluder: shkurton kohën diagnostikuese; provë për çdo pacient; çdo mjek stomatolog mund të përdorë përkohësisht B. B. Diskluder; diagnozë diferenciale; lehtësim të mjekimit

etj.

Materiale & Metoda: Vendosja e BBD në gojë:

1. Vendosim pacientin në pozicion 1/2 shtrirë duke u thënë të numërojnë nga 1-10 (ndjenja e dhimbjes)

2. Vemë materialin e masës në discluder (rekomandohet heavy body not too hard) ose akrilik në discluder.

3. Vendosim diskluderin në centralet e sipërm, në mënyrë që materiali i masës të qëndrojë tamam te dhëmbët dhe sipërfaqja e sheshtë të jetë paralel me margot incizale. Vendosim dhe fijen mbrojtëse në qafë.

4. Pacienti përplas frontalët e poshtëm kundrejt sipërfaqes të sheshtë me inklinacion prej 8 gradësh, në pjesën distale të masës të kafshuar.

5. Drejtojmë ngadalë dhëmbët drejt BBD-së në mënyrë që nofulla e poshtme të mos protrudrohet, fillojmë numërimin nga 10 - 12 herë në minutë.

6. Vazhdojmë përplasjen përafërsisht 2 minuta.

7. E ndërpresim përplasjen dhe numërojmë nga 1-10, për të shmangur ose jo dhimbjen apo lehtësimin.

8. Disa pacientëve u duhet me shumë kohë për të ndjerë çlodhjen(lehtësimin e dhimbjes). Në këto raste i lemë pacientët gjysëm të shtrirë, 10-15 minuta dhe ngadalë përplasim dhëmbët.

9. Nëse kemi lehtësim të dhimbjes i themi pacientit të numërojë nga 1-10, duke parë ndryshimin nga fillimi i numërimit.

10. Palpojmë muskujt lateralë, pterigoidë, maseter, temporal, duke vënë re ndryshimet në nivelin e dhimbjes.

11. Heqja e dhimbjes e provuar nga BBD-ja shërben si mjet identifikimi.

Konkluzione: Është mjet jo i kushtueshëm, lehtësisht i përdorshëm nga të gjithë mjekët që bën diagnozën diferenciale të dhimbjeve faciale, të kokës, të qafës, nga sëmundje të tjera si migrena, fibromialgjia etj.

Fjalë kyçe: BBD, dhimbje, diagnozë diferenciale.

87. INDIKACIONET DHE KUNDËRINDIKACIONET E HEQJES SË

MOLARËVE TË TRETË

Renato ISUFI[1], Aurora ISUFI[2], Jakup VRIONI[1], Ramazan ISUFI[1]

[1]*Departamenti i Kirurgjisë Orale dhe Maksilofaciale, FMD*

[2]*Klinikë Dentare Private, Tiranë*

Abstrakt

Në parametrat e kujdesit, të publikuara nga Shoqata Amerikane e Kirugëve Oral dhe Maksilofacial janë përcaktuar kriteret për ekstraksionin e molarëve të tretë.

Zakonisht rekomandohet një grafi panoramike për të bërë ekstraksionin e molarëve të tretë, por mund të përdoren dhe RöGrafitë periapikale, maksilare, mandibulare ose Dentaskaneri, për të dhëna më të detajuara.

Kirurgu duhet të marrë në konsideratë tre kritere madhore kur vendos që të bëjë ekstraksionin e një molari të tretë të impaktuar si: moshën e pacientit; gjendjen e përgjithshme shëndetësore; riskun e shtuar për dëmtim të strukturave anatomike fqinje. Gjatë konsensusit informues pacienti duhet të njoftohet për të gjitha komplikacionet e mundshme që mund t'i ndodhin gjatë heqjes së molarëve të tretë të impaktuar.

Fjalë kyçe: Indikacion, kundërindikacion, heqje e molarëve të tretë të impaktuar.

88. TRAJTIMI I KLASAVE TË DYTA ORTODONTIKE NË RASTET JOEKSTRAKTIVE

Jolanda TAGA, Almira ISUFI, Rozela XHEMNICA, Giovani MANES GRAVINA

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Në këtë temë paraqitet një aplikim për distalizimin e segmenteve të pasëm, nga kaninët maksilarë në molarët maksilarë. Qëllimi i përdorimit të kësaj aparature është rregullimi i kafshimit dhe arritja e një rezultati ortodontik të klasës së parë, në rastet pa ekstraksion të dhëmbëve të përhershëm. Gjithashtu dhe shkurtimi i kohës së distalizimit krahasuar me metoda të tjera distalizuese.

Materiale & Metoda: Traksioni distalizues është bërë me aparatin Carriere Distalizer, një aparat me përbërje çeliku inoks pa nikel. Aparati është i lidhur me kaninin dhe molarin e parë, metodë e cila lejon lëvizjen distale përgjatë kurrizit alveolar. Gjatë

përdorimit të Carriere Distalizer si pikë ankorimi kemi përdorur një hark lingual, nga bandat e të cilit bëhet lidhja me Carriere Distalizer me llastiqet e klasës së dytë. Pas fazës së parë të trajtimit, e konsiderojmë rastin të jetë në statusin e një platforme të klasit të parë. Ky pozicion është pika strategjike që duam të arrijmë.

Rezultate: Kohëzgjatja e distalizimit zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme në krahasim me pajisjet e mëparshme, sepse me ta, pas distalizimit të molarit të parë maksilar, pjesa tjetër e premolarit dhe kaninit duhet të distalizohet në një sekuencë progresive të lëvizjes, ndërkohë që me sistemin Carriere Distalizer lëvizja kryhet si një grup në një lëvizje të vetme distale.

Konkluzione: Përfundimi i procedurës së distalizimit u krye me sukses, si në mbajtjen ashtu edhe komoditetin nga pacienti, në kohëzgjatjen e trajtimit, apo në lëvizjen trupore të dhëmbëve. Nga ky status rasti mund të përfundojë me teknikën e preferuar nga ortodonti. Në rastin tonë, vazhdimi i rastit është bërë me teknikën Straight Wire MBT.

SESIONI 04

*ABSTRAKTET NGA MJEKËSIA

* Përfshihen të gjitha abstraktet e Referimeve Orale nga Mjekësia, Farmacia dhe Shkencat Mjekësore Teknike.

89. AMBLIOPIA: FAKTORËT E RISKUT DHE TRAJTIMI

Prof. Dr. Özgül ALTINTAŞ

Shërbimi i Oftalmologjisë, Spitali Acıbadem, Stamboll, Turqi

Abstrakt

Ambliopia e njohur ndryshe si "syri dembel" është shkaku kryesor i çrregullimeve të shikimit në fëmijë dhe të rritur, ku prevalenca e kësaj sëmundje në botë varion nga 0.2-6%. Ambliopia është humbje unilaterale ose bilaterale e shikimit, pa praninë e patologjive të syrit.

Gjatë këtij prezantimi do të diskutohet mbi faktorët e riskut për zhvillimin e ambliopisë, të cilët përfshijnë strabizmin, anizometrinë e syve, katarakta kongenitale, ametropia bilaterale e shumë faktorë të tjerë, si dhe modalitet e fundit për trajtimin e saj.

90. TË DHËNA MBI KANCERIN PAPILAR DHE FOLIKULAR TË TIROIDES TË TRAJTUARA ME JOD RADIOAKTIV (I131) NË QSUT

Dr. Adishah ÇERMA[1], Prof. Dr. Agron YLLI[2]

[1]*Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

[2]*Shërbimi i Endokrinologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i tiroides është neoplazia më e zakonshme endokrine. Katër format histologjike që hasen më shpesh janë ajo papilare, folikulare, medulare dhe anaplastike, me predominim të asaj papilare në 80% të rasteve, e pasuar nga ajo folikulare. Kanceri papilar dhe ai folikular klasifikohen si forma të diferencuara të kancerit të tiroides dhe trajtohen me jod radiaktiv pas tiroidektomisë. Seksi më i prekur është ai femër dhe sëmundja kulmon në dekadën e katërt dhe të pestë të jetës.. Incidenca e kancerit të tiroides ka qenë në rritje në vitet e fundit, për arsye ende të padeterminuara.

Qëllimi: Të paraqitet një tablo e përgjithshme të kancerit papilar dhe atij folikular të trajtura me jod radioaktiv (I131) në Shqipëri dhe krahasimi i të dhënave të përftuara me ato të literaturës në lidhje me këtë patologji.

Materialet & Metoda: Grupi i i marrë në shqyrtim në këtë studim janë 140 pacientë me kancer papilar dhe folikular, trajtuar me jod radioaktiv (I131) në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Informacioni mbi këta pacientë është siguruar nga kartelat e Mjekësisë Nukleare. Ky informacion përfshin: gjeneralitetet e pacientëve (emër, mbiemër, seksi, mosha, vendlindja),të dhënat e biopsies, vitin e kryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale (tiroidektominë), dozimet hormonale (Tg, anti-Tg) para terapisë ablative me jod, të dhëna mbi terapinë ablative me jod (nr e dozave të marra, doza kumulative, dozat në raport me llojin e karcinomës dhe vlerësimi i efikasitetit të saj).

Rezultate: Në vendin tonë vihet re një tendencë në rritje e Ca të tiroides. Kanceri papilar i tiroides (71%) dominon në raport me atë folikular (29 %). Gjinia femërore është më e prekur (84%)dhe raporti femra/meshkuj rezulton 5/1. Grupmosha me incidencë më të lartë është 51-60 vjec (24%) me një moshë mesatare në të dyja gjinitë është 44,4 vjec. Shumica e pacientëve (58. 6%) trajtohen me dozën 100 mCi me një dozë mesatare të përdorur është 87. 85 mCi. Tg para terapisë me I-131 rezultoi normale në 46% dhe e rritur në 54% kurseAnti-Tg para terapisë me I-131 rezultoi e rritur në 20. 5%. Tg pas terapisë me jod rezultoi e ulur duke mbështetur efikasitetin e saj në trajtimin e formave të diferencuara të karcinomës tiroidiene. Edhe në vendin tonë vihet re një tendencë në rritje e Ca të tiroides.

Konkluzione: Të dhënat e përftuara nga studimi shkojnë paralel me ato të literaturës ndërkombëtare në lidhje me këtë patologji. Nxitur nga mangësitë në të dhënat e mbledhura, theksohet rëndësia e implementimit të një regjistri kombëtar elektronik për dokumentimin korrekt të cdo rasti të ndjekur me Ca të tiroides në QSUT, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj pacientëve por edhe si një aset i vyer për qëllime shkencore dhe akademike. Sipas rekomandimeve të ATA, pacientëve me kancer të tiroides t'i performohen periodikisht këto ekzaminime: Vlerat e Tg,anti-Tg dhe TSH në serum, ËBS me I131 dhe Ultrasonografi e qafës.

Fjalë kyçe: Kancer papilar, kancer folikular, terapi ablative me jod radiaktiv

91. AUTIZMI

Ardiana PONDE

Logopediste

Abstrakt

Autizmi është çrregullim neurobiologjik qe vecohet me veshtirei ne komunikim, nderveprim shoqeror, sjellje te perseritura me rreze te kufizuar interesash. Simptomat e autizmit fillojne te shfaqen para moshes dyvjecare dhe shkalla e demtimit te ketyre tre fushave dallon nga njeri individ tek tjetri. Megjithatë ajo që i bën prindërit të

shqetësohen është zhvillimi social i fëmijës si dhe vonesa në të folur apo humbja ose ndërprerja e të folurit tek ata fëmijë që e kanë filluar këtë proces normalisht.

Qëllimi i këtij punimi është të sjellim tek dëgjuesit problemet që shoqërojnë jetën e këtyre fëmijëve, simptomat e shfaqjes së ketij crregullimi, roli i nderhyrjes se hershme si nje rol kyc ne ecurine e femijes dhe mbi të gjitha një ndërgjegjësim ndaj kësaj kategorie të shoqërisë, në mënyrë të veçantë tek prindërit, të cilët shpesh herë si pasojë e një neglizhence ose mosbesimi që fëmija i tyre të ketë ndonjë problem, lejne pas dore dhe simptomat e qarta që ka ky çrregullim, duke u bërë kështu shkaktarë të disa pasojave të parikuperueshme për të gjithë jetën e fëmijës.

92. NDËRHYRJA LOGOPEDIKE NË DEFEKTET E ARTIKULIMIT

M.Sc. Afërdita KULLURI

Logopedi

Abstrakt

Hyrje: Sa të ngjashme aq edhe të ndryshme vijnë me nje simptomatologji të larmishme duke specifikuar karakteristikat e secilës dhe metodat e nderhyrjes Logopedike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është t njihemi me defektet e artikulimit dhe nderhyrjen ne saje te rajonit fiziologjik ku ndodh defekti. Më pas të ndërhyjmë me anë të terapisë për të realizuar qëllimin final që ka Rehabilitimi Logopedik ,që është "Të rrisim aftësite komunikuese".

Materiale & Metoda: Punimi është realizuar në aspektin klinik në kuadër te crregullimeve te komunikimit ,duke konkretizuar defektet e artikulimit me nje rast, e me pas duke e krahasuar me crregullime te te njejtes familje.

Rezultate: Duke u bazuar në kete patologji si dhe ndikimin nga faktoret predispozues, vihet re që në bazë të studimeve, nderhyrja logopedike e shoqëruar me fizioterapinë rritën numrin e rasteve te përmirësuara ,kryesisht pas rehabilitimeve post operatore.

Konkluzione:

- Defektet ne artikulim janë evidente në jetën e përditshme.
- Graviteti i patologjisë, nderhyrja e hershme ndikojnë në përmirësimin e subjektit me anë të rehabilitimit.
- Ndërhyrja Logopedike kryesisht konsiston në rritjen e fluences, nyjëtimin automatizimin edhe më pas vendosjen e saj ne kontekst ,duke eleminuar fillimisht

problematikat madhore.

• Diagnoza diferencjale është celsi kyc për ndërhyrjen në problematikën esenciale të pacientit.

Fjalë kyçe: Dislalia, Crregullim funksional, Crregullim fonologjik

93. ENDOKARDITI INFEKTIV DHE PROÇEDURAT INVASIVE DENTARE

Ergys RAMOSAÇO, Entela KOLOVANI, Najada ÇOMO

Shërbimi Infektiv, QSUT

Abstrakt

Hyrje: Endokarditi infektiv shoqërohet me morbilitet dhe mortalitet të lartë. Endokarditi infektiv është një patologji infektive, e shkaktuar nga mikroorganizma të cilët arrijnë të vendosen në endokard, kryesisht atë valvular, duke krijuar vegjetacione, që modifikojnë funksionin normal kardiak. Mikroorganizmat më të shpeshtë janë banorë të florës normale të kavitetit oral.

Prej vitit 1955 është konsideruar e përshtatshme administrimi profilaktik i antibiotikëve në personat me risk të lartë, për të parandaluar endokarditin infektiv para proçedurave dentare invasive që shkaktojnë bakteremi. Sot mendimi rreth profilaksisë me antibiotikë për të parandaluar endokarditin infektiv është i diskutueshëm. Një sërë studimesh të viteve të fundit, konfirmojnë faktin se shumica e rasteve me endokardit infektiv nuk janë rezultat i bakteremisë prej proçedurave invasive dentare, por më tepër nga bakteremia e rastësishme nga aktivitetet ditore, si larja e dhëmbëve apo gjatë përtypjes. Kjo është arsyeja pse sot mendohet se profilaksia mund të parandalojë vetëm një numër të vogël të rasteve me endokardit infektiv.

Konkluzione: Bashkëpunimi i ngushtë midis kardiologëve, infektologëve dhe stomatologëve, do të bëjë të mundur uljen e incidencës së shfaqjes së endokarditit infektiv, pas proçedurave invasive dentare.

94. DIAGNOZA DIFERENCIALE NDËRMJET DERMATOZAVE PSORIASIFORME.

Dr. Alda CENGU, Dr. Shk. Leart BËRDICA, Dr. Orion DOLLMA

Fakulteti i Mjekësisë, UMT

Abstrakt

Sfondi: Dermatoza psoriasiforme është një prezantim i një spektri të gjerë sëmundjesh nga më të padëmshet deri tek ato që kufizojne ndjeshëm cilësinë e jetës. Në këto patologji haset paterni i reaksionit psoriasiforme ndaj është e nevojshme diagnoza mikroskopike për një diferencim të mëtejshëm. Dermatoza më e shpeshtë në këtë grup është Psoriasis, e cila është një sëmundje kronike, hiperproliferative, jo infektive dhe hereditare e përhapur gjerësisht në 2-3% të popullsisë botërore.

Qëllimi & Objektivat: Qëllimi i ketij studimi është qartësimi i diagnozës diferenciale ndërmjet dermatozave psoriasiforme me anë te vlerësimit të marrdhënieve statistikore sipas seksit, lokalizimit, grupmoshës, shenjave klinike dhe mikroskopisë.

Materiale & Metoda: Ky është një studim retrospektiv që përfshin një mostër prej 99 rastesh të vitit 2017 të grumbulluara nga biopsite e "Shërbimit Qendror të Anatomisë Patologjike". Të dhenat e këtij studimi u analizuan në disa variabla sipas programit SPSS përfundimet e të cilit u krahasuan me referenca të studimeve të tjera.

Rezultate: Në studimin e kryer për dermatozat psoriasiforme rezulton se seksi mashkull është predominues, grupmosha 61-70 është më e prekura nga këto patologji dhe regjioni më i prekur janë gjymtyrët dhe regjioni abdominal. Përsa i përket psoriasis prekja e të dy sekseve është pothuaj e ngjashme, grupmosha më e prekur është ajo 61-70 vjec në të dyja sekset, dhe regjioni qe haset në më të shumtën e rasteve në meshkuj janë anësite e sipërme ndërsa në femra është regjioni abdominal. Shumica e këtyre rezultateve të studimit korrelonin me studime të tjera të huaja.

Konkluzione: Studimi prezent rikonfirmon edhe një here rendësinë e diagnozës mikroskopike në diferencimin e patologjive psoriasiforme. Megjithatë sduhet harruar rendesia që ka edhe korrelimi klinik me atë patologjik për të bërë të mundur një diferencim sa më të qartë të patologjive psoriasiforme nga njëra tjetra. Për sa i përket psoriasis si etnitet më vete dolem në konkluzione se regjionet më të prekura ishin anësite dhe regjioni abdominal si dhe kishte pik grupmoshen 61-70 vjec.

Fjalë kyçe: Dermatoza psoriasiforme, Psoriasis, Diagnozë diferenciale, Variabla.

95. ATAKU I PANIKUT, NJË SULM I PAPRITUR PA EMËR DHE PA KUFI

Dr. Alketa ÇOKU

"Psikoanaliza është një mundësi, një mundësi për të rifilluar në një tjetër mënyrë." Jacques

Lacan

Abstrakt

Ataku i panikut është një nga simptomat e reja, të viteve të fundit, që po përhapen gjithnjë e më shumë në shtresa të ndryshme të popullsisë dhe në mosha të ndryshme. Është një nga çrregullimet psikike që përfshijnë më me forcë trupin, i cili përgjigjet në mënyrë të pakontrollueshme. Rrahje zemre të çrregullta, djersitje e tepërt, dridhje, tharje sekrecionesh, frymëmarrje e shpeshtë, një ndjesi pafuqie që e detyrojnë individin që po vuan këtë gjendje të drejtohet shpesh pranë pikave të urgjencave spitalore. Personi nuk di ta shprehi me fjalë atë që po përjeton dhe pasi kalon krizën akute e kalon pjesën më të madhe të kohës duke menduar si të parandalojë ardhjen e një "sulmi" të mundshëm, i tmerruar dhe i pushtuar nga ankthi dhe frika për të ardhmen. Ky sulm paraqitet si një "rrufe në një qiell pa re". Eksperienca që bën personi është një humbje totale e lidhjeve simbolike, e pikave të referimit, e identitetit të personit. Frika nga vdekja, nga marrëzia (frika mos humb arsyen) e detyrojnë personin të kërkojë gjithnjë e më shumë një pikë mbështetjeje, një familjar, një mik apo të afërm, që ta ketë gjithmonë pranë. Kjo vështirëson aktivitetet e përditshme, edhe ato më elementare dhe automatike, si ngarja e makinës kur është vetëm, hipja në ashensor, bërja e pazarit etj. Eksperienca e panikut vë në qendër të vemëndjes subjektin dhe vetminë e tij, mund të jetë i rrethuar nga shumë njerëz por prap të ndihet i vetmuar. Në këtë referim do të nxjerr në pah shkaqet dhe patogjenezën e këtij çrregullimi, nëpërmjet eksperiencave të sjella nga pacientët, si edhe indikacionet e kurës nëpërmjet fjalës. Orientimi psikoanalitik, mënyra e veçantë e dëgjimit, pozicioni etik, e ndihmojnë pacientin të "rivendosë" lidhjet me historinë e tij, me pritshmëritë që ka për veten dhe me ato të tjetrit, me dëshirat e tij, duke i dhënë mundësinë të rishikojë ato zgjedhje që ka bërë, apo s'ka mundur të bëjë, në një tjetër këndvështrim.

96. RËNDËSIA E 1000 DITËVE TË PARA TË JETËS NË ZHVILLIMIN E FËMIJËVE

Dr. Shk. Alketa QOSJA (HOXHA)[1]

[1]*Pediatre-Neonatologe, Pedagoge pranë UMT*

Abstrakt

Globalisht, më shumë se 200 milion fëmijë nën moshën pesë vjeçare nuk arrijnë potencialin e tyre në zhvillimin konjitiv dhe social për shkak të varfërisë, shëndetit të dobët, kequshqyerjes dhe kujdesit të munguar. 1000 ditët e para të jetës nga dita

e konceptimit derisa fëmija të arrijë moshenë dy vjeçare, është konsideruar faza më e rëndësishme e zhvillimit. Zhvillimi i hershëm i fëmijëve të shëndetshëm përfshin zhvillimin fizik, social, emocional dhe njohëse të zhvillimit.

Çfarë ndodh me fëmijën në këto ditë të hershme, ka ndikim të madh në zhvillimin e fëmijës në pjesën tjetër te jetes. Pesë faktorët kryesorë të identifikuar në kontributin për rritjen dhe zhvillimet në fëmijërinë e hershme janë ushqimi, sjelljet e prindërve, prindërimi, praktikat shoqërore dhe kulturore dhe mjedisi.

Nëse ndërhyrjet në kohë janë marrë brenda kësaj periudhe kritike, problemet janë të kthyeshme dhe do të kemi përfitime maksimale. Një fëmijë i shëndetshëm në veçanti brenda kësaj moshe do të ketë aftësi më të mira të njohjes dhe të të mësuarit dhe rrjedhimisht do të ketë ndikim në njohuritë sociale, ekonomike, fizike dhe të njohjes.

Ushqimi është i rëndësishëm përpara dhe gjatë shtatzanisë dhe është faktori më influencues jo-gjenetik në zhvillimin e fetusit. Qumështi i gjirit është ideali dhe ushqimi më i mirë për foshnjat, siguron një lëndë ushqyese unike që përbën proteina, karbohidrate dhe yndyrna të nevojshme për funksionimin dhe rritjen e qelizave optimale. Shumë përpjekje duhet të theksohen në fillimin e hershëm të ushqyerjes së gjirit së bashku me kontaktin e lëkurës në mënyrë që të ndihmojnë në rritjen e ushqyerjes ekskluzive me gji.

Një fillim i duhur dhe adekuat i ushqimit plotësues në gjashtë muaj është kritik për zhvillimin e fëmijëve. Në shumë vende në zhvillim, fëmijët e këtyre grupmoshave nuk marrin ushqim në kohën e duhur, të përshtatshme dhe adekuate për tu rritur në nivelin optimal. Makro dhe mikro ushqyesit janë thelbësore për rritjen dhe zhvillimin normal dhe është më e rëndësishme gjatë shtatzënisë. Pirja e duhanit gjatë shtatzanisë dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit mjedisor ka pasoja të rënda shëndetësore për nënën dhe foshnjën.

Fëmijët e vegjël varen nga kujdesi që ata marrin dhe rritja e tyre varet nga aftësia e kujdestarëve. Ndjeshmëria dhe përgjegjësia janë identifikuar si tipare kryesore të kujdesit që sjell ndryshime në rezultatet e mëvonshme pozitive të shëndetit dhe zhvillimit në fëmijët e vegjël. Gjuha dhe zhvillimi konjitiv janë veçanërisht të rëndësishëm gjatë gjashtë muajve të parë deri në tre vjet të jetës. Kur fëmijët kalojnë vitet e tyre të hershme në një mjedis më pak stimulues, zhvillimi i trurit ndikohet dhe çon në vonesa te njohjes, shoqërore dhe të sjelljes. Nivelet e larta negative dhe stresi gjatë fëmijërisë së hershme mund të rrisin rrezikun e sëmundjeve të lidhura me stresin dhe vështirësitë e të mësuarit.

Fjalë kyçe: 1000 ditë e parë e jetës, vonese e zhvillimit fizik, social, emocional dhe njohës.

97. BIOPSIA RENALE

Alketa SPAHIU[1], Ilirian LAÇI[2]

[1]*Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3,Tiranë*

[2]*QSU "Nënë Tereza",Tiranë*

Abstrakt

Biopsia renale është marrja e disa kampjoneve te vegjel histologjike nga veshka dhe ekzaminimi mikroskopik i tyre. Biopsia renale është futur në praktikën klinike në vitet 1950. Ajo është një procedurë ekzaminuese në diagnozën dhe ndjekjen e disa patologjive renale. Biopsia renale rekomandohet në hematuri dhe proteinuri por jo në hematuri të izoluar mikroskopike ose proteinuri të ulët (<0. 5-1. 0 g /24 orë), sëmundje renale akute ose kronike pa një shkak të qartë,në sindromat nefrotike dhe sëmundjet glomerulare,ndjekjen e renit të transplantuar etj. Mjekët duhet të marrin parasysh raportin rrezikun e një biopsie renale me përfitimit të një diagnoze histologjike. Karakteristikat anatomike, të tilla si kiste në polin renal, veshkat atrofike me korteks të reduktuar ose "ren arkuat", mund të jenë të kundërindikuara në disa pacientë. Ajo realizohet nga nefrologët dhe radiologët duke perdorur (tru-cut 14-18 gauges) me pistoletë automatike të drejtuar nën ekografi. Komplikacioni kryesor i kësaj proçedure është hemoragjia retroperitoneale e cila mund të shkaktojë vdekje nëse nuk ndalohet hemoragjia. Prandaj është i rëndësishëm vlerësimi paraprak i hemogramës,faktorëve të koagulimit të gjakut,ndalimi i medikamenteve që ndikojnë në hemostazë për të minimizuar rriskun e hemoragjisë. Menjëhere pas proçedurës së biopsisë rekomandohet një kohë observacioni 12 deri 24 orë ndonjëherë edhe më i zgjatur për të minimizuar rrisqet e hemoragjise pas proçedurës.

98. CHEPHALOSPORINAT

M.Sc. Anila LILO

Farmaciste

Abstrakt

Qëllimi kryesor i studimit ka të bëjë me studimet e shkencës farmaceutike për të arritur një aktivitet të mirë antimikrobik, për të arritur objektiva të rëndësishme në lidhje me shëndetin e individit në luften e sëmundjeve të ndryshme infektive të shkaktuara nga bakteriet Gram positive dhe Gram negative.

Rëndësia e studimit të cephalosporinave ka të bëjë me zhvillimin e zbulimit të gjeneratave të beta-laktam cephalosporinave.

Metadologjia që është përdorur - Farmakologjia, Farmakokinetika dhe përdorimet klinike të Cephalosporinave.

Gjetja kryesore e studimit ka të bëjë me tranzicionin nga rezistenca ndaj hipersensibilitetit të beta-laktam antibiotikëev në një grup të rinjsh beta-laktam me një afinitet më të lartë ndaj PBP dhe me një stabilitet në beta-lactamazë dhe MRSA (Methyl Resistant Staphylococcus Aureus).

Rëndësia e studimit ka të bëjë me faktin që më 29 tetor 2010, një agjent i ri cefalosporin – Ceftarolin - u miratua nga administrata e ushqimit dhe drogës (FDA). Teflaro (ceftaroline fosamil) është një prodrug - antibiotik i injektueshëm për të trajtuar të rriturit me infeksione akute bakteriale të lëkurës dhe pneumonitë bakteriale të fituar nga komuniteti (CABP Community-Acquired Bacterial Pneumonia).

Rekomandimet praktike janë rekomandimet e lidhura me American Society of Microbiology në lidhje me faktorin e ulët të afinitetit penicilinë, që lidhet me rezistencën e beta-laktamit në Staphylococcus aureus.

99. PLANIFIKIMI FAMILJAR

Ariana POJANI

Abstrakt

Ja disa nga mënyrat si planifikimi familjar i ndihmon të gjithë:

Gratë. Planifikimi familjar i ndihmon gratë të mbrojnë veten nga shtatzanitë e padëshiruara. Që nga 1960 programet e planifikimit familjar kanë ndihmuar gratë rreth botës të shmangin 400 milion shtatzani të padëshiruara. Si rezultat jetët e shumë grave janë shpëtuar nga shtatzanitë me risk të lartë ose i aborteve jo të sigurta. Nëse të gjitha gratë do të mund të shmangnin shtatzanitë me risk të lartë, numri i vdekjeve amtare do të binte në një të katërtën.

Fëmijët. Planifikimi familjar i mbron jetët e fëmijëve duke i ndihmuar gratë të vendosin një hapësirë të përshtatshme kohore nga njëra lindje në tjetrën.

Burrat. Planifikimi familjar i ndihmon burrat dhe gratë të kujdesen për familjet e tyre.

Familjet. Planifikimi familjar përmirëson mirëqënien e familjes. Çiftet me më pak fëmijë janë më të aftë ti përmbushin të gjitha nevojat me mjaftueshëm ushqim, veshje, strehim dhe shkollim.

6 Pikat kryesore:

- Efektiviteti.

- Avantazhet dhe disavantazhet.
- Efektet anësore dhe komplikacionet.
- Përdorimi.
- Parandalimi i SST.
- Ndihmo klientin të kuptojë dhe kujtojë

100. NDRYSHIMET QË SHKAKTON DIABETI NË LËKURË DHE PLAGËT DIABETIKE

Dr. Artenca KRAJA

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është përcaktimi i ndryshimeve që ndodhin në lëkurë tek pacientët diabetikë. Përcaktimi i plagëve diabetike si komplikacioni më problematik që ndodh në lëkurën e këtyre pacientëve. Këshilla praktike mbi parandalimin, trajtimin, mjekimet më të reja për trajtimin e tyre.

Diabeti mund të prekë çdo pjesë të trupit, përfshirë dhe lëkurën. Fatmirsisht pjesa më e madhe e komplikacioneve të lëkurës mund të parandalohen ose të trajtohen lehtë kur kapen në faza të hershme. Këtu përfshihen infeksionet bakteriale, infeksionet mykotike, probleme të tjera me lëkurën që shfaqen kryesisht apo vetëm tek diabetikët siç janë dermopatitë diabetike, necrobiosis lipoidica diabeticorum, flluskat diabetike, acantosis nigricans, digital sclerosis,eruptive xanthomatosis.

Ulçera diabetike në këmbë është një ndër komplikacionet madhore të diabetit mellitus. Shfaqet tek 15% e pacientëve me diabet dhe paraprin 84% të amputimeve të këmbëve të lidhura me diabetin. Kritja e shkallës së vdekshmërisë këto 20 vitet e fundit tek pacientët diabetikë i dedikohet zhvillimit të komplikacioneve mikro e makro vaskulare, përfshirë edhe dëmtimin e procesit të shërimit të plagëve. Ulçeracionet shfaqen kryesisht në shuallin e këmbës ose poshtë gishtit të madh të këmbës. Neglizhimi i tyre mund tëçoje në infektim, deri në humbje të gjymtyrës. Çdo 30 sekonda, dikush në botë humb një nga gjymtyrët e poshtme për shkak të diabetit. Shumë nga amputimet mund të parandalohen me një kujdes të mire të këmbëve dhe trajtim të plagëve. " Jo gjithmonë mund të parandalohet një ulçer, por mund të parandaloni një amputim. " Faktorët e riskut që implikohen në shfaqjen e ulçerave në këmbët e diabetikëve janë :neuropatia diabetike, sëmundja vaskulare periferike, duhanpirja, kontrolli jo i mirë i sheqerit, nefropatia diabetike, ishemia e enëve të mëdha e tëvogla. Ulçerat e këmbëve të diabetikëve kërkojnë një vlerësim

multidisiplinar nga një podiatrist, endokrinolog, kirurg.

Qëllimi primar i trajtimit të ulçerave të këmbëve është shërimi sa më i shpejtë i mundshëm. Sa më shpejtë të shërohen aq më të pakta janë mundësitë për infektim. Në këtë mënyrë farmacisti i vjen në ndihmë pacientit duke i udhëzuar mbi vlerësimin dhe trajtimin e duhur të plagëve diabetike. Shpesh herë pacienti pyet nëse plaga duhet mbuluar apo jo dhe me çfarë duhet mbuluar, cilat janëçorapet dhe këpucët e veçanta, si mund ti parandalojmë apo trajtomë plagët e krijuara etj.

Fusha e trajtimit të plagëve ka evoluar mjaft këto 10 vitet e fundit. Mjekimet inovative që kohët e fundit po aplikohen jashtë vendi janë: Terapia me fibrin e pasuruar me trombocite (Platelet-Rich Fibrin Therapy), me oksigjen hiperbarik (Hyperbaric oxygen),terapia e plagës me presion negative (Negative pressure wound therapy),administrim i lokal i qelizave staminale (Topical administration of stem cells), beta-glukane të tretshem (Soluble beta-glucans), alografte me membranë amniotike (Amniotic Membrane Allografts).

101. PARANDALIMI I INSULTIT CEREBRAL NË PACIENTËT E MOSHUAR ME FIBRILACION ATRIAL JOVALVULAR

Dr. Benard SHEHU

Kardiolog, Shërbimit i Urgjencës, QSUT

Abstrakt

Qëllimi: Mosha është një faktor risku i rëndësishëm për insult cerebral. Prevalenca e fibrilacionit atrial rritet me moshën. Në pacientët e moshuar me fibrilacion atrial jovalvular me risk mesatar në të lartë për insult cerebral, rivaroxaban është po aq efikas sa varfarina, duke mbështetur rivaroxabanin si një alternativë për të moshuarit.

Metoda: Subanalizë e ROCKET-AF; ku 44% e pacientëve ishin ≥ 75 vjeç. Të dhëna të reja për pacientët ≥ 80 vjeç me fibrilacion atrial jovalvular nga databaza retrospektive US. Në dizanjin e studimit u përfshinë 8976 pacientë.

Rezultati: Rivaroxaban siguron parandalim efikas në insultet cerebrale duke përgjysmuar hemorragjitë fatale në pacientët e moshuar krahasuar me antagonistët e Vitaminës K. Të dhënat në jetën reale konfirmojnë sigurinë e rivaroxaban për parandalimin e insultit cerebral në pacientët ≥ 80 vjeç me fibrilacion atrial jovalvular. Në analizat e regjistrit Danez mbi sigurinë dhe efikasitetin e antikoagulantëve orale në pacientët e moshuar me fibrilacion atrial; Xarelto 20 mg u lidh me një risk më të

ulët insulti ishemik ose embolie sistemike krahasuar me varfarinën, pa cënuar sigurinë ndërsa Xarelto 15 mg tregoi një trend drejt shkallëve më të ulëta tromboembolike me shkallë hemorragjie madhore të krahasueshme me varfarinën.

Konkluzione: Efektet relative në tërësi të Rivaroxaban krahasuar me varfarinën ishin konsistente në pacientë të moshuar (dhe të rinj) edhe për efikasitet edhe siguri. Rivaroxaban siguron parandalim efikas në insultet cerebrale duke përgjysmuar hemorragjitë fatale në pacientët e moshuar krahasuar me antagonistët e Vitaminës K. Rivaroxaban risiguron efikasitet konsistent dhe profil sigurie në parandalim insulti për pacientët e moshuar me fibrilacion atrial jovalvular.

102. ROLI I LOGOPEDISTIT NE DIFEKTET MAXILLO-FACIALE

Brikela ZOTAJ

Logopede

Abstrakt

Objektivat: Trajtimi i çrregullimeve dento-maxillofacial nënkupton një rehabilitim funksional për ri-harmonizimin e sistemit orofacial. Ky studim synon të tregojë rëndësinë e një protokolli rehabilitimi të parametrave funksional orofaciale nepermjet rehabilitimit logopedik pas trajtimit kirurgjikal maxillo-facial për të arritur sukses ne komunikimin verbal.

Materiale & Metoda: Pas operacionit maxillo-faciale, ushtrimet e muskulatures së fytyrës dhe stërvitjet e nofullës janë të përshkruara për të nxitur rimëkëmbjen e funksionit neuromuskular. Në përfundim të trajtimit, një mostër prej 30 pacientësh dysgnatikë iu nënshtrua një vlerësimi funksional të sistemit orofacial për të identifikuar ndonjë disfunksion gjuhësor ose artikulues. Informacioni i mbledhur çoi në një program ri-edukimi individual që përbëhej nga një qasje aktive myofunkcionale-logopedike.

Rezultate: 19 pacientë kishin nevojë për terapi miofunksionale për të ri-edukuar procesin e deglutimit dhe levizjet e gjuhes. Çrregullime artikuluese u gjetën në 7 pacientë; 5 prej këtyre rehabilitimeve të kryera me terapinë e fjalës. Pas rehabilitimit parametrat funksionalë u norrmalizuan plotësisht në 12 pacientë; në 5 raste, u arritën përmirësime të pjesshme, ndërsa në 2 raste terapi ishte joefektive.

Konkluzione: Në një pacient që pëson rikonsolidimin post-kirurgjik të ekuilibrit të tij funksional edhe një defekt i pakontrolluar i fjalës mund të çojë në një rezultat të paqëndrueshëm. Vetëm nëpërmjet një qasjeje ndërdisiplinore është e mundur të

kapen dhe ri-edukohen të gjitha funksionet që nuk janë në përputhje me ndryshimet strukturore.

Fjalë kyçe: Çrregullimet e Maxillo-faciale, terapia e të folurit, terapia miofunksionale, ndërhyrja e hershme.

103. ANESTEZIA NE PACIENTE ME SEMUNDJE SHOQERUESE TE RRALLA

Brikena DAUTAJ, Enriketa JAHO, Klerida SHEHU, Esmerilda BULKU

Abstrakt

"Anestezinë" secili nga anestezistët e aplikon cdo ditë në paciente të ndryshëm, nga të porsalindurit në ato tepër të moshuar, nga pacientë pa sëmundje shoqëruese në ato me disa sëmundje shoqëruese. Sfida e anestezistit ngelet një vizitë e mirë preanestetike ku evidenton cdo gjë që mund të rrisë rriskun intra apo postoperator dhe planifikimin e një lloj anestezie sa më të sigurtë për pacientin. Syndroma e Isaac është një sëmundje e rrallë e motoneuronit periferik. Hiperexitimi I nervave motor periferik con në ngërce muskulare, myokimi, pseudomiotoni dhe dobësi muskulare. Aktiviteti anormal persiston gjatë gjumit,anestezisë gjenerale dhe mund të mos ndikohet, reduktohet apo hiqet nga blloqet e nervave periferik. Qëllimi: Në këtë punim është paraqitur rasti i një pacienti me sind Isaac,sëmundje tepër e rrallë kjo,janë rreth 200 pacientë në të gjithë botën. Ka shume pak punime dhe case reporte persa I takon kësaj sëmundjeje. Duke u konsultuar me literaturat botërore dhe neurologet tanë, u menaxhua rasti në mënyrë kënaqshme. Në pavionin e ortopedisë bëhet vizita preanestetike e një pacienti me iniciale B. TH. 69 vjec me nr kartele 4543 me frakturë trokanterike. Pacienti dhe familjarët referojnë se vuan nga sindromi Isaacs për të cilën ishte trajtuar fillimisht në pavionin e neurologjisë QSUT, përpara 7 vitesh e më pas në një spital në Stamboll ku I ishte nënshtruar trakeotomisë dhe ventilimit mekanik për disa javë për shkak të ins respiratore nga dobësia e muskujve respiratorë). Aktualisht pacienti i qetë, me respiracion efficient, pa shenja të një ins respiratore, trakeotomia e mbyllur.

Materiale dhe metoda: Në një konsulte me neurologun që e ka ndjekur dhe literaturat që lexuam morëm informacione rreth patologjisë dhe pikëpyetjeve të shumta në përdorimin e anestezisë spinale dhe kurareve. Në këto kushte u vendos që pacienti të realizohej me anestezi endovenoze dhe inhalatore pa përdorimin e kurareve, duke e vlerësuar në moment për një tub me fi të vogël orotrakeal apo një maske laringeale. Pacienti merret në sallë ,monitorohet (EKG, TA, SPO2, end Tidal CO2), I aplikohet 200 mcg fentanyl, 300 mg propofol, intubohet pa problem orotrakeal me tub 6. 5

dhe mbahet manualisht me FiO2 50%. Anestezia mbajtëse sevoflurane 2%. Në fund të interventit iu aplikuan si analgjezike voltaren dhe paracetamol. Ekstubimi pa problem, pacienti shoqërohet në pavion. Del nga spitali pas 8 ditësh.

104. NDIKIMI PSIKOSOCIAL I ESTETIKËS DENTARE

Denisa BUNDO

Abstrakt

Objektivi: Për të vlerësuar ndikimin psikosocial të estetikës dentare në aspektin psikologjik dhe social te subjektet e rinj.

Materiale & Metoda: Lloji i studimit: Studimi është Cross-sectional (transversal).

Vendi dhe Kohëzgjatja e studimit: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Klinikat private në Tiranë, për një periudhë kohore, (mars 2018-shtator 2018). Në studim morën pjesë pacientë të rritur pa trajtim paraprak ortodontik, u pyetën për të plotësuar një version të modifikuar të "Pyetësorit te ndikimit psikosocial te estetikës dentare (PIDAQ) dhe komponentin vetë-vlerësues estetik (AC) të indeksit të nevojës së trajtimit ortodontik [self-rated Aesthetic Component (AC) of the Index of Orthodontic Treatment Need (IOTN)]. U përdorën katër variabla, duke përfshirë: "Vetë-besimi "dentar", "Ndikimi social", "Ndikimi psikologjik" dhe "Nevoja e perceptuar për trajtim ortodontik", ndërsa estetika dentare u vlerësua nga të anketuarit duke përdorur komponentin estetik të IOTN-së (vetë-vlerësimin IOTN-AC).

Rezultate: Të anketuarit ishin 160 të rritur (90 femra dhe 70 meshkuj, të moshës mesatare 22. 3 vjeç), tek të cilët të katër variablat matëse të lartpërmendura mbi ndikimin psikologjik treguan korrelacione pozitive dhe të rëndësishme, perceptuar kjo me rendimin e malokluzionit, sikurse përshkruhet nga komponenti estetik (AC) i indeksit të nevojes se trajtimit ortodontik (IOTN), me vlere (p) prej me pak se 0. 05 për të gjitha variablat. Nënshkalla e "Ndikimit psikologjik" ka pikëzimin më të lartë krahasuar me shkallët e tjera, (ANOVA F-ratio= 19. 8 p<0. 001). Tek meshkujt, ndikimi psikologjik (p=0. 04), social (p=0. 001) dhe vetvlerësimi dentar (p=0. 009), është më i ulët se tek femrat. Nevoja për trajtim endodontik është shprehur më shumë nga femrat krahasuar me meshkujt me ndryshim sinjifikant ndërmjet tyre (p<0. 001).

Konkluzione: Rezultatet tregojnë ndikimin e fortë psikosocial të estetikës të ndryshuar dentare në gjendjen emocionale të një individi. Kjo mund të shpjegohet me fenomenin e "krahasimit social' ku paraqitja e fytyrës, e lidhur me vetë-konceptimin

mund të ndikojë në masën e të qënit një handikap social.

Fjalë kyçe: ndikimi psikosocial, estetika dentare, indeksi i nevojës se trajtimit ortodontik.

105. DIABETI INSIPID TEK FEMIJËT

Prof. Asc. Diamant SHTIZA[1], Prof. Asc. Enkelejda SHKURTI[2], Dr. Maksim BASHO[3], Dr. Blerina SARAÇI[3]

[1]*Nefropediatër, Departamenti i Pediatrise, QSUT "Nënë Tereza"; UMT*

[2]*Lektore e Statistikës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT*

[3]*Mjek radiolog, Shef i Shërbimit te Imazherise dhe DIagnostikes, UMT*

[3]*Mjeke radiologe, Shërbimi i Imazherisë dhe Diagnostikës, Departamenti i Pediatrisë, UMT*

Abstrakt

Diabeti insipid karakterizohet nga sasia e madhe e urinës së holluar (me peshë specifike më të vogël se 1005 dhe osmolaritet më të vogël se ai plazmatik) dhe nga nevoja për të marrë sasi të konsiderueshme lëngjesh. Mund të shkaktohet nga pamjftueshmëria e prodhimit të hormonit antidiuretik (diabet insipid central) ose nga mungesa e përgjigjes renale ndaj hormonit (diabet insipid nefrogjen).

Etiologjia: diabeti insipid central mund të jetë idiopatik ose dytësor (tumore, inflamacione, trauma, autoimun); diabeti insipid nefrogjen mund të jetë kongenital (trashigimi e lidhur me X) ose i fituar (probleme renale, pasojë e medikamenteve).

Klinika: shenjat kryesore janë poliuria e polidipsia; latanti mund të ketë dehidrim, të vjella, temperaturë, konstipacion, vonesë në rritje.

Diagnoza:

1. Urina e 24 orëve (poliuria, densitet <1005, osmolaritet <200 mOsm/L);

2. Osmolaritet plazmatik normal (në mungesë të restriksionit hidrik);

3. Prova e etjes: persistenca e osmolaritetit të ulët urinar dhe i fluksit të lartë është indeks i diabetit insipid central ose nefrogjen; në polidipsinë psikogjene osmolariteti urinar rritet mbi atë plazmatik;

4. Testi me DDAVP provokon shtimin e osmolaritetit urinarne diabetin insipid central, ndërsa nuk e ndryshon ne atë nefrogjen.

5. Rezonanca Magnetike encefalike dhe zona hipotalamo hipofizare.

Terapia: Diabeti Insipid Central: Minirin/DDAVP spray nga hunda (1 puffe=5mcg), 1 pufe në secilën vrimë të hundës 1-2 herë në ditë.

Diabeti Insipid Nefrogjen: Dietë e varfër me kripëra, Diuretike si hidroklortiazid 25 mg 1-2 mg/kg/dite, në 2-3 marrje, Indometacine 1-3 mg/kg/dite (frenuese e sintezës së prostaglandinave me efekt anti-ADH).

106. TRAJTIMI I ZGJATUR I TROMBOEMBOLIZMIT VENOZ ME RIVAROXABAN

Edvin SELMANI

Ortoped-Traumatolog, QSUT

Pedagog i jashtëm, Fakulteti i Mjekësisë, Lënda Ortopedi-Traumatologji

Abstrakt

Qëllimi: Trajtimi me Rivaroxaban është parë se është një alternativë tejet efektive dhe e sigurtë për trajtimin dhe parandalimin sekondar të tromboembolive venoze, por është parë që pas përfundimit të periudhës standarte të trajtimit 6-12 muaj risku për rekurencë persiston. Kjo është arsyeja që është ndërmarrë një studim mbi sigurinë dhe efikasitetin e Rivaroxaban 10 mg për parandalim të rekurencës krahasuar me aspirinën pas përfundimit të terapisë standarte 6 mujore.

Metoda: Në këtë studim "double-blind" u krahasua Rivaroxaban 10 mg, Rivaroxaban 15 mg dhe aspirinë për një periudhë 1 vjecare. Në studim u përfshinë 3300 pacientë të ndarë në mënyrë të barabartë.

Rezultati: Kundrejt aspirinës, Rivaroxabani redukton mesatarisht me 70 % riskun për rekurencë, Xarelto 20 mg 76% dhe Xarelto 10 mg 66%.

Konkluzione: Në paciëntët me tromboemboli venoze Rivaroxaban është një alternativë e sigurtë dhe efikase kundrejt aspirinës në trajtimin e zgjatur. Përveç të dhënave shkencore që mbështesin dhe inkurajojnë përdorimin Xarelto-s, kjo e fundit është një alternativë e lehtë dhe komode që nuk kërkon monitorimin rutinë të antikoagulimit me anë të INR.

107. VLERËSIM SASIOR I LËNDËVE AKTIVE TË KOMBINUARA NË NJË FORME DOZË

Prof. Asc. Ela HOTI, Aurora TAFA, Fabiola NOGA, Elton MYFTARI

Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë,UMT

Abstrakt

Me zhvillimin e industrisë farmaceutike, farmacisti analist përballet me sfida dhe problematika të vazhdueshme në lidhje me çështjen e kontrollit të cilësisë së barnave. Rritja e numrit të formulimeve të reja, shtimi i barnave xhenerikë në treg dhe globalizimi i tregut farmaceutik çon në kërkimin dhe zhvillimin e metodave të përshtatshme analitike për hetimin e cilësisë së barnave. Një interest të veçantë, paraqesin produktet që kombinojnë dy ose më shumë lëndë aktive në një njësi të vetme dozimi. Trajtimet me këto produkte ofrojnë disa përfitime si: thjeshtimin e regjimit të trajtimit, minimizimin e efekteve anësore të tyre dhe përmirësimin e mirëqenies psikologjike të pacientit, që ka perceptimin se marrja e më shumë barnave barazohet me të qenit më i sëmurë.

Kombinimi i Amlodipinës, Valsartanit dhe Hidroklorotiazidit është ndër më të preferuarit për trajtimin e hipertensionit. Zhvillimi dhe validimi i metodave analitike për vlerësimin sasior të njëkohshëm të këtyre lëndëve aktive është sfidues, për shkak të shumëllojshmërisë së problemeve që dalin nga vetitë farmakokinetike, karakteristikave fiziko-kimike, si dhe në shumë raste, diferencës së madhe të sasive të kombinuara. Nga shqyrtimi i literaturës u përzgjodh dhe u optimizua në kushtet tona laboratorike, një metodë RP-HPLC/DAD për vlerësimin sasiorë të njëkohshëm të tyre në një formë dozë. U analizuan tre produkte të ndryshme. Metoda e aplikuar tregoi shkallë të lartë saktësie, linearitet, përzgjedhshmërie dhe përpikmërie.

Tabletat e marra në analizë, kaluan me sukses provat e kontrollit të cilësisë sipas kushteve të përcaktuara nga literaturat zyrtare: provën e paraqitjes, variacionit të peshës dhe përmbajtjes së lëndëve aktive. Të gjitha tabletat, brenda të njëjtit produkt kishin uniformitet në paraqitje. Asnjë nga tabletat nuk kaloi vlerën ± 5%, të devijimit në % të lejuar, sipas udhëzimeve farmakopeale, për tableta me peshë më shumë se 324 mg. Testi i vlerësimit sasior tregoi se të tre produktet plotësojnë kushtin farmakopeal për përmbajtjen e lëndëve aktive në diapazonin 92. 5% - 107. 5%.

Fjalë kyçe: Vlerësim sasiorë; Formë dozë e kombinuar; RP-HPLC/DAD.

108. HIPERTESIONI NË SHTATZANI, PRE-EKLAMPSIA

E. KOLIÇI, A. Lushllari, D. KERI, K. POSHI, E. THOMA

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,UMT

Abstrakt

Qëllimi: Çrregullimet HTA në shtatzëni janë shkaktari kryesor i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë në shtatzani. Aftësia për të parashikuar këto ndërlikime duke përdorur teste të thjeshta mund të ndihmojë në menaxhimin dhe përmirësimin e rezultateve.

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë komplikacionet që sjell hipertensioni tek gratë shtatëzëna dhe diagnozën laboratorike për pre-eklampsinë në bashkëpunim me shenjat klinike dhe analizat e tjera.

Materiale & Metoda: Një studim retrospektiv (Tetor-Dhjetor 2016) u përdor për të vleresuar 52 paciente të grupmoshes nga 17-45 vjec, të diagnostikuara me hipertension arterial. Për këto paciente u vlerësuan mosha e nënës,nr i shtatzanive, vlerat e HTA,prania e patologjive të tjera si diabeti Mellitus, vlerat e transaminazave, proteinurisë, trombociteve, Të dhënat u morën në statistikën e maternitetit "Koço Glozheni".

Rezultate: Në varësi të te dhenave u vu re se kemi një rritje te rasteve me HTA në grupmoshën 35-45 vjec në krahasim me grupmoshat e tjera. U vu re një rritje e rasteve me eklamsi në nënat me patologji bashkeshoqeruese te shtatzanise. Rastet e aborteve është në rritje në rastet në grupmoshat e 35-45 vjec të shoqëruara me patologji të tjera. Nuk u vu re nje lidhje sinjikavive mes vlerave të HTA me ndryshimet biokimike. Nga parametrat biokimike vetëm vlera të larta të proteinurisë janë më të besuara si bashkeshoqeruese e eklamsise.

Konkluzione: Çrregullimet hipertensionale në shtatzëni janë shkaku kryesor i vdekshmërisë amtare në mbarë botën. Incidenca e hipertensionit në shtatzëni vazhdon të rritet. Aktualisht, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë se cili pacient do të zhvillojë këtë patologji. Jo gjithmonë një HTA I rendë shoqerohet me ndryshime të rëndësishme biokimike. Rastet me eklamsi rriten me rritjen e moshës së shtazanise.

Fjalë kyçe: Pre-eklampsi, HTA, Proteinuri, Acid Urik.

109. PREZANTIMI NË URGJENCË I KANCERIT GASTRIK

Dr. Enkela PUCI, Dr. Rovena BODE

Fakulteti i Mjekësisë, UMT
Klinika Nr. 1, Kirurgjia e Përgjithshme, QSUT

Abstrakt

Sfondi: Edhe pse komplikacionet akute që kanë nevojë për shtrim urgjent në spital janë të mirë dokumentuara në kancerin e kolonit, të dhëna të ngjashme për kancerin gastrik janë të pakta. Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë mënyrën e paraqitjes së kancerit gastrik në urgjencë, sfidat në diagnozën e këtyre komplikacioneve dhe mënyrën e trajtimit kirurgjikal në urgjencë.

Materiale & Metoda: Materiali për këtë studim është siguruar nga kartelat e të sëmurëve të paraqitur në shërbimin e Urgjencës Kirurgjikale të Qendrës Spitalore Universitare, Tiranë dhe të trajtuar me kirurgji për komplikacione të kancerit gastrik. Studimi është i tipit retrospektiv dhe është realizuar për periudhën Janar 2018-Qershor 2018.

Rezultate: Në Urgjencën e Klinikës Nr. 1 janë paraqitur me komplikacione të kancerit gastrik, hemoragji ose peritonit, dhe të trajtuar me kirurgji urgjente 14 të sëmurë gjatë periudhës Janar-Qershor 2018. Mosha mediane e tyre ishte 69. 5 vjeç dhe varionte nga 25 -116 vjeç.

Konkluzione: Pacientët me komplikacione të kancerit gastrik paraqiten në stade të avancuara të sëmundjes dhe trajtohen shpesh me kirurgji radikale trajtuese ose paliative.

Fjalë kyçe: Prezantim në urgjencë, kancer gastrik, kirurgji.

110. A INFLUENCON EKSPERIENCA DHE FRIKA E MËPARSHME DENTARE TE PERCEPTIMI I CILËSISË SË JETËS SË LIDHUR ME SHËNDETIN ORAL TE FËMIJËT (OHRQOL)?

Enkelejda SHKURTI[1], Diamant SHTIZA[2], Esmeralda THOMA[1], Batilda NUSHI[3]

[1]*Universiteti i Mjekësise Tiranë*

[2]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

[3]*Fakulteti i Mjekësise Dentare, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Cilësia e jetës e lidhur me shëndetin oral (OHRQoL) është përdorur për të përshkruar pasojat e kushteve dhe trajtimit të shëndetit oral tek fëmijët. Një perceptim më i mirë i cilësisë së jetës e lidhur me shëndetin dentar dhe lidhjen e saj me friken dentare dhe eksperiencën e mëparshme dentare është e nevojshme për të përmirësuar statusin e shëndetit oral të fëmijëve. Qëllimi i këtij studimi është investigimi i asociacionit midis historisë dentare, eksperiencën me frikën dentare dhe cilësinë e jetës së lidhur me shëndetin oral (OHRQoL) tek fëmijët e moshës 11-14 vjeç në Tiranë.

Materiale & Metoda: Një studim kros-seksional u ndërmor duke përdorur një mostër të shtresëzuar të 574 fëmijëve të shkollave nëntëvjeçare në qytetin e Tiranë të moshës 11-14 vjeç. Informacioni rreth OHRQoL u mblodh tek fëmijët duke përdorur (CPQ) pyetësorin e perceptimit të fëmijëve dhe informacioni rreth frikës dentare u akumulua duke përdorur nënshkallën dentare të skedës së survejimit të frikës së fëmijëve (CFSS-DS). Informacioni mbi eksperiencat e mëparshme dentare dhe të dhënat sociodemografike u mbodhën nga prindërit duke përdorur pyetësorë të vetë-administruar. Ekzaminime dentare u performuan për të vlerësuar eksperiencën e kariesit.

Rezultate: Modeli multivariat vlerësoi se frika dentare ishte indikatori më i fortë i OHRQoL sepse fëmijët që kishin frikë kishin një mesatare të rezultateve të pyetsorit të perceptimit të fëmijëve (CPQ) që ishte 10 njësi më e lartë sesa ajo e fëmijëve që nuk kishin frikë. Në lidhje me eksperiencën e mëparshme dentare, dhimbja si arsyeja në vizitën më të fundit dentare ishte e asociuar me një cilësi të ulët të OHRQoL, ndërsa vizita e një mbushjeje gjatë takimeve të mëparshme dentare ishte në mënyrë sinjifikante e lidhur me një cilësi më të lartë të jetës së lidhur me shëndetin oral (OHRQoL. Duhet shtuar se të ardhurat e pakëta familjare, një edukim i ulët prindëror, problemet me shëndetin dhe hospitalizimin ishin në mënyrë sinjifikante të lidhura me cilësinë e jetës së lidhur me shëndetin oral (OHRQoL).

Konkluzione: Ky studim identifikoi se frika dentare dhe disa faktorë të lidhur me eksperiencat e mëparshme dentare ishin të asociuara me cilësinë e jetës së lidhur me shëndetin oral (OHRQoL). Në praktikën dentare duhen identifikuar fëmijët që paraqesin frikë dentare të udhëhiqen dhe të trajtohen herët për të parandaluar keqësimin e cilësinë e jetës së lidhur me shendetin oral (OHRQoL).

Fjalë kyçe: Cilësia e jetës së lidhur me shëndetin oral (OHRQoL), frika dentare,

indikatorët e eksperiencës dentare.

111. DIAGNOSTIKIMI NË KOHË I NEOPLAZIVE ORBITALE

Dr. Eralda LECI[1], Dr. Altin JUSUFATI[2], Dr. Bledar CURRAJ[3]

[1]*Okuliste QSUT;*

[2]*Imazherist Qsut;*

[3]*Specializant Okulistike*

Abstrakt

Qëllimi: Prezantimi i një rasti klinik me neoplazi të orbitës, me ecuri të shpejtë (6 mujore) dhe përfundim në exitus.

Metoda & Rezultate: Pacienti paraqitet në shërbimin e okulistikës me ankesë kryesore: Ekzoftalmi unilaterale dhe ulje e moderuar e shikimit. Pas ekzaminimit oftalmologjik, pacienti referohet për konsulte në shërbimin e endokrinologjisë për të përjashtuar Morbus Grave. Pacienti paraqitet përsëri në okulistikë pas rreth 3 muajsh me proptoze, distopi, humbje totale të shikimit. Në konsultë me mjekët neurokirugë, okulistë, vendoset transferimi në shërbimin e onkologjisë për trajtim me rrezatim. Pas rreth 3 muajsh trajtimi, pacienti përfundon me exitus letalis.

Konkluzione: Neoplazitë e orbitës janë patologji me ecuri dhe prognozë të ndryshme në varësi të natyrës dhe origjinës se tyre. Diagnostikimi në kohë i tyre ndikon në fillimin e trajtimit të tyre, paliativ apo terapeutik. Është e rëndësishme që të ketë një bashkëpunim të ngushtë midis shërbimeve të ndryshme, ku paraqiten apo referohen këta pacientë.

112. MANIFESTIMET KLINIKE DHE DIAGNOZA NË ALERGJITË MUKOZALE TË KONTAKTIT DHE SINDROMAT ALERGJIKE ORALE

Dr. Eralda LEKLI

Mjeke Specializante, Shërbimi i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Ekspozimi i vazhdueshëm i mukozës orale ndaj agjentëve irritues dhe alergeneve të ndryshëm në ushqime, materialet dentare dhe produktet e higjienës orale, të cilët përmbajnë agjentë aromatizues dhe konservues kanë ndikuar në rritjen e prevalencës së sëmundjeve alergjike që prekin mukozën orale. Spektri i shenjave dhe simptomave të alergjive qe prekin mukozen orale është i gjerë dhe lidhen me së shumti me stomatitin dhe cheilitin alergjik te kontaktit, gjuhën gjeografike, reaksione lichenoide orale, sindromin e djegies orale (burning mouth syndrome) dhe në vecanti sindroma të alergjisë orale polen-ushqim.

Ky spektër i gjerë i paraqitjeve klinike, materialeve dhe alergeneve që mund ta shkaktojnë e bejnë të vështirë interpretimin e rezultateve të patch testeve dhe vlerësimin e relevancës klinike të haptenëve të gjetur pozitiv në alërgjitë e kontaktit. IgE specifike, testi i aktivizimit të bazofileve dhe së fundmi diagnoza e bazuar në komponentët molekular, përbën një inovacion në diagnozë vecanërisht në rastet e sindromave orale polen-ushqim, ku pacientet e sensitivizuar ndaj poleneve të pemëve dhe graseve mund te paraqesin simptoma alergjike të izoluara në mukozën oro-faringeale pas konsumimit të disa lloje frutash dhe perimesh për shkak te pranisë së molekulave të cross-reaktivitetit si: PR-10, profilinat, Bet v1, Bet v2, proteinat e transportit lipidik, albuminat, etj.

E vështirë, por me metoda inovative në dispozicion, diagnoza dhe identifikimi i alergeneve me qëllim eleminimin e shkaktarit apo imunoterapine alergen specifike është celësi për adresimin e rasteve me fenomene alergjike të izoluara të mukozës orale, shpesh te nendiagnostikuara dhe me impakt negativ në cilësinë e jetës së pacienteve.

Fjalë Kyçe: Sindroma alergjike orale, Alergjitë mukozale te kontaktit, Diagnoza e bazuar ne komponente molekular, Cross-reaktiviteti.

113. EFIKASITETI I TRAJTIMIT ME TESTOSTERON NË DEFICENSËN E TESTOSTERONIT

Dr. Ervin DANI

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i terapisë me testosteron është të arrihen nivelet e duhura te tesoteronit në gjak në përputhje me moshën e pacientit. Rasti i vetëm në të cilat

format e tjera të trajtimit mund të jenë të nevojshme është vetëm nëse ekziston dëshira për fertilitet. Këto trajtime duhet të aplikohen në qendra të specializuara për mjekësinë riprodhuese. Trajtimi me testosteron duhet të jetë individual në varësi të moshës së pacientit dhe nevojave të tij. Duhet të monitorizohet trajtimi për të vlerësuar përmirësimin e simptomave.

Si funksionon: Komponenti aktiv është testosteron undecanoate, i cili është një ester i testosteronit nayral. Testosteron undecanoate sillet në të njëjtën mënyrë si testosteroni natyral në organizëm. Menjëherë pas injeksionit, testosteron undecanoate çlirohet gradualisht në qarkullimin e gjakut dhe më pas metabolizohet në mëlci dhe në organe dhe inde të tjera.

Një dozë përmban 1000 mg testosteron undecanoate në 4ml solucion vajor. Kjo dozë çon në një përqëndrim stabël të tëstosteronit për një periudhë kohe të gjatë.

Pas dhënies së dozës së parë, nivele normale të testosteronit në serum arrihen brënda javës. Piku i testosteronit që tejkalon kufirin normal përjashtohet. Me përjashtim të dozës së dytë, e cila meret 6 javë pas dozës së parë, dozat e reja të Nebidos meren 12 javë më pas. Midis dozës së parë dhë të dytë, përqëndrimet në serum mbeten në nivele normale.

Konkluzione: Qëndrueshmëria e testosteronit, efikasiteti i sigurtë i saj dhe kohëzgjatja e efektit e bën atë si zgjedhjen më superiore të trajtimit. Është i leverdisshëm dhe i thjeshtë. Vetëm 4 injeksione me testosteron kërkohen në vit, ndryshe nga trajtimet e tjera që kërkojne me përafërsi 20 injeksione në vit. Eviton luhatjet (ulje dhe ngritje) të testosteronit në serum, duke përjashtuar problemet që lidhen me luhatjet e humorit që mund të japin opsionet e tjera të trajtimit me testosteron injeksioni. Është provuar të jetë shumë efektiv në trajtimin e hypogonadizmit mashkullor: përmirëson libidon dhe funksionin seksual, influencon pozitivisht në gjendjen e humorit, rrit fuqinë muskulare, përmirëson formën trupore (pakëson shpërndarjen e indit dhjamor, rrit masë trupore). Ruhen nivelet e testosteronit në kufinj normal 3 ditë pas administrimit të parë të injeksionit. Është parë të jetë i mirëtolerueshëm.

114. IMPAKTI I ARTRITIT REUMATOID (AR) NË PATOLOGJITË E KAVITETIT ORAL

Ervin RAPUSHI[1,2,3], Teuta BACKA1, Artur ZOTO[1], Lediana NUHAJ[1], Valbona SALKO[1], Elona XHERAHU[1], Irena KOLA[1,2], Indin XHEMAILI[3]

[1]*Shërbimi Reumatologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*

[2]*Fakluteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë, Tiranë*

[3]*Poliklinika Gjermane Tiranë*

Abstrakt

AR është një sëmundje sistemike autoimmune, kronike me prekje artikulare dhe extra artikulare. Stuhia inflamatore në AR, medikamentet e përdorur në trajtimin e AR si edhe komplikacionet e tij atakojnë cdo strukturë të kavitetit oral.

Cilat janë gjetjet më shpeshta patologjike të kavitetit oral në pacientët me AR:

- AR gjatë ecurisë së tij prek artikulacionin TMP.
- Osteoporoza në pacientët me AR prek mandibulën dhe maksilën duke shkaktuar instabilitet dentar si edhe dëmtim të protezës.
- Infalmacioni sistemik në AR shkakton inflamacion të mishrave të dhëmbëve (gingivitis) dhe karies.
- Sindromi Sjogrën në AR shkakton inflamacion të gjendrave salivare dhe ulje të sekrecioneve salivare (Xerostomia).
- Infeksione orale bakteriale dhe fungale, të favorizuara nga imuniteti i ulur gjatë trajtimit me preparate modifikuese të sëmundjes.
- Ulceracione orale të shkaktuara nga infalamioni (vaskuliti) në AR por edhe nga trajtimi me MTX.

Të dhëna nga studimet: Aktualisht periodentitis është tregues i severitetit të AR; kariesi dentar korrelon shumë mirë me Sindromin Sjogren; matja e densitetit kockor në mandibul/maksil me anë të DXA është faktor parashikues për ecurinë e protezave dhe implantet dentare; janë të njëtat qeliza inflamatore që gjenden në indet e artikulacioneve skeletike të prekura nga AR si edhe në indet e kavieteit oral te pacienteve me AR; gjendet një korrelacion në disa studime ndërmjet incidencës së humbjes së dhëmbëve dhe nivelit të CCP në pacientët me AR; intoksikacioni në MTX në pacientët me AR shenjën e parë e jep në strukturat e kavitetit oral; infeksioni në kavitetin oral agravon simptomat e AR.

Konkluzione: Si përfundim mund të themi që AR gjatë dekursit, si edhe preparatet që përdoren për trjatimin e tij paraqesin impaktin e vet në cdo strukturë përbërëse të kavitetit oral.

115. DEPRESIONI DHE STIGMA MIDIS STUDENTËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

Dr. Gentjan Asllanaj

Rezident, Shërbimi i Psikiatrisë, QSUT

Abstrakt

Hyrje: Depresioni përfshin një gjendje të zgjatur të humorit të ulur, humbjes së shpresës apo humbjes së energjisë. Për fat të keq, ky problem nuk trajtohet si sëmundjet e tjera, por rrethohet nga stigma. Stigma përfshin ndjenjën e turpit që i veçon njerëzit dhe i identifikon ata si të ndryshëm apo të padëshirueshëm. Duke qenë një patologji që prek të gjitha grupmoshat apo gjinitë, të rriskuar janë edhe studentët e shkencave mjekësore.

Qëllimi: nxjerrja e statistikave dhe krijimi i një lidhjeje të mundshme midis studimit në universitetet mjekësore dhe depresionit dhe stigmës.

Materiale & Metoda: U realizua një studim i cili përfshiu 348 studentë, të fushave të ndryshme, si: mjekësi e përgjithshme, mjekësi dentare, infermieristikë, farmaci etj. Studentët ishin pjesë e universiteteve publike dhe shtetërore në Shqipëri. Ata plotësuan një formular me të dhënat e tyre të përgjithshme: mosha, gjinia, universiteti, fakulteti, viti, vendlindja, gjendja ekonomike, dhe me të dhëna në lidhje me situate depressive në jetën e tyre dhe gjatë viteve të universitetit. Të dhënat u analizuan me SPSS.

Resultate: Studimi tregoi se rreth 1 në 3 persona kishin shfaqur shenja depresive të paktën një here në jetën e tyre, të lidhura me problemet familjare, problemet ekonomike apo problemet shoqërore. 28,16 % e tyre kishin kaluar të paktën një situatë depresive gjatë viteve të universitetit e lidhur kjo me universitetin. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë kërkuar trajtimin psikiatrik dhe rreth 13 raste kanë tentuar apo kanë kërcënuar se do të vetëvriten.

Konkluzione: Depresioni dhe mendimet vetëvrasëse te studentët e mjekësisë ndikojnë negativisht së pari në shëndetin afatgjatë të tyre dhe së dyti në aftësitë e tyre profesionale. Shkaqet mbizotëruese të këtyre gjendjeve janë stresi dhe ankthi si pasojë e konkurrencës së lartë mes studentëve. Lind nevoja në krijimin e një fryme më pozitive në universitete midis studentëve dhe pedagogëve.

Fjalë kyçe: depresioni, stigma, studentë, mjekësi, mjekësi dentare, farmaci

116. BESUESHMËRIA E PERCEPTUAR E INFORMACIONEVE SHËNDETËSORE NË MEDIAT SOCIALE

Dr. Gentjan LITA, Dr. Shk. Ilir ALIMEHMETI

Fakulteti i Mjekësisë, UMT

Departamenti i Mjekut të Familjes dhe i Sëmundjeve Profesionale, UMT

Abstrakti

Media sociale po kthehet dita ditës në një hapësirë shumë të rëndësishme komunikimi jo vetëm për ndërlidhjen me njerëzit, por edhe gjithashtu për të përcjellë informacione shëndetësore me publikun.

Qëllimi & Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë sa i besojnë shqiptarët informacionet shëndetësore online dhe në mediat sociale dhe si ndikojnë ato në sjelljet e tyre shëndetësore.

Materiale & Metoda: Studimi është i llojit cross-sectional ku është realizuar një pyetësor online mbi perceptimin e besueshmërisë së informacioneve shëndetësore në mediat sociale nga ana e popullatës shqiptare dhe ndikimin në sjelljet e tyre shëndetësore. Pyetësori përbëhej nga të dhënat socio-demografike dhe Informacionet shëndetësore dhe mediat sociale, ku është përfshiheshin hi frekuenca e përdorimit të mediave sociale, besueshmëria e perceptuar dhe preferencat mbi komunikimin shëndetësor në mediat sociale në popullatën shqiptare. Varianti përfundimtar është shpërndarë përmes rrjeteve sociale dhe platformave online.

Rezultate: Pyetësori online u plotësuan nga 517 persona, 69. 6% femra (n=360) dhe 30. 4% meshkuj (n=157). Mosha varionte nga 14-76 vjeç, ku mosha mesatare ishte 23. 9 vjeç (SD=5. 56). Sa i përket arsimit, 80. 7% ishin me arsim të lartë (universitet, n=417), 14. 1% ishim me arsim pas-universitar (n=73). Nga ana tjetër, 76. 6% (n=396) studionin apo kishin studiuar në shkencat mjekësore (si p. sh. mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmaci, infermieri etj.). 66. 3% e njerëzve i drejtohen internetit si burim i parë për të marrë informacion shëndetësor (përkatësisht 57. 4% në website të huaja dhe 8. 9% në website shqip). Ndërkohë, 16. 6% i drejtohen personelit mjekësor, 13. 5% i marrin nga librat mjekësore dhe vetëm 1. 2% raportojnë se i drejtohen rrjeteve sociale. 3. 3% shprehen se më shpesh kërkojnë informacione mbi shëndetin në rrjetet sociale (Facebook, Instagram etj.); 3. 9% shkojnë në Youtube, 7. 7% në Portale shqip; 77. 0% kërkojnë në website të huaja (p. sh. wikipedia anglisht), si dhe 5. 4% kërkojnë në website të huaja apo lexojnë artikuj shkencor.

Konkluzione: Interneti mbetet burimi kryesor për të marrë informacione shëndetësore, ku mbi 40% shprehen se kërkojnë shpesh informacion shëndetësor online. Informacionet shëndetësore në mediat sociale konsiderohen si pak ose mesatarisht të besueshme, ku pjesa më madhe e atyre që kërkojnë informacion shëndetësor online e bëjnë për të vendosur nëse duhet të shkojnë te mjeku apo jo. Nga ana tjetër, mbi 60% shprehen se do të dëshironin që të konsultoheshin me mjekun e tyre përmes mediave sociale apo platformave online.

Fjalë kyçe: informacion shëndetësor, media sociale, besueshmëri, sjellje shëndetësore, popullata shqiptare.

117. KOLELITIAZA DHE KOLECISTITI AKUT. TRAJTIMI KIRURGJIKAL

Dr. Hysni DIDA[1], Prof. Asc. Sokol PAPARISTO[2]

[1]Fakulteti i Mjekësisë, UMT

[2]Shërbimi i Kirugjisë së Përgjithshme, Klinina Nr. 1, QSUT "Nënë Tereza"

Abstrakt

Litiaza biliare është prania e gurëve biliarë në vezikën biliare apo në rrugët biliare që krijohen si pasojë e prishjes së homeostazës biliare dhe kryesisht të mekanizmit që ka të bëjë me tretshmërinë e kolesterolit e të kriprave biliare.

Qëllimi: Qëllimi i studimit të ndërrmarrë është vrojtimi i trajtimit të pacientëve me kalkulozë të kolecistës dhe të ndërlikimeve të saj si kolecistit akut kalkuloz, kolecistit akut gangrenoz. Gjithashtu të bëhet një pasqyrë e trajtimit kirurgjikal, teknikave të përdorura në varësi të diagnozës dhe fazës klinike të sëmundjes.

Materialet & Metoda: Metodologjia e përdorur në këtë studim është e tipit retrospektiv analitik. Të dhënat janë marrë nga librat e operacioneve të klinikës I, për operacionet e kryera në periudhën janar-dhjetor 2017.

Rezultate: Në studim janë marrë 173 raste. Nga studimi u vu re se kishte një predominim të gjinisë femërore, grupmosha me e shpështë është 50-70 vjec per te dyja gjinite. Diagnoza predominuese ishte litiaze e kolecistës. Ditëqëndrimi mesatar rezultoi 2.49 ditë për të gjithë pacientët ku shumica (70%) qëndronin më pak se tre ditë. Teknikat kirurgjikale më të përdorura në klinikën Nr.1 janë kolecistektomia e hapur retrograde dhe kolecistektomia laparoskopike. Nga rastet e paraqitura vetëm 4 ishin paraqitje të ndërlikuara të kolelitiazës. Ato ishin kolecistit akut gangrenoz, masë në kolecistë, pankreatit nekrotiko hemorragjik, pankreatit. Gjatë kolecistektomisë përshkrimet makroskopike janë këto 129 raste me kolecistë me parete të trasha (74.5%), 11 raste me kolecistë skleroatrofike 6%, kolecista hidroptike do të kemi 71 raste (41%), inflamacion gangrenoz vetëm në një rast. Rastet me vetëm një kalkul ishin 26 (15%) me shumë kalkula janë 83 (47 %) dhe rastet ku janë gjetur kalkula dhe në koledok janë 22 (12%).

Fjalë kyçe: kolelitiaza, kolecisitit, kolecistektomia e hapur, kolecistektomia laparoskopike.

118. REZONANCA MAGNETIKE E GJIRIT

Dr. Shk. Ilirian LAÇI[1,3], Dr. Alketa SPAHIU[2], Dr. Ervehe DERVISHI[1], Blendi DISHA[1], Elvis ANTONI[1], Geriart KOLA[1]

[1]*Spitali "Villa Maria", Tiranë*

[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3 Tiranë*

[3]*QSU"Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt

Kanceri i gjirit është kanceri i dytë më i zakonshëm te femrat. Ai zë 1/3 e kancereve të diagnostikuara te femrat dhe është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve në SHBA dhe Evropë. Rreziku mesatar i prekjes nga kanceri i gjirit është 1 ne 8 gra afërsisht 12%. Në këtë kohë MRI e gjirit është bërë një modalitet shumë i rëndësishëm për zbulimin,vleresimin si dhe menaxhimin e kancerit të gjirit. MRI është shumë e rëndësishme në paciente me rrisk të lartë për kancer gjiri,vlerësismi i lezioneve multifokale dhe bilaterale të gjirit,vlerësimi i trajtimit me kimioterapi i kancerit të gjirit. Gjithashtu MRI jep të dhëna të rëndesishme në paciente me gjinj dens ku vlerësimi me ekografi dhe mamografi është i vështire ose jo konkludues.

Sipas ACR (American Collage of Radiology) janë vendosur disa standarte për realizimin e MRI të gjirit ku pershihen sekuenca (T2-weighted), (multi-phase T1 weighted) ku të dy gjinjtë duhet të ekzamininohen njëkohesisht. Imazhet pre dhe post kontrast në (T1 weighted) bëhen ne prerje ≤ 3. 0 mm. Imazhet (T1 weighted GRE) përftohen në dinamikë të njëpasnjëshme nga faza e shpejte deri në fazë të vonë,pas injektimit të kontrastit. Programi kompjuterik bën përpunimin e imazheve për të vlerësuar imprenjimin e tumorit në faza të ndryshme dhe na jep të dhëna lidhur me karakteristikat e tumorit. DWI (Diffusion weighted imaging) dhe ADC (Apparent diffusion coefficient) japin të dhëna të vlefshme në diferencimin e tumoreve beninje nga ata malinje.

Vlerësimi i lezione varet nga shumë faktorë ku më kryesorët janë karakteristikat morfologjike dhe karakteristikat e kontrastimit. Imazhet në fazat e vonshme janë shumë të rëndësishme për DCIS (Ductal Carcinoma in Situ) të gradës së ulët. Ne gjithashtu në praktikën e përditshme realizojmë sekuencat (T2 weighted) dhe (T1 weighted) me FOV të zgjeruar ku përfshijmë të gjithe toraksin në prerje aksiale për të vlerësuar paretin torakal,inflitrimin muskujve apo strukturave të tjera të paretit nga kanceri i gjirit. Në keto sekuenca kemi gjetur prezencen e metastazave hepatike,pulm onare,mediastinale, kockore, indet të buta etj.

Gjithashtu në këto sekuenca bëhet vlerësimi i adenopative aksilare,supra dhe infraklavikulare në ndihmë të stadifikimit për të planifikuar edhe mënyrën e trajtimit. Klasifikimi në MRI pas ekzaminimit bëhet gjithmone sipas sistemit BIRADS i cili është i njëjtë me klasifikimin që përdorim në mamografi, ku: BIRADS 0

konsiderohet imazh jo i plotë ku kërkohen edhe ekzaminime te tjera shtesë, BIRADS 1 konsiderohet ekzaminim normal, BIRADS 2 konsiderohen lezione beninje, BIRADS 3 konsiderohet lezion probabilisht beninj i cili kërkon ndjekje të shpejtë (6 mujore) pasi edhe ne keto paciente kane rezultuar 0,3 deri 1,8 % malinjitet, BIRADS 4 lezione me dyshim të lartë malinjitet 10 deri 55 % prandaj rekomandohet biopsi, BIRADS 5 lezione malinje 60 deri 100% prandaj rekomandohet biopsi dhe BIRADS 6 lezione te konfirmuara malinje.

119. MELANOMA

Dr. Jonida PJETRUSHAJ[1], Dr. Shk. Monika FIDA[2]

[1]*Mjeke e përgjithshme, Urgjenca e Spitalit Rajonal Lezhë, Shqipëri*

[2]*Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Dermato-Venerologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

Abstrakt

Hyrje: Melanoma është një sëmundje malinje e cila e merr origjinën nga melanocitet të cilat ndodhen në shtresën bazale të epidermës. Zakonisht shfaqet si një lezion i hiperpigmentuar në lëkurë ose mukoza por mund të jetë dhe amelanocitare. Prevalenca globale është në rritje. Faktorët e riskut përfshijnë ekspozimin në diell, fenotipin I&II të lëkurës, faktorët gjenetikë, imunosupresioni, praninë e nevuseve kongenital gjigant, praninë e mbi 50 nevuseve melanocitik.

Qëllimi: Të vlerësohen karakteristikat klinike dhe epidemiologjike të melanomës për vitin 2015-2016 të pacientëve të diagnostikuar me melanomë.

Materiale & Metoda: Ky studim është realizuar në periudhën janar 2015- shtator 2016. Në studim janë marrë pacientë të shtruar në Shërbimin e Dermatologjisë, QSUT, Tiranë. Të dhënat janë nxjerrë nga regjistri i shtrimeve, kartelave klinike, regjistri i dermatoskopisë ,regjistri i biopsive kutane dhe regjistri i daljeve gjatë kësaj periudhe. Të dhënat e pacientëve janë hedhur në një database të përgatitur në Exel dhe Megastat.

Rezulutate & Konkluzione: Rezultoi që gjatë periudhës janar 2015-shtator2016 u diagnostikuan, u hospitalizuan dhe u trajtuan në Shërbimin e Dermatologjisë 25 pacientë. Në këtë studim rezultoi që përqindja më e madhe e të diagnostikuarve me melanoma është meshkuj sesa femra respektivisht 44% me 56%. Grupmosha që predominon është grupmosha 51-60 vjeç me moshë mesatare 51 vjeç. Përsa i përket ditëqëndrimit në spital, më i shpeshtë ka qënë 5 ditë ndërsa ditëqëndrimi mesatar ka qënë 6 ditë. Numri më i madh i pacientëve ka qënë nga Tirana dhe qytetet përreth me 48% për Tiranën, e pasuar nga Lushnja dhe Fieri me nga 12%. Melanoma sipërfaqësore është tipi histologjik më i shpeshtë. Kjo shikohet qartë dhe në studimin tonë ku 60% të rasteve e zë melanoma sipërfaqësore e ndjekur nga ajo nodulare me

28%.

Fjalë kyçe: Melanoma, dermatoskopi, nevus atipik, Breslow, Clark.

120. KANCERI KOLOREKTAL DHE "SCREENING KOLONOSKOPI"

K. SHEHU[1], M. SINA[2], G. ASLLANAJ[3], K. POSHI[1], M. GEGA[1]

[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT*

[2]*Shërbimi i Gastrohepatologjisë ,QSUT*

[3]*Universiteti Aldent , Tiranë*

Abstrakt

Kanceri kolorektal renditet si shkaku I tretë I vdekshmërisë tek gratë dhe I dyti tek burrat. "Screeining" kolonoskopi ul pasojat e kancerit kolorektal nëpërmjet diagnostikimit të hershëm si dhe nëpërmjet evidnetimit dhe heqjes së polipeve prekancerozë. Mënyra ideale për screening e kancerit kolorektal duhet të jetë kosto-efektive, të jetë e pranueshme nga pacientet, me sukses të lartë në evidentimni e lezioneve prekanceroze dhe me intervale të gjata midis ekzaminimeve. Ka shumë mënyra për të bërë screning për kancerin kolorektal dhe asnjë prej tyre nuk është perfekte.

Në varësi të politikave mjekësore në vende të ndryshme janë zgjedhur modalitet të ndryshme për screeining. Në shqipëri ende nuk janë aplikuar ekzaminime screeining për kancerin kolorektal. Kemi marrë të dhëna nga medline pubmed mbi të dhënat e fundit nga shtete ku është aplikuar screening për kancerin kolorektal. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se screenining kolonoskopi e ul rriskun relativ për incidencën e CRC me 61% dhe me uljen deri në 61% mortalitetin nga CRC në pacinetët të cilët nuk kishin gjetje malinje. Në disa grupmadje analiza tregoi se screeining kolonoskopi ishte dhe me efektive, deri në 89% reduktimin e incidences së CRC krahasimisht me kolonoskopinë diagnostike.

Sipas të dhënave tona të marra në QSUT nga viti 2011-2016 janë diagnostikur 265 pacient me CRC nga të cilët 62,5 % rezultuan në gr III dhe të IV te patologjisë. Përqindja e lartë e të diagnostikuarvë në grada të përparuara të sëmundjes vjen për disa shkaqe ku një ndër to është mungesa e screeining të kancerit kolorektal.

Konkluzione: Në bazë të meta analizës nga studime të ndryshme incidenca dhe mortalitet I CRC ulen ndjeshëm pas fillimit të kolonoskopisë screeining. Ky efekt është shumë më I ndjeshëm se sa në rastin e kolonoskopisë diagnostikuese. Në

shqipëri lind nevoja për aplikimin e politikave për screeining në CRC si me fece gjak okult ashtu edhe me kolonoskopi në mënyrë që të ulet incidenca dhe mortaliteti nga kjo patologji.

121. PREVALENCA E ANTI-TPO NE PACIENTET ME SUBCLINIK DHE HYPOTIROIDIENE.

K. POSHI, K. Xhaferi, A. NURÇE, E. KOLIÇI, E. RUSTAMI, M. GEGA

Abstrakt

Hipotireoza subklinike është nje gjendje ku demtimi lehtetsisht I qelizave tiroidiene ka ne thelb te dhenat laboratorike Hormon stimulues të serumit në serum (TSH) është lehtetsisht i rritur dhe një përqendrim normal i tetra tireottirazes (FT4).

Qëllimi i studimit është vlerësimi i prevalencës së antitrupave antioksidantë anti-tiroide (anti-TPO) midise pacientëve me hipotireoza klinike dhe subclinike

Materiale & Metoda: Studimi është I tipit prospektiv ku perfshihen 50 pacientë me egzaminime laboratorike dhe te dhena klinike per hypotiroze dhe subklinik hypotiroidienet. Hipotireoza është situate klinike ku laboratorikist rezulton me hormon stimulues tiroide (TSH)> 5. 0 μIU / ml me FT4 normale.

Rezultate: Nga 50 raste, 28 subjekte kishin hypothyroidism klinike (25 femra dhe 3 meshkuj) dhe 22 kishin subklinik Hypothyroidism (14 femra dhe 8males). Midis 50 subjekteve me hypothyroidism klinike dhe subklinik 33 ishin anti-TPO pozitive. Përqindja korresponduese e pozitivitetit anti-TPO e vërejtur në pacientet me hypothyroidism klinike dhe grupet hipotireoze subklinike ishin përkatësisht 80% dhe 50%.

Konkluzione: Egzaminimet laboratorike te TSH dhe anti-TPO janë thelbësore në përcaktimin e etiologjisë së hipotiroidizmit dhe rrezikut e përparimit në hypothyroidism të pacientëve hypotiroze subklinike.

Fjalë kyçe: Hypothyroidism klinike, hypothyroidism subklinik TSH, anti-TPO antitrupa.

122. REHABILITIMI PULMONAR NË PACIENTËT ME SËMUNDJE PULMONARE

OBSTUKTIVE KRONIKE DHE ATA ME INSUFICIENCË KARDIAKE KONGJESTIVE

Ledi NEÇAJ

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësor Tiranë

Abstrakt

Vështirësia e frymëmarrjes që shoqërohet me anomalitë kardio-respiratore dhe diskomfortin e muskujve periferik janë faktorët kryesorë që kufizojnë aftësinë ushtrimore në pacientët me sëmundje pulmonare obstruktive kronike (SPOK) dhe ata me insuficiensë kardiake kongjestive (CHF). Të dyja këto sëmundje ndikojnë negativisht në nivelet e përditshme të aktivitetit fizik të pacientëve. Nga ana tjetër, aktiviteti i dobët fizik i përditshëm zakonisht lidhet me normat e rritura të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. Mes pacientëve të referuar me sëmundje të arterieve koronare, përfundimi i Rehabilitimit Kardiopulmonar është i lidhur me jetesë të përmirësuar dhe ulje të hospitalizimit.

Ky është një studim prospektiv në pacientë të cilët iu nënshtruan operacionit kardiak dhe pulmonar në qendrën spitalore universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, gjatë periudhës 2015-2017. Pacientët u vlerësuan para dhe pas rehabilitimit kardiak (CR). Duhet të merren parasysh programet e rehabilitimit pulmonar për pacientët me SPOK të të gjitha fazave, të cilët kanë simptoma respiratore dhe / ose që nuk kanë tolerancë ndaj aktivitetit fizik, pavarësisht trajtimit optimal farmakologjik.

Fjalë kyçe: rehabilitimi kardio-pulmonar, kapaciteti i ushtrimeve, program trajnimi.

123. KRITERET E REJA DIAGNOSTIKE TË DERMATOPOLIMIOZITIT (DPM) DHE DIAGNOZA DIFERENCIALE ME MIOPATITË E TJERA

Lediana NUHAJ[1], Teuta BACKA[1], Artur ZOTO[1], Ervin RAPUSHI[1], Valbona SALKO[1], Elona XHERAHU[1]

[1]*Shërbimi i Reumatologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*

Abstrakt

Dermatopolimioziti, (DPM), është një miopati inflamatore idiopatike që në bazë të sistemit që prek ndahet në polimiozit (PM) dhe dermatomiozit (DM). PM karakterizohet nga dobësi muskulare proksimale simetrike, rritje e enzimave muskulare skeletale si dhe nga ndryshime karakteristike në EMG dhe biopsi muskulare. DM ndryshe nga PM ka edhe prekjen karakteristike kutane përveç prekjes muskulare por mund të prekë gjithashtu edhe artikulacionet, pulmonin, ezofagun dhe më rrallë zemrën.

Diagnoza e DPM: vendoset në bazë të anamnezës, ekzaminimit objektiv, ekzaminimeve laboratorike dhe imazherike. Në ekzaminimet laboratorike mund të gjendet: leukocitozë ose trombocitozë (leukocitoza është e pranishme në > 50% të pacientëve), rritja e ERS dhe PCR (50% të pacientëve), rritja e enzimave muskulare, transaminazat, mioglobinuria, autoantitrupat, FR pozitiv në 50% të pacientëve.

Nivelet e CK zakonisht rriten nga 5-50 herë më shumë se vlerat normale dhe është ekzaminimi më i ndjeshëm në DPM. Aldolaza dhe LDH rriten gjithashtu por mund të jenë edhe në nivele normale. ANA mund të jenë pozitive por nuk janë të nevojshme për diagnozën.

Antitrupat anti-Mi-2 janë shumë specifike për DM por ndjeshmëria është e ulët, është pozitive vetëm në 25% të rasteve. Këto antitrupa lidhen më shumë me DM klasik me fillim akut, duke përfshirë shenjën klasike të shallit në formë V (poikiloderma), si dhe shoqërohet me një prognozë të mirë. Antitrupat anti-Jo-1 gjenden më shpesh në pacientët me PM por mund të shfaqen edhe në ata me DM. Këto antitrupa janë të lidhur me prekjen pulmonare, fenomenin Raynaud dhe duart e mekanikut në kuadrin e një sindrome anti-sintetazë. Antitrupat anti-SRP janë pozitivë në rreth 4% të pacientëve me PM dhe lidhen me fillimin e shpejtë të një lodhje të theksuar, rritje të incidencës për prekje kardiake dhe me një shkallë më të lartë mortaliteti. Antitrupa të tjerë miozit-specifikë janë TIF1-γ, anti-p155/p140, anti-CADM-140, NXP2 dhe SAE por që përdoren rrallë në praktikën klinike.

Është e rëndësishme që të kryhen testet e nevojshme për të përjashtuar një sëmundje malinje duke u nisur nga mosha dhe gjinia e pacientit: RX, CT, MRI, mamografi, endoskopi. Gjithashtu duhet të kryhen testet funksionale respiratore dhe kapaciteti i difuzionit për të vlerësuar një sëmundje intersticiale pulmonare, ekokardiografia dhe EKG për funksionin kardiak, radioskopia e ezofagut me barium për të vlerësuar peristaltikën ezofageale,

Thelbësore për vendosjen e diagnozës janë EMG dhe biopsia muskulare dhe kutane. EMG është jonormale në 90% të pacientëve me PM duke paraqitur ndryshime të shumëllojshme në varësi të stadit të sëmundjes. Biopsia muskulare është e rëndësishme si për vendosjen e diagnozës duke treguar miopatinë inflamatore ashtu edhe për përjashtimin e miopative të tjera. Duhet të shmanget marrja e biopsisë në vende ku është kryer EMG. Biopsia kutane mund të tregojë një dermatit i cili është i vështirë të diferencohet nga LES.

Për diagnozën e DM, pacienti duhet të ketë të paktën një simptomë kutane të listuar në grupin e "lezioneve kutane" dhe katër nga simptomat e tjera. Për diagnozën e PM pacienti nuk duhet të ketë simptoma kutane dhe duhet të ketë katër nga simptomat e tjera.

Diagnoza diferenciale: PM dhe DM janë dy patologji multidimensionale, me prekje muskulare, kutane dhe sistemike për të cilat është e rëndësishme të bëhet diagnoza diferenciale me sëmundje të tjera që kanë simptoma të ngjashme. Vonesa në diagnozë çon në progresionin e sëmundjes dhe thellimin e prekjes së organeve specifike.

DM duhet të diferencohet nga: Lupus Eritematoz Diskoid, Graft Versus Host Disease, Lichen Myxedematosus, Lichen Planus, Retikulohistiocitoza Multicentrike, Parapsoriasis, Pityriasis Rubra Pilaris, Polymorphous Light Eruption, Psoriasis, Rosacea, Sarkoidoza, Lupus Eritematoz Kutan Subakut, LES, Tinea Corporis.

PM duhet të diferencohet nga: Skleroza Laterale Amiotrofike, Fibromialgjia, Hipertiroidizëm dhe Tirotoksikozë, Hipotiroidizëm, Sindromi Cushing Jatrogjenik, Polimialgjia Reumatika, AR, Sarkoidoza, LES, Trichinosis, Myasthenia gravis, Miopati, IBM, Mioziti eozinofilik, Mioziti osifikues, Mioziti fokal, Mioziti me qeliza gjigande, Poliradikulopatia diabetike, Miopatia metabolike, Distrofia muskulare, Sindromi i mbivendosjes me sëmundje të tjera të indit lidhor. Diagnoza diferenciale duhet të bëhet edhe me miopatitë medikamentoze si për shembull nga: Etanoli, Antimalarikët, Klofibrat, Kolkicine, Ketokonazol dhe agjentë të tjerë antifungalë azolik, Statinat, D-penicilamina, Vinkristina, Zidovudina (AZT).

124. STUDIM KRAHASUES MBI EDUKIMIN DHE SISTEMIN FARMACEUTIK NË SHTETE TË NDRYSHME

Prof. Asc. Entela HALOCI[1], E. GOCI[2], R. SHKRELI[2], L. ZENELAJ[4], I. HALOCI[3], M. KADRIU[4]

[1]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

[2]*Universiteti Aldent*

[3]*APB*

[4]*Farmaci*

Abstrakt

Hyrje: Ushtrimi i profesionit të farmacistit zë një vend shume të rëndësishëm në kujdesin shëndetësor në tërësi. Rreth 400 mijë farmacistë të rrjetit të hapur

(komunitarë) kontribuojnë në shëndetin e mbi 500 milionë njerëzve në gjithë Europën, nga të cilët 46 milionë vizitojnë një farmaci komunitare çdo ditë.

E drejta e profesionisteve si qytetarë të BE-së për të punuar në një shtet tjetër anëtar rrjedh direkt nga Traktatet dhe direktivat europiane. Meqenëse kërkesat e kualifikimit ndryshojnë nga një vend në tjetrin, një profesionist i cili është plotësisht i kualifikuar në një Shtet Anëtar te BE-se mund të hasi vështirësi në ushtrimin e profesionit në një Shtet tjetër Anëtar dhe joanëtar.

Direktiva e vitit 1985 te Komunitetit Ekonomik Europian (EEC) mbi profesionin e farmacistit, supozon se krahasueshmëria e edukimit ne farmaci në gjithë Evropen mund të sigurojë një bazë për njohjen reciproke të diplomave.

Direktiva e Kualifikimeve Profesionale 2005/36/EC është një instrument që synon kapërcimin e këtyre vështirësive duke organizuar njohjen e kualifikimeve profesionale. Ne vijim te kritereve te percaktuara nga kjo direktive europiane rreth 34 vende anëtare të BE-së ose vende kandidate janë organizuar në Unionin Europian te Grupit Farmaceutik (Pharmaceutical Group of the European Union - PGEU). Ne kete studim janë paraqitur një sërë shembujsh të sistemit të edukimit dhe sistemit farmaceutike me qellim për të parë të përbashkëtat, si dhe japim informacion ne lidhje me to.

Materiale & Metoda: Studimi është i tipi krahasues retrospektiv. Janë marre informacione nga konferencat kombetare dhe nderkombetare si dhe botime te ndryshme ne revista te njohura.

Rezultate: Rezultoi se nga studimi restrospektiv i literatures shihet se ne Shqipëri ne lidhje me ndertimin e kurrikules dhe programit te studimit per shkak te implementimit te sistemit te Bolonjes dhe reformave te arsimite larte ka ngjashmeri me disa vende te rajonit edhe anetare te BE, por vihen re ndryshime te konsiderueshme sic janë me vendet nordike. Ne lidhje me sistemin farmaceutik, licensimin, te drejten e ushtrimit te profesionit organizmat drejtues perkates Shqipëria shfaqet me ndryshime te konsiderueshme me vendet e BE dhe ka ngjashmeri kryesisht me vendet e Ballkanit. Ne lidhje me edukimin ne vazhdim jemi ne formim e siper te sistemit edhe pse është zhvilluar mire vitet e fundit.

Konkluzione: Sistemi i edukimit dhe i rrjetit farmaceutik ne Shqipëri shfaqet me ngjashmeri me vendet e Ballkanit por me problematika me te theksuara dhe ka ndryshime te konsiderueshme me vendet e BE. Duhet te stimulojme dhe te adaptojme direktvat e BE, te behemi pjese e konsortiumeve qe tentojne te sheshojne ndryshimet midis sistemeve farmaceutike ne menyre qe kapercehet 'ngerci' i sistemit farmaceutik aktual.

125. EFIKASITETI DHE SIGURIA E RIVAROXABANIT PËRKUNDREJT VARFARINËS NË PACIENTËT ME FIBRILACION ATRIAL JOVALVULAR, DËMTIM RENAL DHE DIABET

Majlinda CAFKA

Abstrakt

Qëllimi: Diabeti Mellitus (DM) është një nga sëmundjet shoqëruese më të zakonshme në pacientët me fibrilacion atrial. Pacientët me diabet Mellitus dhe fibrilacion atrial kanë një risk më të lartë për evente kardiovaskulare dhe vdekje nga çdo shkak krahasuar me ata pa fibrilacion atrial. Sëmundja diabetike e veshkave është një komplikacion afatgjatë i diabetit. Rivaroxaban mbështetet nga rezultatet si një alternativë efektive kundrejt varfarinës për parandalimin e insultit cerebral në pacientët me/pa diabet Mellitus, dhe tregon efikasitet konsistent kundrejt varfarinës në pacient me fibrilacion atrial jovalvular dhe dëmtim të moderuar renal.

Metoda: U vlerësua efektiviteti dhe siguria e rivaroxabanit në popullatë reale kundrejt varfarinës në pacientët me FAJV dhe diabet në praktikën klinike rutinë. Të dhënat u morën nga një databazë e gjerë administrative.

Sipas analizës retrospektive e të dhënavë të regjistrit US Truvën MarketScan, u morën në studim pacientët me fibrilacion atrial jovalvular dhe diabet të cilët kishin filluar rivaroxaban ose varfarinë. Për të zvogëluar diferencat, në dy kategoritë u zbatua grupimi "propensity-score". Për të krahasuar efektet e NOACs me varfarinën në rezultatet renale u përdor analiza retrospektive që përdori të dhënat e Optum-Labs Data Warehouse; ku metoda e përdorur ishte ajo e ndarjes e grupeve proporcionale.

Rezultate: Në total 5,517 pacientë me rivaroxaban dhe 5,517 pacientë me varfarinë ishin të përshtatshëm për studim (~97% me DM tipit 2). Rivaroxaban (të gjitha dozat) lidhej me një reduktim të stroke/ES dhe insultit ishemik me 32% dhe 22% përkatësisht, krahasuar me varfarinën. Rezultatet ishin konsistente në pacientët që merrnin dozën standarte (20mg dozë e vetme) dhe atë të reduktuar (15mg dozë e vetme), po ashtu edhe në pacientët që vuanin nga sëmundja kronike e veshkave.

Krahasuar me varfarinën, përdorimi i NOAC lidhej me një risk më të reduktuar prej ≥30% zbritje në eGFR, dyfishim të serumit të kreatininës dhe dëmtim renal akut më të rrallë.

Konkluzione: Konsistenca e rezultateve midis provave klinike dhe ato në popullatë

reale rrit sigurinë e specialistëvë në përdorimin e rivaroxabanit në pacientët me FAJV dhe diabet. Rrivaroxaban tregoi efikasitet konsistent kundrejt varfarinës në pacient me FAJV dhe dëmtim të moderuar renal.

126. PËRQASJA ANTIKOAGULUESE TEK PACIENTET ME INSULT TË MËPARSHËM

Manjola LIKO

Abstrakt

Qëllimi: Përzgjedhja e terapisë së duhur në pacientët që kanë kaluar një insult të mëparshëm. Përcaktimi i riskut për përsëritje të eventit dhe nevoja për trajtim. Diferenca midis terapisë me aspirinë dhe NOAC.

Materiale & Metoda: Studimi Coleman shqyrtoi databazën e analizave të pacientëve me fibrilacion atrial jovalvular OAC- naive mbi 80 vjeç duke filluar Rivaroxaban ose varfarinë ndërmjet Nëntor 2011 dhe Mars 2016. Në studim u përfshinë 4,398 përdorues Rivaroxaban (43. 4% morën një dozë të reduktuar) dhe 4,398 përdorues të varfarinës.

Rezultati primar i efikasitetit: Insult Cerebral / Emboli Sistemik

Rezultati primari i sigurisë: Hemorragji madhore (algoritmi Cunningham)

Rezultate: Rivaroxaban reduktoi me 39 % insultet cerebrale/embolite sistemike dhe 41% insultet ishemike krahasuar me varfarinën. Nuk pati diferencë në shkallët e hemorragjisë madhore mes kohortëve, gjithsesi Rivaroxaban u lidh me një shkallë më të ulët numerikisht të insulteve hemorragjike dhe intrakraniale. Në popullatën e trajtuar, rezultatet për insult cerebral/emboli sistemike dhe hemorragji madhore ishin konsistente me analizat gjatë trajtimit.

Konkluzione: Ky studim në jetën reale sugjeron se efikasiteti dhe siguria e Xareltos vs Varfarines ruhet në pacientët me fibrilacion atrial jovalvular mbi 80 vjeç. Këto rezultate janë konsistente me gjetjet e mëparshme të studimit ROCKET AF që tregoi një reduktim 20% në insult / emboli sistemike dhe shkallë hemorragjie madhore me Rivaroxaban krahasuar me varfarinen në pacientët me fibrilacion atrial jovalvular mbi 75 vjec. Konsistenca ndërmjet rezultateve të studimit në jetën reale dhe ROCKET-AF jep një siguri në përdorimin e Xarelto në pacientët e moshuar më fibrilacion atrial jovalvular.

127. MANIFESTIMET ORALE NË SËMUNDJEN RENALE KRONIKE

Matilda IMERAJ[1], Ermira IMERAJ[2]

[1]*Nefrologe, Shërbimi i Nefrologji-Dializë-Transplant "QSUT "Nënë Tereza" Tiranë*

[2]*Farmaciste, FSDKSH, Tiranë*

Abstrakt

Sëmundja renale kronike (SRK) është një problem mbarë botëror i shëndetit publik me një prevalencë të vlerësuar nga 10 deri në 13% në vendet me të ardhura të larta. Ne semundjen renale kronike ndodh demtim progresiv i funksionit renal dhe manifestimet klinike vihen re në pothuajse të gjitha organet dhe sistemet e trupit dhe 90% e të gjithë pacientëve me SRK përjetojnë simptoma orale. Ka një incidience të lartë të manifestimeve patologjike orale në pacientët ne stadin terminal te SRK-se që i nenshtrohen trajtimit renal zevendesues qe lidhet me vet semundjen ose si rezultat i trajtimit të saj. Manifestimet me frekuente oro-maksilo-faciale ne pacientet me semundje renale kronike nen trajtim me dialize ose te transplantuar janë: Hiperplazia e gingivave, gingivitis katarrhalis i gjeneralizuar, ndryshimet inflamatore në mukozën orale, zbehja e mukozës së gojës si rezultat i sindromës anemike, xerostomia, alterim i sensacionit te shijes, fetor uremik, glositi uremik, stomatiti uremik, hipoplazia e smaltit, ngushtimi i dhomës së pulpës dentare, karies, ndryshimet kockore. Kujdesi dentar i pacientëve që trajtohen me dializë mund të jetë kompleks, duke pasur parasysh prevalencën e larte te semundjeve bashkeshoqeruese sic janë: Diabeti, hipertensioni arterial, osteodistrofia renale, imunosupresioni, prania e paisjeve mbrojtëse dentare,përdorimi i barnave antihipertensivëve, antikoagulanteve ose barnave antiagregante. Konsultimi me nefrologët në lidhje me masat specifike të domosdoshme për çdo pacient me SRK mbart ne vetvete nje rendesi te vecante ne funksion te bashkepunimit multidisiplinar me qellim rritjen e kujdesit ndaj pacietit. Plani i trajtimit dentar duhet të kete në fokus faktin që këta pacientë kanë tendencë per fenomene hemoragjie, hipertension, anemi sekondare, intolerance te larte ndaj barnave dhe infeksione rekurente.

Fjalë kyçe: Sëmundja renale kronike (SRK), manifestimet orale, menaxhimi.

128. KOMPLIKIMET E INJEKSIONEVE ME ACID HIALURONIK (FILLER)

Monika FIDA[1], Orjana JANUSHAJ[2], Laerta PUPO[2], Silva RISTA[2], Ritjona MALA[1],

Valbona ZENELAJ[1], Erjona SHEHU[1]

[1]*Shërbimi i Dermatologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*

[2]*Klinikë Dermatologjike Private, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Dermatologjia estetike dhe procedurat e rigjenerimit të lëkurës, trajtimit të inestetismave po gjejnë përdorim gjithnjë e më shumë në praktikën e përditshme. Trendi i sotëm është drejt procëdurave jo- invazive krahasuar me numrin e këtyre procedurave të kryera kryer më parë. Aplikimi korrekt i acidit hialuronik dhe nga mjekë të trajnuar saktë në këtë fushe shoqërohet me numër shumë të vogel ose aspak të komplikimeve.

Qëllimi: Të theksohet rëndësia e kualifikimit në procedurat e injeksioneve të acidit hialuronik (Filler). Të njihen, të kuptohen dhe të ritheksohen mënyrat e menaxhimit të komplikimeve pas aplikimit të acidit hialuronik.

Materiale & Metoda: Pacientë të trajtuar me injeksione të acidit hialuronik (Filler) dhe që pas procedures kanë raportuar komplikime. Materiali i perzgjedhur në këtë referim është material jo vetëm i rasteve klinike të hasur në praktikën e përdishtme 10 vjecare por dhe raste të raportuara në pubmed.

Rezultate: Komplikimet pas injeksioneve të acidit hialuronik mund të klasifikohen: Komplikime të afërta (menjehërë post procedure) dhe komplikime të largëta. Numri i komplikimeve menjëherë post procedure është më i madh krahasuar me numrin e komplikimeve të largëta dhe përfshin: dhimbje, edeme, discomfort, hematome, jo-trajtshmëri, noduj, komprimim vaskular- nekroze, herpes simplex, impetigo, verbim. Numri i komplikimeve të largëta është më i vogël dhe përfshin : granuloma, migrim të fillers, infeksione.

Konkluzione: Procedurat e injeksioneve të acidit hialuronik janë procedura të sigurta dhe efektive në se aplikohen nga personel mjekesor i trajnuar. Thellimi i njohurive në këtë nën specialitet dhe vecanërisht trajtimi i komplikimeve është një domosdoshmëri për personelin mjekësor që realizon këto procedura. Mjekësia estethike është ura lidhëse midis mjekësisë dhe artit.

129. DIAGNOZA DIFERENCIALE MES MELANOMËS E NEVUSEVE DISPLAZIKË, DHE NDIHMESA E IMUNOHISTOKIMISË NË VENDOSJEN E KËSAJ DIAGNOZE

Dr. Orion DOLLMA, Dr. Shk. Leart BËRDICA, Dr. Alda CENGU

Fakulteti i Mjekësisë, UMT

Abstrakt

Sfondi: Melanoma është një ndër proliferimet malinje më të rrezikshme dhe është shkaku i 30 i mortalitetit në vendin tonë. Diagnoza diferenciale ndërmjet nevuseve atipikë me displazi të rëndë dhe melanomës shpeshhere është tejet i vështirë për tu realizuar vetëm nëpërmjet ekzaminimit bioptik.

Qëllimi & Objektivat: Qëllimi i këtij studimi është që të vlerësojë karakteristikat e ndryshme të këtyre dy proliferimeve në vëndin tonë, si arrihet realizimi i kësaj diagnoze diferenciale në vendin tonë dhe ndihmën që mund të japë imunohistokimia në këtë drejtim.

Materiale & Metoda: Ky është një studim retrospektiv që përfshin 1129 raste të shpërndara në kohë nga viti 2009 deri në mesin e vitit 2018. Materialet u morën nga arkivat elektronike të Spitalit Amerikan, nga Klinika Mjekësore Megis dhe nga arkivi i klinikës Royal Diagnostic Center. Materialet pasi u shqyrtuan rast pas rasti u ndanë në kategori të ndryshme në varësi të moshës, gjinisë, lokalizimit, diagnozës bioptike dhe antitrupave që ishin përdorur. Të dhënat u analizuan nga programi kompjuterik SPSS për të vlerësuar domethënien e tyre statistikore.

Rezultate: Variablat e ndryshme që u vlerësuan (grupmosha, gjinia, lokalizimi) rezultuan të jenë të lidhura ngushtësisht nga ana statistikore me rastet e dyshuara dhe të konfirmuara të melanomës (ku P rezultoi <0. 003 në të gjitha marrëdhëniet). Grupmoshat më të rrezikuara nga melanoma rezultuan dekada e pestë e jetës dhe mbrapa. Meshkujt predominojnë rastet e melanomës (57%) dhe lokalizimi më i shpështë në të dyja gjinitë rezultoi regjioni i trungut (48%). Dyshimet klinike për melanomë u konfirmuan nga biopsia në 19% të rasteve ndërsa 47% e rasteve rezultuan nevuse dhe 34% diagnoza të tjera. Imunohistokimia rezultoi të jetë e suksesshme në diagnozën diferenciale të melanomës dhe shumica e antitrupave treguan sensitivitet të lartë.

Konkluzione: Diagnoza diferenciale e nevuseve displazikë me melanomën vazhdon të jetë një diagnozë e vështirë për tu vendosur, sic tregohet edhe nga raporti i rasteve të shumta të dyshuara për melanomë me rastet e konfirmuara më pas nëpërmjet biopsisë, ku vetëm 19% rezultojnë të tilla në fund, por imunohistokimia premton të jetë një armë e fortë në lehtësimin e kësaj dileme mjeksore në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Melanoma, Nevuse Displazike, Imunohistokimi, Diagnoze Diferenciale, Biopsi.

130. BELBËZIMI, A NDIKON NË PERFORMANCËN E TË NXËNIT?

Orla KAIMI

Logopede

Abstrakt

Ky studim trajton ndikimin e belbëzimit në performancën e të nxënit. Për këtë studim u intervistuan 60 edukatore që punojnë në 20 kopshte të arsimit parashkollor në Tiranë, shumica e të cilave kanë punuar dhe punojnë me fëmijë të moshës 3-6 vjeç që belbëzojnë. Sipas këtij studimit, çrregullimet më të shpeshta janë çrregullimet e artikulimit, belbëzimi, vonesa e gjuhës dhe të folurit, disleksia dhe çrregullime të tjera si spektri i autizmit, sindroma down, ADHD dhe prapambetja mendore. Për të trajtuar belbëzimin edukatoret përdorin teknika si: stimulimi i fëmijës, përsëritja e fjalës me anë të ngrohtësisë / përkëdhelive, aktivizimi dhe përballja me problemin, nuk e pyesin të parin në mësim fëmijën që belbëzon, ritregimi, përshkrimi i figurave dhe ndihma për shqiptimin sa më të saktë të fjalëve. Në disa raste ato i kërkojnë fëmijës të flasë ngadalë apo nuk përdorin metoda dhe i trajtojnë këta fëmijë si gjithë fëmijët e tjerë. Fushat që preken më shumë nga belbëzimi janë: ritregimi, bashkëbisedimi, recitimi, leximi dhe e folura spontane. Studimi arrin në përfundimin se: " Belbëzimi ndikon në performancën e të nxënit".

Për të krahasuar metodat që përdoren nga edukatoret, për të evidentuar avantazhet dhe mangësitë në punën e tyre, u mor një rast klinik me një pacient të moshës 10 vjeç, diagnoza e të cilit ishte: Çrregullim i rrjedhshmërisë, shoqëruar me çrregullim të artikulimit të fonemave LL-DH dhe Q-Ç. Fillimisht u mor anamneza dhe u bë një vlerësim i të folurit të fëmijës. Më pas u hartua plani i punës me të gjithë komponentët përbërës të tij, si objektivat parësorë dhe dytësorë, terapia direkte (ushtrimet e respirimit dhe ekspirimit, relaksimi i organeve fonatore dhe të artikulimit, ushtrime fonetike dhe të artikulimit, loja me role, aktrimi ose bashkëbisedimi sipas rregullave të të folurit standard) dhe terapia indirekte (bisedat me prindërit dhe fëmijën për sensibilizimin e çrregullimit, këshillimi me prindin, marrëdhënia e qetë familjare fëmijë–prind).

Rasti klinik demonstrohet edhe me video të punës me pacientin.

Fjalë kyçe: belbëzim, performancë të nxëni, çrregullim, teknikë, arsim parashkollor, terapi.

131. CRUSH SINDROME DHE TERAPIA

ZËVENDËSUESE RENALE E VAZHDUAR (CRRT)

R. KëRTOÇI, B. ARAPI

Shërbimi Anestezi-Reanimacion, Spitali Amerikan, Tiranë

Astrakt

Hyrje: Mioglobina është proteinë që në bazë ka hekurin dhe mundëson transportin e O2 në muskujt(e strijuar). Në rastet me rabdomiolize(Crush Sindrome) për shkak të dëmtimit të muskujve çlirohet mioglobinë e cila mendohet që është arsyeja kryesore e IRA(nëpërmjet disa mekanizmave tashmë të konfirmuar).

Qëllimi: Vlerësimi i modaliteteve të trajtimit të IRA në rabdomiolizë duke u fokusuar kryesisht në CRRT si edhe eksperienca jonë në trajtimin e pacientit në gjendje septike të rëndë e IRA (anuri).

Konkluzione: Përvec trajtimit konvencional në Crush Sindrome, rol të rëndësishëm kan edhe CRRT(CVVH dhe SHF), hemodializa. Momenti i fillimit të CRRT varet nga i IRA dhe ose MODS dhe jo nga niveli i mioglobinemi apo LDH. Në 2014 ka patur raportime për përdorimin e SHF(super high flow hemofiltracion) e cila realizohet me filtra me dimensione të poreve më të mëdha sesa filtrat e zakonshëm.

Fjalë Kyçe: Crush Sindrome, CRRT, rabdomiolize, IRA, mioglonine, SHF.

132. STUDIMET PARAKLINIKE NË ZHVILLIMIN E BARNAVE TË REJA, ASPEKTE TË PERGJITHSHME DHE PROBLEMATIKAT

M.Sc. Shpresa ZHURDA

Abstrakt

Në procesin e zhvillimit të barit, studimet paraklinike janë një fazë e hulumtimit që fillon pasi zbulohet komponimi "lider", ku i nënshtrohet proçesit të zhvillimit për optimizimin e vetive të tij. Ky proçes përfshin studimet farmakologjike dhe efektet në toksicitet, karcinogjenicitet, mutagjenicitet dhe zhvillimet riprodhuese. Këto të dhëna janë thelbësore për tu njohur. Mesatarisht, vetëm një në çdo 5,000 komponime që hyjnë në fazën e zhvillimit paraklinik, aprovohet si bar apo produkt potencial.

Çdo klasë e produkteve mund t'i nënshtrohet llojeve të ndryshme të studimeve paraklinike. Për shembull, barnat mund t'i nënshtrohen studimeve të farmakodinamikës (FD), farmakokinetikes (FK) dhe testeve të toksikologjisë.

Modelet të gjitarëve brejtës dhe jobrejtës përdoren për të përcaktuar profilin e farmakokinetikës dhe vlerësimet mbi toksicitetin për të marrë të dhënat e para mbi sigurinë e përdorimit.. Përdorimi i kafshëve në disa raste çon në vuajtjen e organizmit të përdorur dhe në vështirësi në proçeset e ekstrapolimit të të dhënave eksperimentale.

Për këto arsye aktivistët e të drejtave të kafshëve po kundërshtojnë gjithnjë e më shumë përdorimin e tyre. Kjo i ka detyruar studiuesit të gjejnë mënyra për të ulur numrin e kafshëve të përdorura. Për të përmbushur këtë qëllim, janë hartuar një sërë teknikash të reja in vitro të cilat quhen "Alternativa" ose "4R-zevendësuese" që përfshijnë metodat fiziko-kimike dhe teknikat që përdorin kulturën e indeve, sistemin mikrobiologjik, sekuencat e ADN-së, modele të analizës kompjuterike, studime epidemiologjike dhe materiale bimore. Ndonëse sot zhvillimi i barnave i është drejtuar provave "ex vivo", "in vitro'" apo modeleve virtuale, disa analiza e kanë të domosdoshme konfirmimin final në kafshë.

Persa i përket Shqipërisë, nga ana praktike, eksperienca shqiptare me studime paraklinike është pothuajse zero. Të vetmet eksperienca me prova në kafshë janë ato me karakter vlerësim teknologjik cilësor i formave të caktuara farmaceutike (teste pirogjeniteti), por jo prova që mund të klasifikohen në grupimin "paraklinik".

Gjatë zhvillimit të studimeve paraklinike është e rëndësishme që të zbatohen të gjitha rregullat dhe kërkesat e vendosura nga autoritetet rregullatore. Përmbushja e parimeve të Praktikës së Mirë Laboratorike është një nga kriteret kryesore që garanton besueshmërinë e rezultateve të studimit klinik

Fjalë kyçe: studimet paraklinike, modelet e kafshëve, in vivo, ex vivo,4R-të, GLP

133. WHEEZING & ASTMA E MOSHËS PARASHKOLLORE

Dr. Sonila BORIÇI

Shërbimi i Pneumoalergologjisë Pediatrike, QSUT "Nënë Tereza"

Abstrakt

Wheezing përbën një nga simptomat më të shpeshta të paraqitjes së fëmijëve për konsultë pediatrike. 1/3 e fëmijëve parashkollore prezantohen me wheezing para

moshes 5 vjeç (1 në 3 femijë ka së paku një episod me wheezing para moshës 5 vjeç). Fenotipet klinike të wheezing janë shumë heterogjene, ndërkohë ka pak të dhëna mbi fizpatologjinë dhe trajtimin e tij. Në literaturë gjejmë të dhëna kontradiktore mbi klasifikimin dhe trajtimin e tij. Në moshën shkollore, pjesa më e madhe e femijëve me wheezing nuk kanë me simptoma, ndryshe nga fëmijët me astme tek të cilat simptomat persistojnë gjatë gjithë fëmijërisë. Ky fakt nxiti përpjekjet për identifikimin e faktorëve të cilët parashikojnë persistencën e simptomave në moshën shkollore, si dhe klasifikimin fenotipik të wheezing. Faktori më i rëndësishëm i riskut për persistencë të simptomave në moshën shkollore është atopia: sa më shumë alergene dhe sa më e madhe shkalla e sensitivizimit aq më e madhe mundësia që wheezing të persistojë edhe në moshën shkollore.

134. URGJENCA NË PACIENTËT ME SËMUNDJE HEMATOLOGJIKE

Prof. Dr. Tatjana NAKUÇI CAJA, Dr. Adela PEROLLA, Dr. Jada CAJA, Dr. Tedi MANA

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

A ka urgjenca Hematologjia? Ashtu si çdo shërbim tjetër mjekësor, edhe të sëmurët me patologji hematologjike janë të predispozuar të kenë nevojë për ndihmë urgjente mjekësore.

Cilat janë disa patologji hematologjike që kanë nevojë për ndihmë urgjente mjekësore?

- Purpura trombocitopenike trombotike,
- Leukemia akute promielocitare,
- Drepanocitoza,
- Neutropenia febrile,
- Kompresioni i kordave spinale.

Roli i Shërbimit të urgjencës mjekësore dhe impakti i ndihmës urgjente praktikisht, si dhe rëndësia e psikologut në kushtet e urgjencës do të jenë në fokusin e këtij referimi.

135. VLERËSIMI I NIVELIT TË STRESIT DHE BURNOUT-T NË PUNË NË POPULLATËN SHQIPTARE, NDIKIMIMI I TIJ NË SHËNDET DHE NË MËNYRËN E JETESËS

Zvjetllana SKOROVOTI[1], Mirela GOGAJ[1], Alba THEMELI[2]

[1]*Departamenti i Neuroshkencës, QSUT "Nënë Tereza"*

[2]*Qendra e Trajnimit Profesional Mjekësor "Santa Maria"*

Abstrakt

Hyrje: Stresi i lidhur me vendin e punës është përgjigja që kanë njerëzit kur përballen me presione dhe kërkesa të cilat nuk janë në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe sfidojnë aftësinë për tu përshtatur. Stresi në punë mund të rritet kur punëtorët nuk ndihen të mbështetur nga mbikëqyrësit apo kolegët ose ndihen sikur të kenë pak kontroll mbi proceset e punës.

Objektivi: Qëllimi i këtij punim është të vlerësohet niveli i stresit dhe i ezaurimit në vendin e punës, faktorët pozitiv dhe negative në Shqipëri në punojësit me ngarkesë të punës mendore.

Materiale & Metoda: Ky studim është një studim deskriptiv i faktorëve pozitiv dhe negative që ndikojnë në nivelin e stresit në popullatën punëtore si dhe në nivelin e prodhimshmërisë e parë kjo në terma ekonomik si dhe shëndetsorë. Në këtë studim morën pjesë 1000 punonjës dhe përzgjedhja u bë nëpërmjet teknikave të përzgjedhjes së kampionit. Të dhënat u përpunuan me spss version 23. Pyetësori i përdorur është GHQ 12.

Rezultate: Në nivelin e stresit në punë ndikojnë shumë faktorë si mosha, të ardhurat ekonomike, statusi social, kushtet e punës, siguria në punë, orari i punës. Stresi në punë është përgjegjës për ç'rregullimin e gjumit, aftësisë për tu përqëndruar, ndjenjën e pafuqisë dhe ndryshimet e humorit, vetëvlerësimin, aftësinë për tu përballur me problemet dhe në lumturinë e përgjithshme.

Rekomandime: Risku psikosocial në punë nuk duhet neglizhohet. Përmes identifikimit në kohë dhe vlerësimin adekuat të rreziqeve psikosociale, qasje gjithëpërfshirëse parandaluese, masat për të eliminuar ato dhe duke krijuar karakteristikat e një mjedisi psikosocial të shëndetshëm të punës, mund të krijohen vende pune të shëndetshme dhe organizata të shëndetshme, ku punëtorët janë të kënaqur dhe kane qëndrim të motivuar dhe pozitiv ndaj punës së tyre.